Ku mund të studioni?

Faqe 7-10

I HAVE A DREAM

Nga: Adi Krasta

Faqe 2

Anketa, maturantët përcaktohen për në AAB-Riinvest

Faqe 6

Anketë

Ku dëshironi të studioni?

Universiteti Publik i Prizrenit (117)

Universiteti AAB-Riinvest (1003)

Universiteti i Prishtinës (1044)

Universiteti Amerikan i Kosovës (270)

Universiteti i Tetovës (123)

Universiteti i Tiranës (188)

Të tjera (411)

STUDENTI

E MARTË, 26 PRILL 2011, NR. 1, VITI I

Fakulteti i Komunikimeve Masive dhe Gazetarisë bëhet me objekt të vetin

Prijësi në Kosovë tani synon rajonin

Universiteti AAB-Riinvest ka pretendime reale, për të qenë prijës në rajon. Sa për në Kosovë, këtë tashmë e ka dëshmuar jo vetëm për nga teknika e teknologjia e investuar dhe për nga objekti i ri për Fakultetin e Komunikimeve dhe Gazetarisë, por vlerësimin si prijës në vend e mori kur Agjencia e Akreditimit vetëm këtij fakulteti në Kosovë i dha akreditimit për studimet pasdiplomike të masterit

Faqe 3

Shtojca

MATURANTI

Pasiguri dhe optimizëm për testin e pjekurisë

Përderisa maturantët dhe drejtorët e disa shkollave ankohen për neglizhencën e Ministrisë së Arsimit për parapërgatitjet dhe specifikat e testit të maturës, në këtë institucion thonë se nuk janë të interesuar për rritjen e përqindjes së kalueshmërisë, por për rritjen e cilësisë

Faqe 13

Ish-studentët e AAB-Riinvest mposhtin konkurrencën - tani të suksesshëm në tregun e punës

Krenohen me studimet e kryera

Faqe 4

Të studiosh në Prishtinë dhe të marrësh diplomë angleze

Franshiza, studime unikate në Kosovë

Faqe 3

Testi i maturës, ja cilat janë pyetjet

Testi i maturës i vitit të kaluar (2010)

Faqe 19

Editorial

E studentëve dhe për studentët

Studentët kanë sot në dorë gazetën e tyre. Është e thjeshtë, praktike me sukseset, vështirësitë, dëshirat, por edhe idetë e tyre. Këto ide nuk lidhen me interesin e politikës, por me arsimimin më cilësor, përparimin e shoqërisë, rritjes së mirëqenies, shkencës. Paraqesin edhe opinion publik. Interesi politik kërkon turmë dhe turma lidhet pas udhëheqësit. Studentët kanë mendimin e tyre të pavarur, janë kritikë. Ata duan konkurrencën e vlerave. Këtë e kanë përqafuar studentët tanë.

Edhe dalja e kësaj gazete studentore është rezultat i punës së studentëve me vetiniciativë. Ky rezultat ka ardhur në vazhdën e angazhimeve të deritanishme gjithnjë e në rritje të punës së tyre konkurruese. Një konkurrencë e brendshme në mjediset universitare bëri që studentët e Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë në AAB-Riinvest të prodhojnë qindra kronika radiotelevizive në gjini të ndryshme, vetëm brenda këtij semestri. E gjithë kjo në mjediset universitare dhe në sajë të kushteve të krijuara me studio televizive, studio të radios, sallë montazhi, produksioni etj. Përveç produktit të tyre në mediat audiovizive, puna konkurruese studentore në këtë institucion arsimor bëri që vetëm brenda pak muajsh të mbërrihet lexuesi i 1 (një) miliontë në agjencinë e lajmeve KNN, duke u shtrirë kështu ky informacion në të gjithë globin.

Puna kërkimore e stafit, produkti profesional studentor dhe investimet që krijuan kushte jashtëzakonisht komode me të gjitha llojet e mediave në mjediset brendauniversitare, ka bërë që ky institucion arsimor të marrë vlerësimet më të larta nga Agjencia e Akreditimit. Cilësia ka bërë që vetëm ky universitet në Kosovë të akreditohet për studimet pasdiplomike në master të komunikimeve masive dhe gazetarisë. Tani, pasi ka marrë merituesheim epitetin e të parit në Kosovë, synon primatin në rajon.

I HAVE A DREAM

Adi Krasta

Do të duhej të lindte Martin Lutheri, që të shqiptonte këtë frazë të madhe: "Unë kam një ëndërr". Për të ndryshuar një mentalitet të madh, global. Për të shkaktuar një ndryshim që përfshinte miliona mendje e zemra në gjithë botën, do të mund të shihnin me sytë e mendjes, me sytë e dëshirës. Këta njerëz që dashurojnë njeriun dhe mësojnë me ngulm të punojnë me të duke komunikuar bëhen të rëndësishëm sidomos në një vend që po krijon identitetin e vet, me mund e gjak, ata që komunikojnë janë së pari ëndërruesit, ata që shohin larg, ata që me artin e fjalës dhe forcën e mendimit frymëzojnë, ngrenë peshë zemrat e bashkëkombësve të tyre që jetojnë në një kohë me ta. Ndaj i shoh me dashuri studentët e Komunikimit Masiv, sepse pres të bëjnë shumë më shumë se fabrikimin e pafat e naiv të fjalëve. Ja përse komunikoj me ta si i barabartë. Sepse i besoj që në ditën e parë të sinqeritetit të tyre, dëshirës për të mësuar, për t'u lodhur që i gjithë vendi, të ndryshojë bashkë me ta. Dhe sa herë që sjell në mendje ndryshimin më kujtohet një thënie e Mahatma Gandit: "Ju duhet të jeni ndryshimi të cilin dëshironi ta shihni në botë".

Sa i njoh kolegët e mi, për të cilët kam admirim të veçantë, që nga Masar Stavileci, Agim Vinca, Ibrahim Berisha, Mimoza Doko, Ilir Tafa, Enver Petrovci, etj, marr kënaqësi që jam pjesë e një ndryshimi të madh, i cili fillon natyrshëm në bankën e universitetit. Kosova dhe Shqipëria, duhet të ndryshojnë, të krijojnë një tjetër klasë politike, më të përgjegjshme, më pranë jetesës së popullit. Kosova dhe Shqipëria do të duhen të përmenden vazhdimisht së bashku, si vëllezërit siamezë, fati i të cilëve qëndron i lidhur, me karakteristikat e veçanta që rrisin vlerën e secilit vend dhe fuqizojnë njeriun shqiptar, pavarësisht nga cila anë e kufirit vjen ai. Kush më shumë se studentët, ëndërrimtarët, punëtorët e palodhur, këmbëngulësit, shpirtrat e lirë, të pajisur me dije dhe eksperiencë do ta përmbushin këtë mision. Kujt më shumë se atyre do t'i besohej ai. Ata janë " të zgjedhurit". Ndaj, periudha e tyre e studimeve të larta, është më shumë se kalim kohe, është më shumë se pajisja me një maturi të shkujdesur. Kosova dhe Shqipëria kanë nevojë për Martin Luther Kings. Për shumë të tillë. Që bëjnë më shumë se sa flasin. Që dinë të bashkëpunojnë më shumë sesa e mbajnë veten "ideologë" që dashurohen me pamjen e tyre nëpër mediume, duke i rënë vazhdimisht dhe me kokëfortësi daulleve të përçarjes. Neve do të na duhen shqiptarë që mendojnë thellë, që janë pajisur me fuqinë për të parë të ardhmen. Këta, komunikues, këto vajza e djem të cilëve do t'u besojmë shumë, i kam çdo shtator përballë. Dhe vazhdimisht shpresoj që ata ta dinë se nuk janë rastësisht aty. Dhe krejt në fund, nëse do të duhej t'i kisha thënë diçka, do sillja ndërmend kinezin e mençur Konfuci, i cili i përulur, i ditshëm, dhe largpamës, do t'u kishte thënë:" Çfarë do që të bëni, bëjeni atë me gjithë zemër". Nuk ka rëndësi kush ka një ëndërr. Ne kemi një ëndërr. Ejani t'i futemi punës!.

"Çfarë do që të bëni, bëjeni atë me gjithë zemër"- Konfuci

Politika për rininë, mjet apo qëllim?

Marigona Qela

Shumë të rinj të Kosovës janë inkuadruar në politikë për shkak se një gjë e tillë u pëlqen, por edhe për faktin se e shohin politikën si rrugë e cila do t'u ndihmojë në karrierën e tyre të ardhshme. Shumë të rinj mendojnë se janë disa parti politike në të cilat kanë mundësi t'i shprehin mendimet e tyre.

Ka parti politike në të cilat aderimi i rinisë është i konsiderueshëm dhe ka mjaft të rinj të tjerë të cilët interesohen për t'u angazhuar në politikë. Disa nga partitë politike u japin mjaft hapësirë forumeve rinore dhe mendimeve të tyre, por disa nga këto kanë formuar forume rinore pa ndonjë rol aktiv. Ka edhe të atillë që politikën e shikojnë si diçka që nuk u përket dhe nuk duhet jetuar aktivisht, sepse kanë krijuar bindjen se të gjithë politikanët janë "hajdutë", "mashtrues" dhe "të korruptuar".

Mendoj se janë këto dy argumente që prekin të rinjtë e sotëm në lidhje me pjesëmarrjen e tyre aktive në jetën politike. Prandaj, një pjesë e rinisë për këtë arsye nuk angazhohet në jetën politike. Megjithatë, disa nga partitë politike janë mjaft të kënaqura me numrin e të anëtarësuarve në partitë e tyre, numër ky i cili e arrin shifrën deri në 200 mijë. Jeta sociale në Kosovë në të shumtën e rasteve është e tillë ku në një aplikacion pune pyetet edhe pikëpamja politike, me imponim apo pa të, duhet domosdo t'i përkasësh ndonjë partie.

Një arsye tjetër pse rinia është e inkuadruar në politikë, janë kushtet e rënda sociale,të cilat imponojnë simpatizimin e ndonjë partie ku me shpresë se ajo parti do të marrë parasysh këtë problem jetësor të tyre dhe do t'u ndihmojë në njërën apo tjetrën anë.

Sipas një hulumtimi të bërë kohëve të fundit, numri më i madh i personave të inkuadruar rishtazi në partitë politike, janë të rinj në moshë. Edhe popullsia e Kosovës, po sipas statistikave, është e re, me një përqindje të madhe të grup-moshës 18-30 vjeç, moshë kjo e cila mund dhe di më së miri të përfaqësojë qoftë një parti, një institucion apo çfarë do qoftë tjetër. Ka edhe të atillë që u është imponuar nga familja e tyre, e cila ka qenë e angazhuar dikur në parti, apo është sot dhe nuk lejon që fëmijët e tyre të mos i përkasin po të njëjtës parti.

Përmbledhja e gjithë kësaj është se në Kosovë për rini mund të ndjesh keqardhje. Atyre u "imponohet shumëçka", janë të shtypur, nuk kanë hapësirë të mjaftueshme në çfarëdo lloj fushe, nuk kanë përkrahje shtetërore, institucionale dhe veten e gjejnë vetëm në një vend aty ku kanë sadopak të drejta, përparësi dhe përkrahje. Ai vend është politika, e cila jo gjithmonë kërkon apo ka vlera.

Gazeta Periodike "STUDENTI"
Boton: Universiteti AAB-Riinvest , Zona Industriale Prishtinë - Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,
Tel: 038/ 601 019; 038/ 601 020, info@aabriinvest.net, www.aabriinvest.net

Fakulteti i Komunikimeve Masive dhe Gazetarisë bëhet me objekt të vetin

Prijësi në Kosovë tani synon rajonin

Universiteti AAB-Riinvest ka pretendime reale, për të qenë prijës në rajon. Sa për në Kosovë, këtë tashmë e ka dëshmuar jo vetëm për nga teknika e teknologjia e investuar dhe për nga objekti i ri për Fakultetin e Komunikimeve dhe Gazetarisë, por vlerësimin si prijës në vend e mori kur Agjencia e Akreditimit vetëm këtij fakulteti në Kosovë i dha akreditimit për studimet pas-diplomike të masterit

Drilon Pulaj

Një ambient krejtësisht i ri, një mjedis me mundësi të shumta prej ku studenti – gazetar i ardhshëm, mund t'i mësojë zanatet e shumta të komunikimit.

Fjala është për përurimin e objektit të ri të Fakultetit të Komunikimeve Masive dhe Gazetarisë të Universitetit AAB-Riinvest, i vetmi fakultet i gazetarisë me objekt të vetin në Kosovë.

Universiteti AAB-Riinvest ka pretendime reale, për të qenë prijës në rajon. Sa për në Kosovë, këtë tashmë e ka dëshmuar jo për nga teknika e teknologjia e investuar dhe për nga objekti i ri për Fakultetin e Komunikimeve dhe Gazetarisë, por vlerësimin si prijës në vend e mori kur Agjencia e Akreditimit vetëm këtij fakulteti në Kosovë i dha akreditimit për studimet pas-diplomike të masterit.

Hapja edhe e drejtimit të Produksionit, përveç atij të Gazetarisë, ka bërë që ky drejtim i ri në vendin tonë të jetë i kërkuar, aq më shumë që tashmë menaxhmenti i universitetit do të vazhdojë në ngritjen e dy kateve të tjera të këtij fakulteti, ndërsa teknikat mediatike pritet të jenë nga më të sofistikuarat.

Pasi është bërë hapja e këtij objekti, Fakultetit të Komunikimit Masiv i është shtuar edhe më shumë hapësirë për të vepruar, ku përveç amfiteatrove më modernë të cilat janë edhe në tre objektet e tjera të këtij universiteti, këtu janë investuar mjete të shumta për salla praktike. Studentët pas orëve teorike vazhdojnë në orë praktike me të gjitha mjetet e një radioje, e një televizioni, e një gazete, salla e montazhit, salla e përgatitjes së lajmeve, salla moderne për xhirimi e emisioneve të ndryshme etj. E gjithë kjo do të zhvillohet nga studentët nën udhëheqjen e profesorëve më të kualifikuar nga vendi e nga rajoni.

Tani ka filluar të botohet kjo revistë javore me qëllim të informimit dhe angazhimit të studentëve për botimin e eseve dhe shkrimeve të ndryshme, përmes së cilës çdo student mund të tregojë aftësitë e veta për të shkruar.

Ky universitet posedon gjithashtu edhe agjencinë e lajmeve "Kosovo News Network" (KNN) dhe është në përfundim të përgatitjeve për hapjen e televizionit me të njëjtin emër, me programe informative e argëtuese, me qëllim që studentët në këtë universitet jo vetëm të dëgjojnë për gazetarinë, por edhe ta bëjnë atë vetë.

Përveç kësaj, Universiteti AAB-Riinvest në këtë objekt të ri ka hapur edhe sallën sportive në të cilën do të zhvillohen ndeshjet e klubit të volejbollit "Universiteti AAB-Riinvest Prishtina", e cila përveç ushtrimeve, tani bëhet edhe nikoqire për ndeshjet e saja volejbollistike me të gjitha klubet e tjera të Kosovës dhe më gjerë. Studentët e Komunikimit Masiv për argëtim kanë gjithmonë në dispozicion sallën, për futboll, basketboll dhe volejboll.

Në objektin e katërt nuk mungon edhe poligoni për auto-shkollën e universitetit, me të cilën shpërblehen studentët e sapo regjistruar dhe të cilët dëshirojnë të bëhen shoferë. Regjistrimi, përgatitja teorike dhe praktike e të gjitha procedurat tjera deri në marrjen e patentë-shoferit, janë pa pagesë.

Pasi që gjendet në periferi të Prishtinës me një kampus të gjerë universitar, AAB-Riinvest posedon edhe autobusët privatë të cilët qarkullojnë me orar në të gjitha anët e kryeqytetit për të sjellë studentët në hapësirat e universitetit, në çdo kohë të ligjëra-tave, pa pagesë.

"Ia vlen të vizitoni së paku një herë objektet e këtij universitetit dhe do të bindeni", thonë vetë studentët kolegëve të universiteteve të tjera.

Botimi i Librit universitar nga AAB-Riinvest

Universiteti AAB-Riinvest ka filluar me kohë të zhvillojë veprimtarinë botuese të librit universitar me qëllim që studentët e tij të kenë edhe botimet e pedagogëve të fakulteteve përkatëse në shërbim të procesit mësimor dhe edukativ të Universitetit.

Kështu, veprimtaria e tij botues shtrihet në fushat, për të cilat studentët e këtij Universiteti kanë treguar interesim të veçantë, si dhe prej të cilave ata përgatisin provimet e tyre, përveç atyre thjesht shkencore. Kështu, Universiteti boton libra universitarë dhe literaturë profesionale. Universitetit AAB-Riinvest ka botuar një varg librash shkencorë kërkimorë në gjuhën shqipe, si dhe në gjuhë të tjera.

Universitetit AAB-Riinvest boton edhe revistën kërkimore ndërkombëtare "Thesis Kosova" në gjuhët shqipe dhe angleze.

Po radhisim këtu më poshtë botimet e tij , sipas fushave studimore.

Nga fusha e Komunikimit Masiv janë botuar:
- **"Agjensët e komunikimit"**, autor Ibrahim BERISHA
- **"Media dhe shoqëria"**, autor Ibrahim BERISHA
- **"Radiogazetaria"** , autor Rrahman Paçarizi
- **"Zhanret e gazetarisë"** , autor Ibrahim BERISHA

Nga fusha e Shkencave Juridike janë botuar këta tituj:
- **"E drejta familjare"** , autor Hamdi PODVORICA
- **"E drejta trashëgimore"**, autor Hamdi PODVORICA
- **"Draftimi i Kushtetutës – Manual për hartuesit e Kushtetutës"**, autor Arsim BAJRAMI
- **"Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë"**, autor Ramë BUJA
- **"E drejta e detyrimeve"** , autor Nerxhivane DAUTI
- **"E drejta kontraktuese –Praktikumi"**, autor Nerxhivane DAUTI
- **"E drejta me njohuri themelore të së drejtës afariste"**, autor Mehdi HETEMI (ribotim).
- **"Mbrojtja e tregut të lirë nga konkurrenca jolojale"**, autor Mehdi HETEMI

Nga fusha e Shkencave Ekonomike janë botuar këta tituj:
- **"Bazat e menaxhimit modern"**, autor Isa Tahiri, Afrim GOVORI
- **"Ndërmarrja dhe ekonomia e tregut"**, autor Isa TAHIRI
- **"Bazat e informatikës"**, autorë Naim BRAHA, Faton MEROVCI
- **"Analizë matematikore"**, autorë Naim BRAHA, Islam SHEHU
- **"Drejtimi dhe strategjia e marketingut"**, autorë Liljana ELMAZI, Shaip BYTYQI
- **"Shërbimet e Marketingut"**, autorë Liljana ELMAZI, Shaip BYTYQI
- **"Drejtim marketingu"**, autorë Liljana ELMAZI, Shaip BYTYQI
- **"Bazat e biznesit"**, autor Zeki BEJTULLAHU
- **"Menxhmenti dhe menaxhimi i biznesit"**, Zeki BEJTULLAHU

Nga fusha e Shkencave Kriminalistike, Shtëpia botuese AAB, ka botuar mbi 30 skripte e dispensa për studentë.

Nga fusha e Shkencave Filologjike, Shtëpia botuese AAB, ka botuar monografinë **"Krijimtaria letrare e Mirko Gashit",** autor Bujar Tafa

Po ashtu, Shtëpia Botuese AAB boton edhe revistën studentore AAB.

Të punosh dhe të studiosh

Majlinda dhe Behrami ia dalin me sukses

Të gjesh punë sot në Kosovë është shumë e vështirë. Por, Majlinda dhe Behrami kanë një vend pune dhe njëkohësisht arrijnë të ndjekin edhe studimet universitare. Është mjaft e lodhshme, por ia dalin...

Liridona Hyseni

Majlinda Ademi

Behram Behrami

Të studiosh dhe punosh njëkohësisht nuk është shumë e lehtë, por Majlinda dhe Behrami ia dalin, madje me shumë sukses. Ata ruajnë vendin e punës, gjetja e të cilit sot në Kosovë është bërë tepër e vështirë.

Të dy kanë gjetur ofertën e favorshme të AAB-Riinvestit, i cili universitet u mundëson atyre që t'i ndjekin ligjëratat pa u shkëputur nga puna.

Majlinda Ademi fillon rrëfimin duke treguar se është në marrëdhënie pune dhe studion në të njëjtën kohë, pa humbur gjë nga puna që ajo kryen. Majlinda punon në GrandStore në këndin e lojërave për fëmijë dhe studion Komunikimin Masiv në AAB-Riinvest.

Puna e saj kërkon shumë vullnet, dëshirë për të qenë sa më e afërt dhe e dashur me fëmijët dhe përkujdesje ndaj tyre. Ka disa vite që Majlinda merret me këtë punë dhe me shumë qejf tregon për emocionet që fëmijët në punë ia ofrojnë.

"E bëjë me shumë dëshirë këtë punë, kur jam më fëmijët kënaqem aq shumë me ta saqë i harroj shqetësimet që kam në moment të caktuara, prandaj edhe kur punoj shumë nuk e ndjej lodhjen".

Në tetorin e vitit 2009 Majlinda filloi studimet duke e shfrytëzuar ofertën pa shkëputje nga puna. Këtë nevojën për të studiuar dhe dëshirën për t'u marrë me atë që ajo e quan profesion të ëndrrave e plotësoi tek ky universitet që po studion.

Universiteti AAB-Riinvest ofron dy mundësi, për të mbajtur ligjëratat e njëjta para dhe pas dite. Kështu që studentët e punësuar mund t`i ndjekin ato varësisht edhe nga orari i punës. Për Majlindën duket se nuk është fare problem ndjekja e ligjëratave të rregullta pasi që ka gjetur mirëkuptim në punë dhe i përshtatet mirë orari i universitetit.

"Dua të përmend faktin se kam dy vite që jam në këtë universitet dhe nuk kujtoj që më ka humbur ndonjë ligjëratë për shkak të orarit të papërshtatshëm të punës".

Në këtë aspekt ekzistojnë edhe alternative e mbajtjes së ligjëratave shtesë nëse studentët e ndjejnë një nevojë të tillë. "Kur në ndonjë lëndë mësimore apo ndonjë temë të caktuar nuk kemi pas kohë ta shtjellojmë mjaftueshëm,universiteti në bashkëpunim me profesorët na mundësojnë edhe orë të tjera plotësuese. Gjithmonë ekziston një mirëkuptim në raport me studentët.

Majlinda gjen kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur për seminaret dhe provimet, duke e shfrytëzuar edhe bibliotekën e Fakultetit, ku gjen literaturën e nevojshme. Për të është shumë i rëndësishëm është koordinimi i kohës, pasi që ajo pas ligjëratave qëndron në bibliotekë deri sa i vjen orari i punës. Nuk ka problem as me transportin. Ai është falas nga universiteti ku studion dhe gjithmonë është në kohë, në punë dhe në fakultet.

Pas të gjitha këtyre përpjekjeve, për Majlindën nuk mungojnë sukseset.

"Mendoj se të gjitha këto detaje por edhe dëshira për të studiuar profesionin e ëndrrave të mia kanë qenë çelësi im i suksesit që të përfundoj provimet e tre semestrave në kohë", tha ajo.

Behram Behrami është një student tjetër i punësuar por edhe që studion në Universitetin AAB-Riinvest. Ai tregon për vështirësitë që atij i shfaqen në mbajtjen e ligjëratave me rregull, për shkak se i duhet të punojë me orar të ndryshuar një javë para dite dhe një javë pasdite. "Unë problem kam atëherë kur ligjëratat që mbahen paradite mund të mos mbahen të njëjta me ato të pasdites".

Në këto raste atij i duhet të bëjë më shumë hulumtime për të mos i ikur gjërat kryesore të ligjëruara. "Nëse nuk kam mundur t`i ndjek ligjëratat, ndonjë ditë mundohem të marr sa më shumë shënime dhe përmes internetit nxjerri informata të tjera në lidhje me atë temë që është trajtuar".

Vështirësi për Behramin është edhe presioni i kohës në përmbushjen e obligimeve që ka para vetes. Atij i duhet shumë herë të ngutet për të arritur me kohë në punë ose në fakultet.

Objekti i punës shumë herë shndërrohet edhe në bibliotekë të improvizuar, jo për të krijuar një pamje të re, por për të shfrytëzuar qoftë edhe shumë pak minuta për lexim. Kjo ndodh shumë shpesh në kohën e provimeve.

"Seminareve dhe provimeve mundohem t`u kushtoj rëndësi dhe kohë aq sa kam në dispozicion. Nganjëherë edhe në orarin e punës marr material mësimor dhe e shfletoj".

Për studentët pjesa më e preferuar e studimeve mbetet praktika, gjatë të cilës ata përballen me realitetin e vërtetë të profesionit të cilin e studiojnë. Behrami nuk po arrin të gjejë kohë të mjaftueshme për t`iu përkushtuar sa duhet kësaj pjese.

Me shpresën se i gjithë ky mund do të shpërblehet në të ardhmen dhe përpjekjen për t'u aftësuar sa më shumë në këtë profesion- përfundon bisedën Behram Behrami.

Ish-studentët e AAB-Riinvest mposhtin konkurrencën - tani të suksesshëm në tregun e punës

Krenohen me studimet e kryera

Albulenë Stublla tani punon si inspektore Tatimore në Administratën Tatimore të Kosovës, ndërsa Diana Maliqi, gazetare në Radio Kosovë, e diplomuar gjithashtu në Universitetin AAB-Riinvest. Thonë se ndjehen të privilegjuara me studimet që kanë kryer

Kaltrina Cana - Delija

Diana Maliqi

Universiteti AAB Riinvest konsiderohet njëri ndër universitetet më të suksesshëm privat në Kosovë, pos kushteve të mira që jep, jep edhe mundësi zgjedhjeje për të studiuar degën e dëshiruar, siç janë: Komunikimi Masiv, Ekonomi, Juridiku, Gjuhë Angleze, Kriminalistikë etj,. Prej tij, gjithashtu kanë dal në pah shumë gjenerata të reja, të suksesshme dhe të cilët kanë vende pune kyçe nëpër bankat, institucionet publike, mediet, qeveri, organizata të ndryshme etj.

Njëri ndër ata studentë të suksesshëm ka qenë edhe Albulenë Stublla, ajo ka studiuar dhe ka diplomuar në Universitetin AAB Riinvest – dega Ekonomi.

Albulena, është 24 vjeçare dhe punon si Inspektore Tatimore në Administratën Tatimore të Kosovës. Duke folur në pika të shkurtra për Universitetin AAB Riinvest, ajo nuk lë pa përmendur se sa e kënaqur është me kushtet dhe punën që ky universitet i ka ofruar asaj.

"Jam tepër e lumtur që kam pasur mundësi dhe rast të studioj në këtë universitet, AAB ka treguar efikasitetin e tij. Edhe pse në moshë të re, diplomimi prej këtij universiteti më ka dhënë rastin të kem një punë të mirë dhe gjithashtu edhe shumë raste të tjera."

Albulena shpreson, që gjeneratat e reja të këtij universiteti të kenë mundësi të jenë edhe më të suksesshëm. Ajo, po ashtu pretendon që në vitin e ardhshëm të fillojë masterin në këtë universitet. Albulena mendon, që fillimi i masterit, është një shans për të arritur diçka më shumë në jetë. "Unë, po mendoj që vitin e ardhshëm të filloj masterin. Mendoj që do më jep edhe më shumë raste të reja në aspektin e karrierës dhe punës." – pohoi Albulena.

Albulenë Stublla

Çdo gjeneratë që ka diplomuar në këtë universitet, ka arritur të jenë në shkallën e suksesit. "Po të më të jepej prapë rasti për të studiuar në ndonjë degë tjetër, nuk do të hezitoja, prapë do zgjedhja Universitetin AAB" – theksoi Albulena.

Diana Maliqi, gazetare në Radio Kosova – e diplomuar në Universitetin AAB – Dega Komunikimi Masiv, ndihet e privilegjuar, për faktin që ka qenë studente e këtij universiteti. "AAB më ka dhënë mundësinë për t'u bërë gazetare profesioniste, edhe pse këtë punë e punoj shumë më herët. Mendoj, që studimi në këtë universitet më ka bërë më profesionale në fushën e gazetarisë, por gjithmonë duke i përfshirë profesionistët të cilët ligjërojnë në këtë universitet. Pa ata nuk do të kisha qenë këtu ku jam sot, dhe gjithashtu të flisja me kaq fjalë miradije." – tha Diana.

Gjithashtu, Diana shpreson që në të ardhmen të dalin edhe shumë gjenerata të reja të suksesshme nga ky universitet.

Prishtina e "makiatove"

Edhe pse thuajse aspak e konsumuar brenda nëpër shtëpi, me çmim të favorshëm apo jo dhe pa marrë parasysh nëse është shprehi apo preferencë, makiato ka zënë vend në shumicën e tavolinave nëpër lokalet tona

Besim Rama

Me pak kafe të presuar, ujë të nxehtë dhe qumësht, bëhet pija më e kërkuar në Kosovë, e quajtur "kafe makiato" apo vetëm "makiato". Kjo pije italiane edhe pse nëpër botë ka evoluuar dhe shërbehet në mjaft forma të ndryshme, te ne mbetet vetëm forma klasike e saj, por mbetet pija më e popullarizuar në vend. Preferencat janë të ndryshme: e rëndë, e lehtë, me shkumë, pa shkumë, me pak sheqer, me shumë sheqer, por prapë pija mbetet e njëjtë - makiato.

Në një lokal të zakonshëm mund të shohësh gjithmonë shumicën e klientëve duke pirë makiato. Duhet vetëm të zgjedhësh se si e dëshiron.

"Makiato është pija e preferuar e shumicës së mysafirëve edhe këtu ku punoj tani, por edhe në restorantet e tjera në të cilat kam punuar më herët", thotë Mimi, kamerier në një restorant në Prishtinë. Për më tepër ai i jep edhe përshtypjet e tij sa i përket kërkesës së klientëve. "Në të shumtën e rasteve nuk më duhet të dëgjoj se për ç'farë lloj pije është kërkesa. E tëra që dëgjoj është "e madhe" ose " e vogël" dhe automatikisht dihet se për çka është fjala".

Por, jo saktësisht të njëjtin mendim me Mimin e ka edhe Bledi, një qytetar nga Prishtina. Ai pohon të jetë konsumues i rregullt i makiatos, por arsyet për këtë i sheh më shumë te shprehia sesa te preferenca.

"Unë pi shumë makiato në ditë. Të paktën tri ose katër, por nuk është se jam aq i dhënë pas kësaj kafeje ose se më pëlqen aq shumë sa s'bën pa të. Disi edhe mua dhe shumë njerëzve që unë i njoh, na është bërë si shprehi që sa herë të ulemi diku, fjala e parë, ndoshta edhe më e lehta është 'makiato'", tha ai.

Shpeshherë e quajtur "pije studentësh" ose "pije fukarash", makiato nuk është se dallon nga çmimet e pijeve ose edhe kafeve të tjera në vend. Nga 50 centë deri 1 euro dhe makiato konkurron me thuajse të gjitha pijet e tjera joalkoolike.

"Nuk është se çmimi e favorizon kërkesën e madhe të makiatos, sepse në shumicën e lokaleve makiato ka çmim të njëjtë me pijet e tjera", thotë Donika, një studente nga kryeqyteti. "Për mua është thjesht një emër që më ka hyrë në kujtesë dhe sa herë e shoh kamerierin, më del para syve 'makiato'", thotë duke qeshur.

Edhe pse thuajse aspak e konsumuar brenda nëpër shtëpi, me çmim të favorshëm apo jo dhe pa marrë parasysh nëse është shprehi apo preferencë, makiato ka zë vend në shumicën e tavolinave nëpër lokalet tona.

"Një makiato të madhe pa shkumë, të lutem"!

Ajo...

Nganjëherë lodhet duke i numëruar sa kishte fituar, e nganjëherë nuk i numëron fare dhe i përplas për muri të hollat që fitonte në lokalin me drita dhe me një shkop në mes...

Drilon Pulaj

Priste në radhë që IOM-i (Organizata Ndërkombëtare për Migrim) ta kthejë në vendin e saj. Në këto çaste të fundit të qëndrimit të saj në Kosovë, nuk ngurron të kujtojë ditën e parë të ardhjes në shtetin më të ri në botë. Thotë se atë ditë shiu rrebesh posa kishte pushuar dhe njerëzit që përkohësisht ishin strehuar nën çatitë e dyqaneve tani po shpejtonin që të mos i zinte furia e re që dukej sikur nuk po vononte. Gjëja e parë që asaj i kishte lënë përshtypje ishte lëvizja e njerëzve, e makinave dhe e minutave që sa hap e mbyll sytë lëviznin me një shpejtësi marramendëse. Nuk ishte se këtu lëvizte ora më shpejtë se nga vendi ku kishte ardhur, por e bënte të lëvizte më shpejtë nga dinamika e lëvizjes së njerëzve në rrugët e këtij kryeqyteti të ri.

Pasi kishte marrë autobusin dhe kishte vajtur në adresën që e mbante në dorë të shënuar në një copë letre të vogël, kujton se kishte hyrë brenda dhe papritmas i është shfaqur një njeri, ku nga pikëpamja e parë nuk ishte nga ata mikpritësit që asaj ia kishin premtuar. Iu dha një urdhër të ulej në një divan dhe të tregonte gjithë gjërat që kishte me vete. Ajo shpalos çantën dhe tregon ca të holla, një pasaportë moldave, ku të dhënat e saj tregonin që vinte nga një fshat i vogël e i prapambetur në Moldavi. Sa për t'u parë ishte një mrekulli e tërë, sytë gri i shndrisnin dhe ishin të mbushura plot shpresë. Në përgjithësi ajo ishte e bardhë dhe e pastër si akulli, e lëmuar dhe e ngrohtë nga natyra.

Ai merr pasaportën e vajzës dhe në gjuhën e saj i thotë që duhet të shkonin me makinë të hanin darkë në një nga restorantet që ai preferonte. Pasi hipën në makinë, vajza me plot buzëqeshje tregon se si ishte përshëndetur me prindërit e saj dhe si ata ishin të lumtur që ajo po shkonte për herë të parë në një vend të huaj ku pritej të punësohej e t'i ndihmonte familjes.

Me të mbërritur te restoranti, ata hynë brenda, hanë darkë nga ushqimet tradicionale ku asaj i pëlqyen shumë. Kishte kaluar ora dhjetë e natës dhe ai merr atë, e nisen për në vendin ku ajo do të punonte në ditët e netët në vazhdimësi.

Së pari, mendon vajza e thotë me vete, në ora dhjetë të natës nuk di se në çfarë pune mund të jetë ajo, që fillon në mesnatë!

Pret që të njoftohet me ambientin e punës, me shefin, me kolegë e kolege të rinj. Kur zbresin nga makina aty pranë ndjehet një qetësi mesnate, ndërsa në këndin tjetër sheh një derë prej hekuri ku aty nga jashtë qëndrojnë dy njerëz të veshur me të zeza të cilët presin të kontrollojnë hyrjen e të gjithë njerëzve brenda.

"U tremba nga ngjarjet që pashë dhe e vetmja gjë që më shkoi ndër mend ishte se si të largohem nga ky vend i panjohur e i trishtuar, por nga t`ia mbaja kur nuk e dija se ku isha" - thotë vajza.

Burri i mrrolur e i cili e shoqëroi deri tek ai vend, bisedonte diçka me ata dy persona edhe më të frikshëm te hyrja e asaj ndërtese.

Për një moment ai bën me dorë nga vajza dhe e thërret që të takohet me ata persona që biseduan para pak kohësh mes veti. Ndërkohë, vajza pa që mbeti në duart e dy të panjohurve dhe vërejti që burri shoqërues largohej andej nga kishte ardhur. Të tre u futën brenda, kur ajo ç`të shihte, veçse zhurmë nga muzika e tmerrshme, errësira kishte mbuluar të gjitha anët e ndërtesës përbrenda, ndërsa ajo pa se shoqërohej nga drita të vogla lëvizëse e shumëngjyrëshe. Në pjesën tjetër të hyrjes pa që dhjetëra vajza shërbenin pije me e pa bikini, për njerëzit që ishin të ulur e prisnin ledhatime nga vajzat përreth.

Ajo tronditet e tëra dhe humb durimin. Fillon të bërtasë e të kërkojë llogari se ku e kanë sjellë, se nuk është prostatë, por nuk e dëgjon njeri.

Djemtë që e shoqëronin ishin të përgatitur që ajo të trembej dhe i japin një lëng ta pinte e të qetësohej. Pasi piu lëngun ajo u qetësua dhe çdo gjë që shihte i dukej normale. Me pastaj thotë se vetëm ka qeshur, pa ditur se përse.

Më pas e dërgojnë në një dhomë ku ka pasur disa rroba nate të ndryshme dhe një grua që dukej se do ta shoqëronte gjatë natës.

Gruaja e detyroi të pastrohej dhe të vishej me rrobat që ishin aty në një dollap. Vajza duket e qetësuar, e disponuar për gjithçka dhe del nga dhoma dhe fillon t`u shërbejë klientëve të tjerë që frekuentonin këtë lokal për dëfrye.s

Duke shërbyer pije me bikini asaj i ngjiten në trup të holla të bollshme dhe në fund kur të pranishmit nisin të dalin nga ky lokal nate, ajo fillon të kthjellet e të shikojë me vetëdije se ku ishte e çfarë po bënte.

Çdo ditë e çdo natë kishte mendduar të largohej nga ai vend që filloi t`ia shkatërronte jetën, por ajo çdo minutë kishte dikë që e shoqëronte dhe nuk kishte c`të bënte e nga t`ia mbathte. Megjithatë, fillon ta mbysë dyshimi: shihte që xhepi i saj çdo natë po mbushej e po stërmbushej me të holla, megjithëse duke parë gjithashtu se po i shkatërrohej jeta. Nganjëherë lodhet duke i numëruar sa kishte fituar, e nganjëherë nuk i numëron fare dhe i përplas për muri të hollat që fitonte.

Kur përmallohej për vendin e familjen e saj, ajo thoshte "Eh c`më bëri paraja"… Tani IOM-i po e kthen në shtëpi, pas një bastisje të policisë në vendin e saj të punës...

Anketa, maturantët përcaktohen për në AAB-Riinvest

Universiteti AAB-Riinvest është institucioni më i pëlqyer privat në Kosovë nga maturantët, duke konkurruar kështu me Universitetin publik. Ky është rezultati që ka dalë nga një anketë të realizuar në gjysmën e parë të muajit prill të këtij viti nga Kosovo News Network (KNN).

Nga maturantët e anketuar me pyetësor thuajse në të gjitha qytetet e Kosovës, 978 maturantë janë përgjigjur se studimet dëshirojnë t'i vazhdojnë në AAB-Riinvest, ndërsa vetëm 307 janë deklaruar për universitetet e tjera jopublike në Kosovë, ku nuk bën pjesë Universiteti Amerikan. Për Universitetin e Prishtinës janë përcaktuar 1029 respondentë, për atë Amerikan 249 dhe për universitetet e tjera 497.

Gjatë këtij hulumtimi me 3060 respondentë është vërejtur gjithashtu një dëshirë e studimeve edhe jashtë Kosovës. Në qytetet e Prizrenit dhe Gjakovës ka rënë në sy një përqindje e respondetëve të cilët janë përcaktuar për Universitetin e Tiranës si dhe, një përqindje e maturantëve në Ferizaj e Kaçanik të cilët parapëlqejnë Tetovën.

Në pyetjen se kush ndikon më shumë në përcaktimin e maturantëve se ku do të studiojnë, dominojnë përgjigjet për cilësinë. Më pas radhitet edhe çmimi, si dhe kushtet

që ofrojnë institucionet publike dhe jopublike të arsimit të lartë.

Ndërkaq, në një anketë online të KNN-së e cila është duke vazhduar, por në të cilën votojnë jo vetëm maturantë, ndryshimi i votave ndërmjet Universiteti AAB-Riinvest dhe atij të Prishtinës është shumë i vogël. Ky votim online mund të shihet në faqen: www.knninfo.com

Franshiza, studime unikate në Kosovë

Programi zhvillohet në gjuhën angleze në formatin e njëjtë me programet që ofrohen në Universitetin Anglez të Staffordshire, në dy drejtime. Në përfundim të studimeve studentët marrin diplomë angleze, por mund të transferohen në Angli edhe gjatë studimeve

Kaltrina Rexhepi

AAB-Riinvest këtë vit ka filluar edhe me një risi unikate në Kosovë, atë të studimeve të franshizës.

Programi i Franshizës, që nënkupton "Të studiosh në Kosovë dhe të marrësh diplomë angleze", ka nisur të zhvillohet në vitin akademik 2010/11 falë marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Sttafordshire University dhe Universitetit AAB-Riinvest.

Muhamet Mustafa, menaxher i Programit të Franshizës, thotë se marrëveshja e bashkëpunimit në mes Sttafordshire University dhe Universitetit AAB-Riinvest, është nënshkruar vitin a kaluar.

"Bashkëpunimi ka filluar qysh para 14-të viteve. Profesorët që ligjërojnë në këtë universitet, janë të huaj dhe vendorë. Të gjithë profesorët dhe asistentët vendorë janë me një diplomë masteri ose doktoraturë në Sttafordshire University "- theksoi Mustafa.

Programi zhvillohet në gjuhën angleze në formatin e njëjtë me programet që ofrohen në Universitetin Anglez të Staffordshire, në dy drejtime: Menaxhim Biznesi dhe Menaxhim Biznesi me Ndërmarrësi, në të cilin janë të rexhistruar 15-të studentë, tre të huaj, një nga Nigeria dhe dy të tjerë nga Maldivet dhe 12-të kosovarë.

Kurse Erza Pula, administratore e Programit të Franshizes, thotë se studentët kanë kontakte në mes veti dhe nuk ka ndonjë diskriminim etnik.

"Studentët janë shumë të afërm me njëri tjetrin, ata nuk kanë ndonjë dallim etnie për tre studentët e huaj, përkundrazi janë shumë të afërm me njëri tjetrin. Ata janë shumë të kënaqur me programin qe ofron ky universitet, si dhe me cilësinë e njëjtë me Universitetin Anglez që sjell ky program"

Kjo nënkupton se studenti i Franshizës në AAB-Riinvest ndjek plan-programet angleze, literaturën, provimet dhe sistem të njëjtë të vlerësimit. Universiteti Staffordshire monitoron cilësinë e këtyre programeve përfshirë mësimdhënien dhe vlerësimin.

Studentët gjithashtu kanë mundësinë që të vazhdojnë studimet e tyre në Angli në përfundim të cilitdo semestër apo vit akademik. Pas përfundimit të suksesshëm të studimeve, të cilat zgjasin tre vjet, studentët do të marrin diplomën Bachelor të lëshuar nga Universiteti Staffordshire në Angli.

Në grupin e franshizës studimet janë duke i ndjekur edhe disa studentë të huaj, madje edhe nga kontinente të tjera.

Makamed Haffau, student në programin e franshizës me prejardhje nga Moldavia thotë se është mjaft i kënaqur me programin e franshizës në Kosovë. "Këtu studentët janë shumë të mirë, gjithashtu edhe profesorët, dëshiroj t'i kaloj këtu tre vite studime, jam i impresionuar me këtë vend". Ndërsa bashkëvendësja e tij, Aishath Sha-ula, thotë se përveç që është e kënaqur me profesorët është shumë e kënaqur me kolegët e saj.

"Në Kosovë paska njerëz të mrekullueshëm. Ky popull qenka populli më i shoqërueshëm në tërë universin. Jam e lumtur që kam shansin të kem miq nga ky vend", tha Shaula.

Ndërsa, studentët nga Kosova janë shumë të lumtur me këtë ofertë që ka bërë AAB-Riinvesti. Ata thonë se për të marrë diplomë angleze, tani me ofertën e AAB-Riinvestit nuk kanë nevojë për shpenzime marramendëse për të shkuar në Angli. Ato mund t'i ndjekësh në Prishtinë dhe të marrësh diplomë angleze.

Ku mund të studioni?

Për Ne

Universiteti AAB-Riinvest është themeluar në bazë të marrëveshjes për integrim institucional me bashkimin e Universiteteve AAB dhe Riinvest, me qëllim të ofrimit të programeve cilësore studimore për një vend në zhvillim. Programet studimore të ofruara nga AAB-Riinvest kanë një profil të konsultuar me sektorin përkatës dhe palët e interesit si dhe marrin për bazë nevojën për arsimim tërëjetësor dhe forcim të komponentës hulumtuese në studimet e arsimit të lartë. Prandaj të gjitha programet e rregullta poashtu ofrohen për studentë pa shkëputje nga puna dhe ofrojnë një rast të veçantë për inkuadrimin në punën hulumtuese dhe në praktikë në institucionet dhe ndërmarrjet më të rëndësishme në Kosovë.

Aktualisht Universiteti AAB-Riinvest operon në 4 objekte në një hapësirë prej 32 000 m2 dhe ofron 21 programe në gjuhën shqipe në studime bachelor dhe master dhe 3 programe studimi në gjuhën angleze nëpërmjet marrëveshjes për franshizë me Staffordshire University nga Anglia. Ka një kampus në periferi të Prishtinës me qasje të rregullt në transportin e siguruar nga institucioni falas për studentët dhe mësimdhënësit. Në kampus ka hapësira rekreative dhe restoranteve për studentë dhe mësimdhënës. Ka një bibliotekë qendrore me salla leximi dhe salla kompjuterësh për lexim dhe studim. Ka një organizim të kërkimit shkencor dhe përkrahje të vazhdueshme të personelit për tu marrë me punë shkencore dhe projekte. Ka bashkëpunim stabil me industrinë, bizneset dhe shoqatat e tyre të cilat marrin pjesë aktive në përtëritjen e programeve studimore dhe në angazhimin e studentëve në praktikë. Përveç niveleve bachelor, master, Universiteti AAB Riinvest ka filluar edhe përgatitjen e programeve të nivelit certifikate dhe diploma për shkallë më të ulëta dhe specifike si dhe ofron programe të Universitetit të Staffordshire.

Fakulteti Ekonomik

Fakulteti Ekonomik i AAB – Riinvest-it, si njeri ndër Fakultetet më të mira jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon, ka qëllim primar që përmes programeve të veta studimore t'i zhvillojë te studentët shkathtësitë, që do ta ndërlidhin ekonomiksin, biznesin, menaxhmentin dhe teknologjinë informative si disiplina kryesore që ndërveprojnë në ekonominë globale dhe që luajnë një rol kyç në krijimin e aftësive esenciale për bizneset dhe organizatat e tjera. Përparësia jonë është mësimdhënia cilësore dhe hulumtimi që bëhen të mundura vetëm përmes zbatimit të një raporti efektiv mësimdhënës - student, qasje në teknologjinë e re dhe në resurset on-line, si dhe përkrahjes për studentin. Programet tona synojnë jo vetëm t'i riparojnë mangësitë e trashëguara nga sistemi i arsimit fillor dhe atij të mesëm, por po ashtu, t'i përgatisin studentët për një treg global e konkurrues. Komponenti hulumtues dhe përkushtimi për të garantuar cilësinë e programeve tona arsimore paraqet një përparësi konkurruese për AAB-Riinvest-in. Aktualisht në AAB-Riinvest funksionojnë 8 programe të Fakultetit Ekonomik: 4 programe bachelor:

- Ekonomiks Biznesi
- Banka, Financa dhe Kontabilitet
- Menaxhment dhe Informatikë
- Marketing dhe Administrim Biznesi

dhe 4 programe master:

- Financa Zhvillimore
- Tregjet Financiare dhe Bankat
- Menaxhment dhe Informatikë
- Ekonomi dhe Financa

Ekonomiks Biznesi

Aftësimi profesional dhe mundësitë

Studimet e Ekonomiksit të Biznesit fokusohen në bazat e mirëqenies sonë. Nga perspektiva e ekonomiksit e me fokus të veçantë në biznes, në këtë program studentët fitojnë njohuri të duhura për kuptimin e ekonomisë dhe ndërtojnë shkathtësi, të cilat u mundësojnë që me sukses të konfrontohen me problemet makroekonomike dhe mikroekonomike në sektorin privat dhe në atë publik. Metodat tona të mësimdhënies dhe puna e vazhdueshme e studentëve u siguron atyre dije të mjaftueshme për marrjen e vendimeve në institucione ekonomike dhe biznes. Pas diplomimit universitar, studentët do të jenë atraktivë për punësim në institucionet dhe bizneset vendore e ndërkombëtare dhe do të kenë performansa të larta për vazhdim të studimeve brenda dhe jashtë vendit.

Banka Financa dhe Kontabilitet

Aftësimi profesional dhe mundësitë

Ky program u ofron studentëve standardet më të larta ndërkombëtare në edukim në fushën e bankave, financave dhe kontabilitetit. Programi ynë do t'i ndihmojë studentët të ndërtojnë personalitetin e tyre me aftësi të fuqishme etike, analitike dhe shkathtësi në zgjidhjen e problemeve nëpërmjet mendimit kritik. Studentët do të jenë në gjendje t'i shohin sfidat e menaxhimit të bankave dhe financave nga perspektivat e ndryshme dhe të kenë njohuri të mjaftueshme mbi relacionin e bankave dhe sektorit financiar me disiplinat e tjera. Ky program do të ndërtojë një sistem të fuqishëm që do t'u mundësonte studentëve njohjen e potencialit të tyre si menaxherë të përgjegjshëm, që të mendojnë qartë, të gjykojnë mençur, të komunikojnë me efikasitet dhe të veprojnë me integritet gjatë gjithë kohës.

Menaxhment dhe Informatikë

Aftësimi profesional dhe mundësitë

Ky program u ofron studentëve standardet më të larta ndërkombëtare në edukim në fushën e Menaxhmentit dhe Informatikës. Ky drejtim eksploron konceptet e Menaxhmentit dhe Lidershipit nëpërmjet analizimit të situatave aktuale dhe fokusimin e zgjidhjeve në të ardhmen. Studentët do të fitojnë dije të mjaftueshme në menaxhimin e bizneseve, institucioneve financiare, menaxhimin me resurse humane, do të fitojnë dije të mjaftueshme për procesin e vendimmarrjes etj.

Marketing dhe Administrim Biznesi

Aftësimi profesional dhe mundësitë

Studimet e marketingut dhe administrimit të biznesit u mundësojnë studentëve që të fitojnë njohuri thelbësore të Marketingut, Ekonomisë dhe Biznesit. Studentët do të përcjellin module të veçanta dhe do të përgatiten me shkathtësi teorike dhe praktike me një fleksibilitet që stimulon aftësitë kreative të tyre. Vijuesit e këtij programi do të fitojnë dije e shkathtësi të nevojshme për promocionin, punë menaxheriale, kapacitetin për mendim kritik, komunikimin dhe aftësinë për zgjidhjen e problemeve, si dhe sjelljen ligjore dhe etike. Ky program, përmes edukimit të mirë për marketing me fokusim në kreativitetin global, po ashtu i përgatit studentët për karrierë të diversitetit në menaxhmentin global, në tregjet e reja që shfaqen, administrim dhe ndërmarrësi nëpërmjet teknologjive për organizim më të lehtë.

Fakulteti Ekonomik - Studimet Master

Pjesë e rëndësishme e punës së studentit për këtë nivel është teza hulumtuese për magjistraturë.
Përmbajtja e tezës hulumtuese duhet të ketë, përveç strukturës teorike të bazuar në literaturë relevante, edhe një studim empirik me të dhëna të përdorura nga studenti që dëshmojnë se studenti ka aplikuar metodologjinë përkatëse hulumtuese.
Nga studentët pritet që në fund të semestrit të tretë, në bashkëpunim me profesorin, të prezantojnë një propozim për hulumtim, i cili vlerësohet nga një juri profesionale e emëruar nga Komisioni për Hulumtime dhe Studime Postdiplomike. Komisioni do të propozojë një mentor i cili do të udhëheqë dhe mbikëqyrë studentin gjatë gjithë procesit hulumtues.
Teza e hulumtimit mbrohet para një jurie dhe studentët e kalojnë provimin nëse arrijnë 60 % të numrit maksimal të pikëve. Secili anëtar i jurisë, në mënyrë të pavarur, vlerëson tezën e paraqitur nga studentët.

Tregjet Financiare dhe Bankat

Aftësimi profesional dhe mundësitë
Programi ka për objektiv t'u ofrojë karrierë të suksesshme studentëve në sektorin financiar. Modulet, të cilat zhvillohen, ua mundësojnë studentëve, që të thellojnë dijet dhe njohuritë, si dhe të rrisin aftësitë e nevojshëm për lidership të suksesshëm në ekonomi dhe sidomos në financa dhe në sistemin bankar;
Programi veçanërisht u përshtatet studentëve që punojnë ose planifikojnë të punojnë në banka, investime, shërbime financiare, fonde pensionale, institucione të sigurimit, institucione të arsimit të lartë, në tregun e kapitalit, në financat në sektorin publik, edhe në organizatat joprofitabile, në bankat qendrore, qeveritë qendrore dhe lokale dhe në organizatat ndërkombëtare.

Menaxhment

Aftësimi profesional dhe mundësitë
Objektiv i përgjithshëm i këtij programi është të zhvillojë aftësitë analitike dhe strategjike, duke promovuar konceptet që derivojnë nga një fushë e gjerë e disiplinave akademike. Ky program ua mundëson studentëve të reflektojnë kreativitet dhe efikasitet dhe të sfidohen me rrethinën globale të biznesit. Studimet ofrojnë një rrjet integral konceptual dhe empirik për fusha gjenerike të menaxhmentit dhe biznesit.
Ky program është i përshtatshëm për studentët nga sektori privat, publik dhe organizatat joqeveritare, si dhe për ata që kanë nevojë të thellojnë dijet dhe kulturën ndërmarrëse për të ngritur dhe menaxhuar bizneset në të ardhmen

Fakulteti Juridik

Fakulteti Juridik është një nga ndërmarrjet e rëndësishme në AAB-Riinvest. Fakulteti ka nisur me programin e Kriminalistikës në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Kriminalistike të Universitetit të Sarajevës që ka qenë i pari program në Kosovë që ka nxjerrë të diplomuar me diploma të dyfishta – edhe nga AAB edhe nga Universiteti i Sarajevës. Më pas janë themeluar edhe programet Juridik i përgjithshëm dhe Administratë Publike me Diplomaci.

Aktualisht në AAB-Riinvest funksionojnë Programet e akredituara:
- Juridik (BA) me specializime në: Përgjithshëm; Kriminalistikë; Integrime Evropiane;
- Administratë Publike (BA) me specializimet në: Përgjithshëm; Shkenca Politike me Diplomaci dhe,
- Juridik Civil (MA).

Aftësimi profesional dhe Mundësitë
Në një shoqëri që përpiqet të ndërtojë institucionet e veta në të gjitha nivelet, juristët janë ata që e bartin barrën kryesore të ndërtimit të institucioneve dhe të administratës, në fakt të vetë shtetit. Së këndejmi, duke qenë të vetëdijshëm për këtë barrë të madhe, AAB-Riinvest i ka kushtuar rëndësi të veçantë përgatitjes së kuadrove të këtij profili. Programi synon kompletim teorik e profesional për implementimin e suksesshëm te strategjisë nacionale për jetësimin e standardeve evropiane dhe të përgjithshme ndërkombëtare në fushën e sundimit të ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, kuadrot e diplomuara në sistemin katërvjeçar të studimeve Bachelor sigurojnë perfeksionim profesional pragmatik në ushtrimin e detyrave nga fusha e gjyqësorit dhe prokurorisë, përkatësisht jetësimin në praktikë të konceptit bashkëkohor klinikal gjyqësor, aftësimin operacional juridik në lëmin e funksionimit të korporatave dhe shoqërive tregtare sot, zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve menaxhuese në fushën e së drejtës dhe luftimit të krimit
Ky program do t'u mundësojë studentëve kualifikime të vlefshme universitare, sidomos atyre që kanë për qëllim të marrin rolin udhëheqës në procesin e reformave në gjyqësi, përgatitjen e ligjeve dhe ofrimin e shërbimeve te qytetarëve në sferën e së drejtës civile dhe së drejtës sendore etj.
Programi Administratë Publike synon të mbledhë studentët më të mirë të interesuar në fushë të drejtësisë dhe të shkencave politike dhe administratës publike. Programi trevjeçar deri në diplomim për administratë publike është dizajnuar me qëllim që studentët, të cilët do të përfshihen në këtë program trevjeçar të fitojnë njohuri menaxhimi, këshilluese, politike, analitike, njohuri juridike, shkathtësi , aftësi dhe kompetenca.

Fakulteti i Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë`

Fakulteti i Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë është Fakulteti me traditën më të gjatë në Universitetin AAB-Riinvest. Aktualisht, në kuadër të këtij Fakulteti funksionojnë dy programe bachelor: 1. Gazetari dhe 2. Produksion, si dhe një program master –Gazetari. Të diplomuarit e këtyre programeve studimore janë kuadro të përgatitura mirë për punë të ndryshme që lidhen me komunikimin masiv me raportet publike, teknikën dhe teknologjinë e medies, marketingun, menaxhimin e medies etj. Këtu duhet kujtuar se AAB-Riinvest deri më tani është i vetmi institucion arsimor në Kosovë i akredituar nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës për studimet e Masterit në Komunikim Masiv dhe Gazetari.
Rreth 90 për qind e të diplomuarve aktualisht punojnë ose kanë punuar më mediat më të njohura në vend dhe jashtë, si në "Zëri i Amerikës", "RTK", "KTV", "RTV21", "Radio Dukagjini", si dhe në gazetat dhe agjencitë më të njohura ne vend. Gjithashtu një pjesë e studentëve që kanë kryer masterin po zhvillojnë karrierë të suksesshme në diplomaci.
Stafi mësimor është i kualifikuar dhe i pajisur me grada shkencore dhe akademike, të fituara në vend dhe jashtë, si dhe me përvojë pune në mediat më prestigjioze, si "BBC", "Evropa e Lirë", "RTK", "Top Channel" etj.
Gjatë studimeve, studentët kanë të gjitha kushtet për punë teorike dhe praktike në mjediset e fakultetit. Këtë vit ky fakultet ka objektin e vet brenda të cilit janë vendosur agjencia e lajmeve KNN, Radio AAB-Riinvest, Salla e montazhit televiziv, Salla e montazhit të radiogazetarisë, Salla e Produksionit etj., Kjo u mundëson studentëve që njëkohësisht me ndjekjen e ligjëratave, të bëjnë edhe punën praktike dhe të ndjekin edhe kurse shtesë profesionale në zhanre të ndryshme të gazetarisë.
Gjithashtu studentët kalojnë nëpër praktikë dyjavore apo njëmuajshe në televizionet dhe radiostacionet më të fuqishme të vendit.
Duke e pasur të zhvilluar komponentën shkencore për këto programe, Agjencia e Akreditimit e Kosovës ka përcaktuar diploma BSc dhe MSc .

Programi: Komunikim Masiv dhe Gazetari

Aftësimi profesional dhe Mundësitë
Programi Komunikim Masiv dhe Gazetari është një program i gjerë studimor që përfshin fusha nga media dhe marrëdhëniet publike. Të diplomuarit në këtë program studimor janë të përgatitur të punojnë si gazetarë, redaktorë, menaxherë mediash (drejtorë, kryeredaktorë, organizatorë, planifikues etj.), zëdhënës, zyrtarë për informim, ekspertë të marrëdhënieve me publikun, ekspertë të profilit publikë, këshilltarë për media, ekspertë marketingu medial etj. Stafi akademik me përvojë akademike dhe praktike në universitete dhe në media prestigjioze si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me mediat me prestigjioze të vendit, e bëjnë këtë program studimor edhe një hapësirë për krijimin e raporteve me botën e medias, qysh gjatë studimeve.

Rezultatet që garantojnë sukses
Gati 90 për qind e të diplomuarve në programin e Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë në AAB-Ri-

invest janë të punësuar. Shumica prej tyre janë drejtorë në medie të ndryshme, kryeredaktorë, redaktorë, gazetarë, zëdhënës insitucionesh e partish politike, zyrtarë për informim etj. Dhjetë gazeta të përditshme, tre televizione me frekuencë nacionale dhe dhjetëra të tjera lokale, si dhe rreth 100 radiostacione nacionale e lokale, pastaj qindra zyra për informim të institucioneve në nivel qendror dhe lokal, por edhe një treg i hapur për konkurrencë të lirë, janë garanci e suksesit.

Programi: Produksion

Aftësimi profesional dhe mundësitë

Programi për Produksion është një nga ofertat më ekskluzive në AAB-Riinvest, duke qenë program krejt unik jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. I mbështetur në kurrikulat e universiteteve më prestigjioze dhe me një staf akademik të kualifikuar dhe me rezultate konkrete, të cilët janë laureatë të shpërblimeve prestigjioze vendore e ndërkombëtare nga fusha e produksionit, Programi i Produksionit është një tundim dhe sfidë serioze për të rinj ambiciozë që janë të dhënë pas teknologjisë informative dhe mediale. Të diplomuarit në këtë program studimesh janë të përgatitur për të punuar si regjisorë programesh televizive e radiofonike, montazherë, producentë, kameramanë, ndriçues, dizajnues programesh e emisionesh televizive, producentë marketingu, ekspertë të fotografisë mediale dhe të fotografisë filmike, skenaristë për media etj. Pajisjet moderne që posedon Fakulteti i Komunikimit Masiv e që janë në shërbim të studentëve, bën që studentët përditë të jenë në kontakt direkt me materien që studiojnë, ndërsa marrëveshjet me mediet më prestigjioze vendore e ndërkombëtare sigurojnë që secili student gjatë studimeve të kryejë pjesën praktike në ndonjë nga mediet elektronike.

Programi Master – Drejtimi Gazetari

Gjatë tre vjetësh për të funksionimit programi Mastër në Komunikime Mediale dhe Gazetari është dëshmuar si një nga rrëfimet e suksesshme për AAB- Riinvest. Punimet serioze që kanë dalë si rezultat i hulumtimeve shkencore si dhe mbrojtjet publike shumë të suksesshme, e bëjnë këtë një drejtim me perspektivë, që përgatit kuadro të nivelit shkencor, të cilët përveç ekspertizës që fitojnë për hulumtimin e çështjeve dhe fenomeneve që kanë të bëjnë me gazetarinë, komunikimin publik, marrëdhëniet me publikun etj., përgatisin kandidatë seriozë për studime të mëtejshme në nivelin e doktoratës. Dhjetëra kandidatë që kanë fituar tashmë gradën master janë dëshmi e punës serioze dhe me përkushtim, ndërsa karriera që kanë ndërtuar bartësit e gradës master nga AAB-Riinvest është dëshmi e cilësisë së ofruar, por edhe e përzgjedhjes së kandidatëve për këto studime. AAB-Riinvest krenohet me faktin që bartësit e gradës MSc nga Komunikimi Masiv dhe Gazetaria po bëjnë edhe karrierë diplomatike, përveç karrierës shumë të suksesshme në mediat vendore e ndërkombëtare. Disa syresh aktualisht janë duke ndjekur studimet e doktoratës në Universitete të ndryshme në rajon dhe më gjerë.

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike – Inxhinieria Softuerike

Aftësimi profesional dhe mundësitë

Sistemet Softuerike janë shtyllat e bizneseve moderne. Këto sisteme janë komplekse dhe zhvillimi i tyre kërkon një kompetencë të madhe. Duke studiuar inxhinierinë softuerike në AAB-Riinvest studentët do të mbledhin njohuri konkrete të nevojshme për të dizajnuar, menaxhuar dhe për të zhvilluar me sukses çdo projekt kompleks softuerik. Kjo do të arrihet përmes aplikimit të metodave të avancuara në mësim dhe ndërlidhjes së fuqishme të teorisë me problemet praktike. Studentët do të kenë mundësi të angazhohen në zhvillimin e projekteve praktike inovative me qëllim të aplikimit të menjëhershëm në praktikë të teknikave dhe metodave teorike dhe të kreativitetit të tyre. Kjo do të garantojë një perspektivë më të madhe në zhvillimin dhe udhëheqjen e projekteve të mëdha e të vogla në çdo kompani të vendit dhe të huaj. Gjithashtu, studentët që përfundojnë këtë drejtim do të jenë të përgatitur për të vazhduar me sukses me studimet për master në Inxhinierinë Softuerike në Universitete të njohura botërore.

Fakulteti i Gjuhës Angleze

Ky është një program unikat dhe krejt i vecantë që për herë të parë organizohet në Kosovë, ndërkohë që as në rajon nuk ka një program studimesh të nivelit bachelor i cili përgatit ekskluzivisht përkthyes. Në kohën kur Kosova dhe Shqipëria janë në fazën përfundimtare në synimet e tyre për integrime evropiane, më shumë përkthyes të kualifikuar do të jenë të domosdoshëm për të përmbushur kërkesat institucionale të Kosovës, të Shqipërisë dhe të institucioneve evropiane. Misioni i këtij programi studimesh është pikërisht ky – përgatitja e kuadrove të domosdoshme për proceset aktuale nëpër të cilat po kalon dhe pritet të kalojë Kosovë. Së këndejmi, ky program, vërtet përgatit kuadro për të ardhmen dhe është ndër programet me më së shumti perspektive dhe më atraktive për tregun.

Aftësimi profesional dhe Mundësitë

Në këtë program studimor, kandidatët përgatitur për të dalë përkthyes profesionalë dhe të diplomuar për përkthime anglisht-shqip dhe shqip-anglisht. Gjithashtu, të diplomuarit në këtë program të akredituar nga Agjencia e Akreditim i Kosovës, sipas vlerësimit të ekspertëve ndërkombëtarë, mund të vazhdojnë studimet master për specializim të mëtejshëm në profile të ngjashme që lidhen me fushën e përkthimit. Stafi akademik me përvojë praktike në fushë përkthimesh si dhe me përvojë akademike të theksuar është garanci për cilësinë e studimeve, ndërsa marrëveshjet me universitete prestigjioze në Britaninë e Madhe, si Staffordshire University janë garanci e ndërtimit të një praktike serioze dhe efikase për studentët e këtij programi.

Kërkesa në tregun e punës për përkthyes të mirë nga anglishtja në shqipe dhe anasjelltas është aq e madhe, saqë qysh sot do të mund të punësoheshin me qindra të tillë.

Gjuha angleze, si gjuhë globale që tashmë është, është aktualisht pothuajse gjuhë e dytë në Kosovë. Në të ardhmen, ajo do të jetë e tillë edhe më shumë, si rezultat i zhvillimit dhe rritjes së saj politike, shoqërore, ekonomike, tregtare, kulturore e arsimore, diplomatike, sportive, teknologjike. Nevoja për të komunikuar me vendet, organizatat dhe institucionet e ndryshme rajonale e botërore, me të cilat Kosova ka dhe do të ketë marrëdhënie të mira në çfarëdo fushe veprimi qoftë, është e pashmangshme.

Fakulteti - Mirëqenie, Edukim dhe Kujdes ndaj Fëmijëve

Programi Mirëqenie dhe Kujdes ndaj Fëmijëve bashkë me programin e Përkthimit dhe Produksionin, është në mesin e programeve më të veçanta që organizon dhe është fokusuar sivjet AAB-Riinvest krahas programeve ekzistuese që janë të zhvilluara dhe të konsoliduara tashmë. Programi i Mirëqenies dhe Kujdesit ndaj Fëmijëve është krejt unik në tërësinë e tij dhe nuk ka një program të ngjashëm në Kosovë dhe në rajon. Është një program që ngërthen në vete edukimin e fëmijëve të moshave të reja, orientimin dhe përcjelljen e zhvillimit të tyre psiko-fizik dhe socializmin e tyre. Një vendi në tranzicion siç është Kosova, njerëzit e këtij profili i janë të domosdoshëm për të kapërcyer sa më lehtë dhe me sa më pak dhimbje procesin e transformimit shoqëror, ku fëmija është pasuria më e çmueshme dhe më e lëndueshme njëkohësisht. Konsolidimi i shtetit social krijon jo vetëm hapësirë, por edhe ngre nevojën e kuadrit të këtij profili që kujdesin profesional ndaj fëmijës do ta konsiderojë primar, ashtu si çdo shoqëri humane, fare pretendon të jetë kjo jona.

Aftësimi profesional dhe mundësitë

Programi Mirëqenie dhe Kujdes ndaj Fëmijës është program mjaft i veçantë i cili nxjerr kuadro të specializuara për përkujdes profesional ndaj fëmijës. Të diplomuarit janë të përgatitur për të punuar me fëmijët e niveleve të ndryshme, para së gjithash si edukatorë, si mbikëqyrës çerdhesh e kopshtesh, si dhe ekspertë programesh të ndryshme sociale në kuadër të institucioneve që merren më kujdesin ndaj fëmijës. Shoqëria perëndimore i kushton shumë rëndësi fëmijës, mirëqenies dhe rrjedhimisht edhe kujdesit ndaj tij. Kosova synon integrimet evropiane, që do të thotë vlerat e saj, humanizmin shtetin që kujdeset për qytetarët e tij dhe për fëmijët si pjesë e të ardhmes së shëndoshë. Në këtë kuptim, edhe institucionet e Kosovës po zhvillojnë programe për kujdesin ndaj fëmijës. Ekspertët e këtij profili janë të pazëvendësueshëm dhe shumë të kërkuar, jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon. Ky treg është hulumtuar me kujdes nga qendrat hulumtuese të AAB-Riinvest, përpara se stafi akademik të hartonte programin studimor dhe rezultatet dëshmojnë për një nevojë urgjente për ekspertë të kësaj fushe, të pajisur me dijen e mjaftueshme për kujdes ndaj fëmijës në institucionet ku aktualisht kjo bëhet nga njerëz që nuk kanë arsimim adekuat dhe të rregullt për këtë fushë të dijes dhe praktikës

Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit

Programi për Kulturë Fizike dhe Sport në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit në kuadër te Universitetit AAB- Riinvest tani e 3 vite ka vënë bazat e një tradite të mirëfilltë në edukimin e brezave të rinj në fushën e Kulturës Fizike dhe Sportive. Këtë vit akademik ky fakultet pret gjeneratën e parë e diplomantëve të cilët me zell e përkushtim janë pajisur me dijet e nevojshme në këtë fushë dhe janë të gatshëm që me dijet dhe shkathtësitë e fituara të japin kontributin e tyre për shoqërinë Kosovare.

Aftësimi profesional dhe Mundësitë

Ky program studimesh vazhdon që në gjirin e vet të rekrutojë të rinj e të reja, sportistë e sportiste të njohura të cilat me entuziazëm dhe shumë sukses I avancojnë shkathtësitë e tyre sportive edhe më tej dhe i pasurojnë me dije të nevojshme teorike në, mënyrë që të arrijnë kualifikimet e njohura ndërkombëtarisht si trajner dhe mësimdhënës të kulturës fizike.

Fakulteti posedon një infrastrukturë supermoderne me hallën sportive me dimensione për të gjitha lojërat, sallën speciale për gjimnastikë sportive dhe gjimnastikë ritmike, sallën e fitnesit të pajisur me mjetet e teknologjisë më të përparuar. Gjithashtu fakulteti posedon edhe me hapësirën e mjaftueshme të qendrës sportive ku përveç terreneve të hapura për të gjitha lojërat sportive, shtigjeve të atletikës posedon edhe pishinën moderne me dimensione olimpike.

Rezultatet që garantojnë sukses

Programet studimore të akredituara në nivelin Bachelor dhe Master, garantojnë krahasueshmëri ndër-kombëtare dhe njohje të diplomave si në vend ashtu edhe në të gjitha vendet e Evropës. Programet udhëhiqen nga profesorë vendorë dhe ndërkombëtarë të dëshmuar në fushën e Edukimit Fizik dhe Sportit.

Përveç dijeve teorike dhe praktike programi studimor i aftëson studentët edhe në aspektin e hulumtimit shkencor. Qendra për Hulumtim në Sport vazhdon bashkëpunimin e ngushtë me Qendrën Hulumtuese të Universitetit të Lubjanës dhe në mënyrë shkencore identifikon dhe trajton problemet aktuale të shoqërisë Kosovare në Lëmin e Sportit dhe në këtë mënyrë ka vënë themelet e para të iniciativave hulumtuese institucionale tejet të nevojshme për zhvillimin e ndërkombëtarizimin e sportit kosovar.

Në shërbim të studentëve

Që në hapin tënd të parë në Universitetin AAB-Riinvest, ti si student i ri do të kesh nevojë për informacionet themelore për aplikimin, regjistrimin, procesin mësimor e për procedurat e tjera për statusin tënd si student.

Për këtë gjithmonë përkujdeset Shërbimi i Studentëve.

Të vendosur në katin e parë të ndërtesës universitare, asistentët administrativë për secilin fakultet veç e veç, gjithnjë janë të gatshëm të të dalin në ndihmë për çdo kërkesë apo pyetje për të cilën do të kesh nevojë për sqarime.

Shërbimi i studentëve është në dispozicionin tuaj nga e hëna deri të shtunën në orar të plotë edhe atë duke filluar në orën 08.30 në mëngjes dhe deri në orën 20.00 të mbrëmjes.

Çështjet administrative të cilat i kryen Shërbimi i Studentëve:

- Provimet pranuese
- Regjistrimi i semestrit
- Oraret e mësimit, të kolokuiumeve dhe të provimeve
- Paraqitja e provimeve
- Vërtetimet për studime
- Certifikatat për provimet e dhëna
- Parashtrimi i kërkesave për bartjen e provimeve në raste transferimi
- Shpall rezultatet e provimeve
- Organizon konsultimet me profesorë
- Njoftimet e ndryshme për aktivitetet ne Universitet, etj.

Agjencia e lajmeve Kosovo News Network (KNN) vepron në kuadër të Fakultetit të Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë të Universitetit AAB-Riinvest **(www.knninfo.com)**

Kryeministri Thaçi, gjatë një ligjerate në AAB-Riinvest

Konferenca Ndërkombetare, pjesë e së cilës ishte edhe ambasadori amerikan Christopher Dell

Presidentja Jahjaga pranon Kupën e Kosovës të fituar nga volejbollistet e klubit "AAB-Riinvest"

Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu në AAB-Riinvest

Shtojca
MATURANTI

Maturantët në pritje të testit të maturës

Pasiguri dhe optimizëm për testin e pjekurisë

Përderisa maturantët dhe drejtorët e disa shkollave ankohen për neglizhencën e Ministrisë së Arsimit për parapërgatitjet dhe specifikat e testit të maturës, në këtë institucion thonë se nuk janë të interesuar për rritjen e përqindjes së kalueshmërisë, por për rritjen e cilësisë

Kanë mbetur edhe pak ditë deri në testin e maturës dhe përgatitjet mungojnë në shumë shkolla, ndonëse këtë vit pritet që pranimi i maturantëve në fakultet të bëhet vetëm me rezultatet e testit të maturës.

Kryetari i Këshillit Qendror Shtetëror të Maturës (KQSHM) Nehat Mustafa, thotë përgatitjet për testin e maturës kanë filluar qysh në mbarimin e maturës 2010-të dhe tani janë në fazën përfundimtare të tyre. Tani në prill dhe në maj, që sipas Ministrisë quhen muajt e sensibilizimit të maturantëve, do të jetë koha kur ata do të njoftohen më hollësisht me përmbajtjen e testit të maturës. Sipas Mustafës, testi do të jetë i lehtë dhe pyetjet do të jenë pyetje logjike dhe të gjithë ata që gjatë shkollës së mesme kanë mësuar për dije dhe jo për notë, do ta kalojnë këtë test pa ndonjë vështirësi. Pyetjet do të jenë të përpiluara nga një profesor universitar i cili do të merret me përmbajtjen shkencore dhe një profesor i shkollës së mesme, i cili do të merret me nivelin e pyetjeve.

Por, maturantët dhe drejtorët e disa shkollave të mesme në kryeqytet thonë Ministria e Arsimit u ka kushtuar shumë pak vëmendje për sa i përket testit të maturës.

Drejtori i gjimnazit "Xhevdet Doda" në Prishtinë, Azem Jaha, tregon se Ministria e Arsimit nuk ka sjellë asnjë përgatitje për nxënësit dhe se janë vonuar shumë, sepse testi po afrohet. Mirëpo, ai ka një shpresë se edhe nxënësit e kësaj gjenerate do të kenë një sukses të mirë ashtu si e kishin nxënësit e vitit të kaluar, të cilët, prej 513 maturantëve vetëm 11 prej tyre nuk kanë arritur të kalonin testin, që, sipas drejtorit, është një rezultat i kënaqshëm.

Por, një optimizëm të tillë nuk e kanë nxënësit e këtij gjimnazi, të cilët shprehen të shqetësuar. Erkënda Ajeti thotë se mosinformimi nga ana e institucioneve kompetente i bën të jenë edhe më të shqetësuar për testin e maturës, i cili do jetë pasaporta e vetme për të shkuar në universitet.

Maturantja Arjeta Dragaj thotë se janë duke u përgatitur në kurse të ndryshme, kurse disa të tjerë e presin kohën e fundit kur profesorët do t'i ushtronin, sepse shkuarja në kurse kërkon një buxhet shtesë, ndërsa disa prej tyre nuk kanë mundësi. E vetmja shpresë e tyre është universiteti privat AAB-Riinvest, i cili u ka ofruar kurse pa pagesë për përgatitjen e testit.

Më të pasigurt ndjehen maturantët e shkollave profesionale të cilat nuk janë informuar nga Ministria e Arsimit rreth specifikave të testit të maturës. Nxënësit e shkollës së mesme profesionale "Hoxhë Kadri Prishtina" thonë se janë të shqetësuar për këtë gjë dhe shprehen se viteve të mëparshme ka pasur më shumë përgatitje për testin e maturës. Antigona Hasani, maturante e kësaj shkolle, thotë se vetëm profesorët janë ata që i kanë drejtuar se ku kanë mundësi të përgatiten dhe ata janë të vetmit që i kanë informuar deri më tani. Ajo thotë se kjo është një padrejtësi, sepse ata gjatë shkollimit të tyre të mesëm do të kenë tre teste dhe kjo është një ngarkesë për ta.

Jahë Azemi, drejtor i shkollës së mesme profesionale "Hoxhë Kadri Prishtina", thotë se kanë filluar përgatitjen e nxënësve për testin e maturës, ndërsa Ministra e Arsimit nuk i ka informuar asgjë deri më tani. Ai thotë se përveç moskujdesit të Ministrisë, shkolla e tyre nuk e gëzon as interesimin e organizatave joqeveritare, që t'i përgatisë nxënësit për këtë test. Megjithatë, drejtori Azemi shpreson se edhe këtë vit nuk do mungojë suksesi i nxënësve të shkollës që e drejton pasi që vitin e kaluar e kishin kaluar 98 % e maturantëve.

Ndërsa, kryetarit të Këshillit Qendror Shtetëror të Maturës (KQSHM), Nehat Mustafa, thotë se Ministria nuk është e interesuar për rritjen e përqindjes së kalueshmërisë, por rritjen e nivelit mësimor dhe cilësisë. "Vetëm ata që kanë mësuar dhe mësojnë, do të kenë mundësi të vazhdojnë studimet universitare". Mustafa shpjegon se këtë vit përgatitjet kanë qenë më të mëdha dhe nuk do të ketë parregullsi, siç kanë qenë viteve të mëparshme nga ana e administruesve.

Këtë vit do të jenë mbi 4000 mijë administrues të cilët do të kujdesen që çdo gjë të shkojë sa më mirë.

Kaltrina Rexhepi

Lamtumirë shoqëri e dashur, ishim maturantë

Ndjej një dhimbje kur ulem pranë bankave... Të heshtur shikojmë njëri - tjetrin. Në mendjen tonë kujtojmë ca ditë të bukura kur luanim bashkë, kur shëtisnim bashkë, kur flisnim për matematikën, gjeografinë, letërsinë... Ah sikur të kthehemi edhe një herë nga fillimi!

Ditë të fundit, ditë të numëruara deri në ndarje. Po përjetojmë sfidën e parë të jetës, të cilën e kemi kuptuar në momentin kur të tjetër na quajnë "maturantë". Për ne fjala maturant ka kuptim jo edhe aq të mirë, sepse po e kuptojmë një ndarje, e çfarëdo ndarje që ndodh, asnjëherë nuk do të jetë e mirë , sidomos kjo ndarje që na është afruar në këto ditët e fundit të shkollës së mesme. Koha na kaloi shumë shpejt.

Më kujtohet dita e parë në këtë shkollë. Ishte e pakuptimtë. E ndjenim veten më të rritur, nuk njihnin njëri-tjetrin, bile as emrat nuk ua dinim. Tani në fund të kësaj periudhe mundohem të kuptoj se si u bë që këtë shoqëri që nuk kërkoja shumë ta njoh më herët, tani erdhi dita që të ndahemi e të qajmë nga kjo ndarje e dhimbshme. Ndjenjat që kisha për shoqërinë e kësaj periudhe po shuhen, sidomos ndjej një dhimbje të madhe kur ulemi pranë bankave të klasës e të gjithë të heshtur shikojmë njëri – tjetrin. Në mendjen tonë kujtojmë ca ditë të bukura kur luanim bashkë, kur shëtisnim bashkë, kur shkëmbenim mendime se si t`ia bëjmë për orën e matematikës, gjeografisë, flisnim për letërsinë, për dashurinë... Nganjëherë, nga dëshira që të rrinim sa më shumë bashkë, nuk përgatiteshim për këto orë mësimi të cilave tani po ua dimë se çfarë vlere kishin pasur. Ne që rrinim të heshtur, secili thoshim me vete: "Ah sikur të kthehemi edhe një herë nga fillimi"! Por, këtë shprehje e kuptuam që ishte vetëm një ëndërr. Tani po i bëjmë pyetje njëri - tjetrit se ku do t`na çojnë valët e jetës, nëpër universitete, nëpër punë të ndryshme apo, çka do të bëjmë më tutje?

Dikush me dëshirë pret të vijë dita e regjistrimit në ndonjë fakultet të cilin e ka pasur ëndërr qëmoti, dikush as që ka menduar të vijojë studimet dhe as që çan kokën për to. E, dikush pret të marrë diplomën e kësaj shkolle, të futet në ndonjë punë dhe të rrijë në shtëpi të krijojë familje. Por, që të gjithë ndjejnë "një shkëputje emocionale nga shpirti". Gëzimin dhe dëshpërimin e kishin ndarë bashkë.

Ne që po mendojmë të studiojmë në këtë të ardhme të afërt, shkëmbejmë mendimet se ku do të studiojmë. Dikush përmend degën e mjekësisë, dikush të ekonomisë, juridikut e dikush të gazetarisë. Në të vërtetë kjo është një ndarje e pakthyeshme, sepse secili tregon gatishmëritë e veta në degët e ndryshme. Këto degë vërtet ndajnë dhe krijojnë degë të tjera shoqërie. Me shoqërinë e vjetër do të shihemi vetëm rrugës kur ecim drejt të ardhmes tonë, e asnjëherë në bankat e shkollës si deri më tani.

Koha të ndryshon dhe mendojmë edhe për përgjegjësitë që do t`na shtohen. E dimë këtë nga të tjerët që tashmë kanë kaluar këtë fazë. E dimë edhe një gjë tjetër: Nuk do të jemi më siç ishim deri më tani!

Lamtumirë shoqëria ime e dashur! Ishim maturantë.

Drilon Pulaj

Matura dhe historia e saj

Mbrëmja e maturës është traditë e kulturës, arsimit dhe qytetërimit tonë e cila vjen pas përfundimit të shkollës së mesme.

Gjatë historisë, termi "Maturë" është përdorur zakonisht pasi nxënësi ka bërë 12 apo 13 vjet shkollim. Çdo kandidat që kalon provimet e tyre të fundit merr një dokument që përmban notat e tyre dhe i cili formalisht u mundëson atyre që të shkojnë më lartë, pra në një universitet.

Në Mbretërinë e Bashkuar ka këto shkallëzime vlerësuese në përfundimin e maturës: Advanced (Shkëlqyeshëm) që mund të ndahet në dy kategori, shkëlqyeshëm absolut (AAA), shkëlqyeshëm (AAB). Suksesi shumë mirë në këtë vend ndahet në dy kategori: ABB dhe BBB, e para me arritje më të lartë për suksesin shumë të mirë dhe e dyta për sukses shumë mirë, por me arritje më të ulët. BBC dhe BCC i përkasin suksesit "mirë" që tek ne kjo vlerësohet me notën (3) etj.

Në Hungari, provimi i maturës quhet ndryshe si "provim i pjekurisë", i cili vlerëson njohuritë në katër apo pesë vitet e fundit, gjegjësisht gjatë shkollës së mesme dhe mund të vlerësohet: shkëlqyeshëm (5), shumë mirë (4), mirë (3), mjaftueshëm (2), dhe ata që dështojnë (1).

Ndërkohë, në Poloni nuk është e detyrueshme kalimi i testit të maturës, që do të thotë se shkolla e mesme mund të përfundohet edhe pa kaluar testi i maturës. Kjo vlen për ata që nuk planifikojnë të vazhdojnë shkollimin. Secili student që synon të kalojë testin e maturës në Poloni, i cili njëkohësisht do të mund të regjistrohet edhe në universitetet e tjera evropiane, është e nevojshme t'i kalojë provimet, sipas standardeve, në këto degë:

1. Provimin e gjuhës (që përfshinë gjuhë dhe njohuri elementare për letërsinë e vendit).
2. Gjuhë të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht apo ruse) dhe,
3. Matematikë.

Në Itali, provimi i maturës quhet "L'esame di Stato" (Provim shtetëror), por zakonisht italianët e quajnë si "Diploma di..." (diploma e...) që nënkupton përfundimi i shkollës së mesme të lartë. Për ta kaluar testin e maturës në Itali, shkollat e kanë të obligueshme që të angazhojnë tre mësues të jashtëm dhe një kryetar komisioni, edhe ai i jashtëm.

Provimi i maturës në Itali ndahet në dy seksione: në test me shkrim dhe test gojor apo intervistë. Në testin me shkrim, është identike në mbarë Italinë që nxënësi duhet të shkruajë një ese të shkurtër, një artikull mbi një temë të caktuar, por ato gjithashtu mund të zgjedhin për të analizuar dhe komentuar në një tekst (zakonisht një poemë). Ndërsa, sipas llojit të shkollës, mund të kenë një shumëllojshmëri të testeve me gjëra të ndryshme të cilat mund të jenë të Pedagogjisë dhe Psikologjisë, Matematikës, gjuhë të huaja (latine, grek, angleze etj). Ndërsa faza e fundit e testit që në Itali e quajnë si "testi i tretë", është ajo e arritjes për katër lëndët kryesore të vitit të fundit për të cilat komisioni jep një vlerësim.

Ngjashëm është edhe në Austri, Slloveni e Bullgari.

Në Kosovë, para vitit 2006, maturantët kanë qenë të obliguar që në përfundim të shkollës së mesme të zgjedhin një temë nga një lëndë mësimore për ta bërë punim të diplomës i cili është kërkuar të jetë jo më i gjatë se 20 faqe. Prej vitit 2006, punimi i diplomës për maturantë është zëvendësuar me provimin e maturës. Tani maturantët, për të përfunduar shkollën e mesme, duhet të kenë dituri të përgjithshme, që do të thotë të jenë të përgatitur në të gjitha lëndët mësimore. Testi i maturës përfshinë 100 pikë dhe përfshinë pyetje nga gjuha shqipe, matematika, gjuha angleze, fizika, kimia, historia, biologjia, gjeografia, informatika, art etj.

Në Kosovë, iniciativa për reforma ka mbetur aty ku ka filluar në vitin 2006, që do të thotë risi e vetme është që më parë ka qenë Viti I, II, III dhe IV, ndërsa tani, shkolla e mesme është një vazhdimësi e fillores që do të thotë vazhdojnë: klasa e nëntë, e dhjetë, e njëmbëdhjetë e dymbëdhjetë dhe në disa degë edhe e trembëdhjeta. Risi tjetër është aplikimi i testit të maturës, që në shumicën e rasteve pyetjet e testit të maturës janë të njëjta edhe pse disa nga shkollat kanë probleme, sidomos drejtimet e reja në shkollat profesionale.

Përgatiti: Sabri Musliu

Kënga e maturës

Katër vjet bashkë i kaluam,
shkoll'n'e mesme e mbaruam,
maturantë jemi ba,
erdhi koha për me u nda.

Një shoqni kemi qenë në klasë,
një dashni ne kemi pasë
japim fund sot aventurës…
festojmë mbrëmjen e maturës.

Një këngë t'bukur po këndojmë
maturantët po festojnë
...Sot po ndahemi ne në pranverë,
A do të shihemi ndonjëherë?

Një këngë t'bukur po këndojmë
maturantët po festojnë
Lot në faqe na kanë mbet
a do të shihemi vallë në jetë?

Diplomat, nga lëkura deri tek ajo e letrës

Në lashtësi, diplomat janë bërë me lëkurë dashi, pasi që si letër nuk ishte shumë i fortë dhe ishte e vështirë për të krijuar.

Lëkura e dashit bëhej si një letër e hollë, në formë katrore mbi të cilën kishte informacione të cilat ishin të shkruara me dorë.

Për një kohë është përdorur lëkura për të bërë diploma, deri sa është vënë në përdorim letra ku kanë filluar të shtypen diplomat prej letre me format standard A4 (bëhet fjalë për diplomat e shkollës së mesme).

Një tjetër gjë interesante për diplomat është edhe mënyra se si u janë shpërndarë ato të diplomuarve. Më parë diplomat, me rastin e ceremonisë së diplomimit ishin mbështjellë, duke i zbukuruar me fjongo. Më parë, është praktikuar metoda se gjatë ceremonisë së diplomimit janë dhënë të tjera diploma, ndërsa diploma origjinale është dhënë disa ditë pas ceremonisë së diplomimit.

Diplomat, sipas sistemit arsimor të bazuar në modelin britanik, përmbanin notat e çdo lënde mësimore, sidomos në vitin e fundit.

Ndërkaq, shkollat evropiane përdorin sistemin e vet të diplomave, sistem ky që ndryshme quhet "Diploma Ndërkombëtare" (International Diploma). Kjo diplomë ka gjetur përdorim të gjerë edhe në disa shtete të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në SHBA, të gjithë nxënësit të cilët e kalojnë klasën e dymbëdhjetë, por që nuk i kanë përmbushur kërkesat për diplomim standard, nuk janë pajisur me diploma të shkollës së mesme, por ata marrin vetëm nga një certifikatë.

Disa shkolla të mesme në SHBA, për nxënës të dalluar ofrojnë diplomat më prestigjioze me të cilat nxënësit kanë më shumë mundësi që të vazhdojnë studimet në cilindo universitet dhe që e kanë më të lehtë të fitojnë bursa për studime.

S. M.

Matura është viti më i bukur i jetës, ruan kujtimet më të mira, gafat më të bukura, shakatë më të këndshme, të qara dhe të qeshura pa fund, zënka të përhershme, po në fund mbahen mend të gjitha si gjëja më e bukur që kemi përjetuar. (IV-B preca)

Maturantët, në pritje të mbrëmjes më gazmore

Kanë mbetur edhe pak ditë mësim deri në fund të vitit shkollor dhe tani shumica e maturantëve kanë filluar përgatitjet për mbrëmjen e tyre më të rëndësishme në jetë, atë të maturës.
Përgatitjet për këtë mbrëmje janë të ndryshme. Maturantët kanë kërkesa të shumta dhe ide të ndryshme nga njëri-tjetri, si për dukje, ashtu edhe për zbavitje. Kanë dëshirë që në këtë mbrëmje aq të rëndësishme për ta, të harrojnë çdo gjë, përfshirë edhe testin e maturës dhe regjistrimin e tyre në fakultet. Ata shprehen të entuziazmuar për këtë ditë të veçantë të jetës së tyre. Djemtë tregojnë se ku do t'i blejnë veshjet e tyre dhe si do të duken, ndërsa vajzat janë ato që mendojnë dhe brengosen më shumë. Thonë se përveç veshjes që sipas tyre do të jetë shumë e thjeshtë dhe me ngjyra ku do të dominojë e kaltra, e gjelbra dhe e zeza, një vëmendje të veçantë do t'u kushtojnë grimit dhe flokëve.
Mirëpo, ëndrrat për të ardhmen tani i kanë të qarta.

Nita Kelmendi, maturante në gjimnazin "Xhevdet Doda" në Prishtinë
Nita thotë së është përgatitur për maturë dhe dëshiron që t'i argëtojë Labinot Tahri i cili, sipas saj, bën muzikë të përshtatshme për maturë. Gjithashtu ajo shprehet së do të duket pak më ndryshe së herëve të tjera gjatë natës së hareshme të maturës.
Për studimet që e presin, ajo tashmë e ndarë mendjen: do të studiojë Kriminalistikën në Universitetin AAB-Riinvest.

Bardha Hoti, maturante e gjimnazit "Sami Frashëri" në Prishtinë
Për natën e përfundimit të shkollës ajo fustanin do ta ketë me ngjyra të çelura i cili do të jetë i gjatë. "Dëshiroj të jem një mbretëreshë atë natë", shprehet Bardha. "Flokët do t'i kem të lëshuara dhe një grim të thjeshtë, kurse për fatin tim të mirë do të këndojë Labi". Për studime të mëtutjeshme Bardha dëshiron të studiojë Gjuhën Angleze.

Vesa Simnica, maturante e gjimnazit "Sami Frashëri" në Prishtinë
Vesa thotë se tashmë i ka përfunduar përgatitjet për mbrëmjen e maturës. Ajo do të ketë një fustan të gjatë dhe me ngjyra të ndryshme; flokët do t'i ketë të dredhura dhe një grim natyral. Sa i përket universitetit, ajo thotë se do të regjistrojë drejtimin e farmacisë. "Jam e dashuruar në këtë profesion. Do të studioj për të, pa marrë parasysh çmimin e tij, ose këtu ose jashtë vendit".

Gentiana Sahiti dhe Shpend Spahija, çift në maturë
Do të hyjnë bashkë në mbrëmje dhe do të shoqërohen bashkë gjatë gjithë kohës. Gentiana do të ketë të veshur një fustan me ngjyrë krem i cili do të jetë i thjeshtë, ndërsa Shpendi do të jetë i veshur thjeshtë: një palë xhinse, setër të zezë dhe një këmishë ngjyrë të çelur. "Dëshiroj t'i përshtatem partneres dhe ta bëj që ajo të ndjehet si një mbretëreshë përkrah meje", thotë Shpendi. Ndërsa, Gentiana tha se për flokët dhe grimin do të kujdeset grimerja dhe parukierja e saj personale.
Mirëpo, pa marrë parasysh angazhimet rreth mbrëmjes së maturës, "çifti i gjimnazit" nuk ka harruar të mendojë edhe për të ardhmen.
"Do të studiojmë Komunikimin Masiv ose ma konkretisht Gazetarinë dhe ky do të jetë profesioni ynë në të ardhmen", thotë Gentiana.

Osman Beka, drejtori i Gjimnazit Sami Frashëri në Prishtinë
"Përgatitjet për festën e maturës kanë përfunduar. Gjithçka është gati për këtë mbrëmje. Kemi rezervuar Hotelin Grand në të cilin do të mbahet mbrëmja dhe për argëtimin e nxënësve do të këndojë Labinot Tahiri (Labi)", thotë Beka. Ai shpjegon se për përgatitjet e mbrëmjes janë angazhuar edhe kryesitë e klasave.
Mbrëmja do të mbahet me 16 dhe 17 maj për arsye të numrit të madh të nxënësve në këtë shkollë, afër 760 maturantë. Ai tregon se për sigurinë do të kujdeset sigurimi i hotelit dhe do të jenë të ndaluara pijet alkoolike.

Krenar Kaçiu, maturant në gjimnazin "Xhevdet Doda" në Prishtinë
Ende nuk është përgatitur për mbrëmjen e maturës, por atë natë dëshiron t'u këndojë Labinot Tahiri, i cili është këngëtari i tij i preferuar.
Pas maturës, Krenari dëshiron të regjistrohet në shkencat e kriminalistikës, në AAB-Riinvest ose në atë publik.

Nora Mushica, maturante në gjimnazin "Xhevdet Doda" në Prishtinë
Thotë se është përgatitur deri diku për mbrëmjen e maturës, ndërsa dëshiron që t'i argëtojë Sinan Vllasaliu. Për nga pamja, ajo dëshiron të duket sa më thjeshtë. Pas mbrëmjes së maturës, Nora thotë se do t'i përvishet seriozisht punës për t'u bërë regjisore.

Valmira Shillova, maturante në gjimnazin "Xhevdet Doda"
Tashmë është përgatit për mbrëmjen e maturës. Atë natë dëshiron të duket sa me thjeshtë dhe t'i argëtojë Labinot Tahiri. Pastaj do të konkurrojë për t'u bërë juriste, në Universitetin e Prishtinës ose në Universitetin AAB-Riinvest.

Istogu mes UP-së dhe AAB-Riinvestit

Avdyl Bajramaj, maturant në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog
Për mbrëmjen e maturës dëshiron të duket më i veçantë. Garderobën do ta blejë në Prishtinë. Jo diçka shumë speciale, por do të jetë modern. "Për frizurën do te kujdeset frizeri im personal", thotë Avdyli, ndërsa për muzikë ai dëshiron të këndojë Labinot Tahiri (Labi) ose Ramadan Krasniqi (Dani) dhe mbrëmja të mbahet në restorantin "Univers" në Pejë.
Nuk fsheh dëshirën se ku dhe çfarë do të studiojë. "E dua Gjuhën Angleze. Nëse nuk pranohem në UP për shkak të konkurrencës, do të regjistrohem në AAB-Riinvest".

Almira Sylaj, maturante në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog
Natën e maturës do të dalë me fustan të zi, të shkurtër. Do ta zgjedhë në kryeqytet. "Për dukjen dëshiroj të përkujdeset një frizer nga Peja, sepse për të shkuar në Prishtinë mendoj që është pak larg". Dëshiron që në mbrëmjen e maturës t'u këndojë Yll Demaj ose Labi. Almira ka menduar edhe për studimet. Ajo tashmë ka zgjedhur Gazetarinë në AAB-Riinvest për shkak të cilësisë më të madhe që ka, ose Filologjikun në Publik.

Ymer Lajmçi, drejtor i Gjimnazit "Haxhi Zeka" në Istog
Drejtori Lajçi thotë se mbrëmja e maturës do të mbahet ndërmjet 20 dhe 25 maj. "Matura është një ditë e shënuar. Maturantët po e përfundojnë një cikël të rëndësishëm të jetës së tyre dhe në bashkëpunim me kujdestarët dhe kryetarët e klasës do të organizojmë këtë ditë të rëndësishme për të gjithë maturantët".
Ndërsa, e vetmja vështirësi për shkollën e Istogut është se nxënësit dëshirojnë që mbrëmjen e maturës ta mbajnë në restorantin "Univers" në Pejë dhe kjo, sipas drejtorisë, po merr kohë dhe shkolla duhet të kujdeset për transportin e nxënësve.

Krenare Lokaj, maturante në Gjimnazin "Bedri Pejani" në Pejë
Thotë se që tani ka filluar me përgatitjet për mbrëmjen e maturës. "Kam zgjedhur dy fustane, por ende nuk kam vendosur se cilin do ta vesh, njëri do të jetë ngjyrë pembe dhe do të jetë i shkurtër, tjetri do të jetë i gjatë dhe ngjyrë të kaftë. Dëshiroj të dukem sa më thjeshtë", tha Krenarja.
Ajo dëshiron që mbrëmjen e maturës ta mbajë në restorantin "Univers" në Pejë dhe të këndojë Xhela. Ndërsa, për studime ende nuk është e sigurt se ku do të regjistrohet.

Flamur Shala, maturant në Gjimnazin "Bedri Pejani" në Pejë
Në dallim prej të tjerëve, Flamuri thotë se meqë do të jetë i shoqëruar nga partnerja, ngjyrat e veshjes do të jenë të njëjta me ato të partneres. "Dëshiroj të këndojë Labi dhe mbrëmja të mbahet në Prishtinë". Ai dëshiron të studiojë mjekësinë në të ardhmen, mirëpo nëse nuk pranohet, ai mendon të studiojë shkencat politike.

Maturantët e Fushë Kosovës nuk largohen, duan në AAB-Riinvest

Liridona Jashari, maturante e shkollës së mesme "Mihal Grameno" në Fushë Kosovë

Liridona thotë së ende nuk është përgatitur për mbrëmje, kurse për të kënduar do të dëshironte që t'i argëtonte Labinot Tahiri.

Për nga veshja dhe frizura, thotë së dëshiron që të jetë sa më thjeshtë, ndërsa do të studiojë Juridikun. Nëse nuk pranohet në universitetin e paguar nga taksat e qytetarëve, ai thotë se studimet do t'i ndjekë në Universitetin AAB-Riinvest.

Genta Pllana, maturante e shkollës së mesme "Mihajl Grameno" në Fushë Kosovë

Ajo thotë se tashmë është përgatitur për mbrëmjen e maturës. Por, në dallim prej të tjerëve, ajo dëshiron që t'i argëtojë këngëtarja Rifadije Grajçevci.

Sa i përket lukut, Genta thotë së dëshiron të duket shumë thjesht. Pas maturës do të konkurrojë për studime në Universitetin e Prishtinës në Ekonomik, ose në AAB-Riinvest.

Maturantët e Vushtrrisë nuk ndryshojnë mendje

Brunilda Hyseni, Gjimnazi "Eqrem Çabej" - Vushtrri

"Ende nuk jam përgatitur për natën e maturës. Ka ende kohë. Do të dëshiroja që ta kemi këngëtarin Xeni në natën e maturës, megjithëse si këngëtar më shumë më pëlqen Labi. Sa i përket përgatitjes, nuk e besoj se do bëj diçka speciale: do rregulloj flokët dhe do bëj një makijazh të thjeshtë". "Më pas, e kam ndarë mendjen: mendoj të regjistroj Edukimin në Universitetin AAB-Riinvest".

Kastriot Miftari, Gjimnazi "Eqrem Çabej" – Vushtrri

"Jam i përgatitur për mbrëmjen e maturës, që tani. Do të vishem me kostum me dukje klasike. Atë natë dua të na argëtojë Tuna, është këngëtarja ime e preferuar. Dhe, më pas na presin studimet. Unë për vete kam vendosur ose Matematikën në UP ose Shkencat Kompjuterike në AAB-Riinvest".

Ermirë Hyseni Gjimnazi "Eqrem Çabej"- Vushtrri

"Si këngëtar më shumë më pëlqen Sinan Vllasaliu, por në natën e maturës dua që të na këndojë Labi. Mendoj që veshja të jetë e thjeshtë, por me frizurë solemne".

"Sa u përket studimeve, mendoj ta regjistroj Fakultetin Ekonomik, drejtimi kontabilitet, në Universitetin AAB-Riinvest".

Ferizaji, disa në UP, disa në AAB-Riinvest

Adil Shabani, maturant i shkollës së mesme ekonomike "Faik Konica" në Ferizaj

Adili thotë se është duke u përgatitur për mbrëmjen e maturës. Për këngëtar dëshiron që ta ketë Sinan Vllasaliun, të cilin e pëlqen shumë. Pas maturës, ai mendon të studiojë degën e marketingut, apo menaxhment biznesi në UP ose në Universitetin AAB-Riinvest.

Gentiana Sherifi, maturante e shkollës së mesme ekonomike "Faik Konica" në Ferizaj

Gentiana ende nuk është përgatitur sa duhet për mbrëmjen e maturës, mirëpo thotë se ende ka kohë. Në mbrëmjen më të hareshme të shkollimit të saj të deritanishëm dëshiron të këndojë Labinot Tahiri, të cilin edhe e pëlqen më së shumti.

Gentiana dëshiron të duket sa më thjeshtë pasi që beson se ashtu do të duket më mirë. "Pas përfundimit të shkollës së mesme mendoj të studioj Gjuhen Angleze", tha ajo.

Ilir Kamenica, maturant i shkollës së mesme ekonomike "Faik Konica" në Ferizaj

Ende nuk është përgatitur për mbrëmje të maturës. Ai thotë se dëshiron që t'u këndojë Labinot Tahiri, të cilin thotë se e pëlqen shumë. Pas maturës, Iliri thotë se do të konkurrojë në Universitetin e Prishtinës në drejtimin Ekonomik, asistent financiar ose kontabilitet. "Nëse nuk pranohem në Universitetin e Prishtinës, atëherë do të regjistrohem Universitetin AAB-Riinvest".

Gjilanasit me shije të ndryshme muzikore

Egzon Maloku, maturant në Gjimnazin "Zenel Hajdini" në Gjilan

Egzoni dëshiron që të këndojë Ermal Fejzullahu në mbrëmjen e tyre të fundit të shkollës së mesme. I do shkencat politike dhe mendon të studiojë në UP ose AAB-Riinvest.

Eris Jashari, maturant në Gjimnazin "Zenel Hajdini" në Gjilan

Natën e maturës dëshiron ta kalojë me këngët e Labinot Tahirit, ndonëse i pëlqen Shaqir Cërvadiku. Dëshiron të bëhet jurist, në AAB-Riinvest ose në Universitetin Publik.

Amir Qerimi maturant në Gjimnazin "Zenel Hajdini" në Gjilan

Amiri e ka nda mendjen. Do të studiojë Juridikun në AAB-Riinvest. "Nuk do të provoj në UP, hiq. Në këtë universitet ka rregull dhe cilësi". Amiri thotë se ka dëgjuar nga të tjerë që ligjëratat në UP mbahen, siç thotë ai, sipas tekave të profesorëve, ndërsa ndodh që studenti të shkojë në provim disa herë dhe provimi të mos mbahet.

Ai është përgatitur tashmë për përfundimin e shkollës së mesme dhe dëshiron që ta shijojë edhe natën e fundit, atë të maturës. Atë natë dëshiron që t'i argëtojë këngëtari Labinot Tahiri.

Deçanasit duan kryeqytetin

Yjvesa Majtaj maturante në shkollën "Vëllezërit Frashëri" në Deçan

Për mbrëmjen e maturës ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura. Pretendon të regjistrohet në shkenca politike dhe gjuhen shqipe dhe ndihet shumë e emocionuar për testin e maturës. Këngëtari Labi është dëshirë e saj për mbrëmjen e hareshme të maturës.

Doruntina Tafilaj, maturante në Gjimnazin "Sami Frashëri" në Irzniq

Ka bërë përgatitjet për mbrëmjen solemne që do mbahet dhe që është fundi i natës qe i përmbyll katër vitet e shkollës. Labinot Tahiri është i preferuari i saj si këngëtar për mbrëmjen e maturës. Mendon të regjistrojë Gjuhë dhe Letërsi në kryeqytet. Nuk harron pa thënë se u uron sukses të gjithë maturantëve.

Bekim Mushkolaj, zëvendësdrejtor shkollën në "Vëllezërit Frashëri" në Deçan

"Përgatitjet për mbrëmjen e maturës janë bërë ndërsa edhe për këtë gjeneratë janë duke u bërë përgatitje për testin e maturës. Në këtë vit janë gjithsej 443 maturant të cilët do t'i nënshtrohen testit". Mushkolaj u uron suksese të gjithë maturantëve dhe inkurajon që të gjithë të vazhdojnë studimet universitare.

Maturantët e Prizrenit - në AAB-Riinvest

Gent Qafleshi, maturant në Gjimnazin "Gjon Buzuku" në Prizren

"Të gjithë jemi të përgatitur dhe me padurim po presim natën e mbrëmjes së maturës e cila do të jetë e paharrueshme. Do të jem sa më i thjeshtë dhe besoj që do të kalojmë sa më mirë", thotë Genti.

Sa për atmosferën e kësaj nate, ai dëshiron të kujdeset Labinot Tahiri. Studimet do t'i vazhdojë në Prishtinë dhe me shumë gjasë Gazetarinë, kuptohet në Universitetin më të vlerësuar cilësisht nga Agjencia Kosovare e Akreditimit, në AAB-Riinvest.

Alban Daka, maturant në Gjimnazin "Gjon Buzuku" në Prizren

Për mbrëmjen e maturës mendon të jetë i thjeshtë edhe në dukje. Paraprakisht është përgatitur dhe shpreson që për mbrëmjen e maturës të këndojë Sabri Fejzullahu. Mbrëmja e maturës do të mbahet në restorantin "Oferta" në Prizren.

"Më kanë folur për Universitetin AAB-Riinvest dhe me shumë shpresë do të vazhdoj studimet atje", tha Albani.

Diellza Elshani, maturante ne Gjimnazin "Gjon Buzuku" në Prizren

Dëshiron të jetë ekstravagante dhe e veçantë. Ka porositur veshjet në Shkup dhe mendon që është nata më speciale e deritanishme për të.

"Labinot Tahirin e kam për zemër dhe dua që ai 'ta kallë' atmosferën atë natë", thotë Diellza.

I pëlqen të studiojë në Universitetin e Prishtinës, por kushtet e UP-së e bëjnë që të ndërrojë mendje dhe të regjistrohet në një nga universitetet private. Këtu ajo veçon Universitetin AAB-Riinvest.

Maturantët gjakovarë edhe në Tiranë

Agon Batusha, maturant në Gjimnazin "Hajdar Dushi", Gjakovë

Ka bërë përgatitjet rreth maturës. Si këngëtar pëlqen që atë natë t'u këndojë Shkëlzen Jetishin-Xeni. Thotë se dëshiron të duket sa më elegant.

"Mendoj se do te regjistroj Fakultetin e Juridik në Tiranë, ndërsa të gjithë maturantëve u uroj suksese dhe plotësimin e dëshirave të regjistrimit në fakultet".

Labinot Haxhia, maturant në shkollën e mesme teknike "Nexhmedin Nixha" në Gjakovë

Tashmë i ka bërë përgatitjet e duhura për mbrëmjen e maturës. Këngëtari i pëlqyer është Edi Furra, të cilin tashmë e kanë prenotuar për t'u kënduar në mbrëmjen e maturës. Atë natë dëshiron të duket thjeshtë dhe sa më elegant. Për studimet tashmë është përcaktuar. "Do të studioj Shkencat politike në Universitetin AAB-Riinvest", tha Labinoti.

Vlorika Rexha, maturante në Gjimnazin "Hajdar Dushi", Gjakovë

Ende është duke u përgatitur për mbrëmjen e maturës. Si këngëtar e do

Xenin për mbrëmjen e maturës.
"Atë natë dua të dukem sa më thjeshtë dhe më elegante. Mendoj të regjistrohem në Fakultetin e Psikologjisë", tha Vlorika.

Nita Rezniqi, maturante në Gjimnazin "Hajdar Dushi" në Gjakovë
kam arritur të bej pergatitjet per mbremjen e matures , Shkelzen Jetishi-Xeni eshtë deshir qe të jetë ne mbremjen e maturës ,dukja thjeshtesia dhe eleganca do jenë paraqitje e imja , mendoj te studjoj Shkenca Kompjuterike dhe te gjithë maturanteve te mesojn sa me shumë dhe suksese në testin finalizues .

Egzon Kurhasani, maturant në shkollën e mesme ekonomike "Kadri Kusari" në Gjakovë
Thotë se ende nuk është përgatitur për mbrëmjen e maturës, i duket pak herët, ka ende kohë. Por, do të duket thjeshtë, elegant. Preferon që natën e hareshme t'u këndojë Xeni.
"Mendoj të studioj ne Banka,Financa kontabilitet", tha ai.

Elira Qurdina, maturante në shkollën ekonomike "Kadri Kusari" në Gjakovë
"Kam arritur të bëj përgatitjet e duhura për mbrëmjen e maturës. Do dukem thjeshtë dhe pëlqej Xenin". Elira mendon të studiojë për ekonomi.

Manuella Berisha, maturante në shkollën ekonomike "Kadri Kusari"
"Jam përgatitur për këtë natë solemne, do të duken thjeshtë dhe padyshim që do jetë një natë e veçantë. Këngëtari i pëlqyer është Shkëlzen Jetishi-Xeni". Manuella dëshiron të punojë në arsim. Do të regjistrohet në Fakultetin e Edukimit, siç thotë ajo, në njërin nga kryeqytetet shqiptare.

Maturantët e Mitrovicës, nëpër universitete të ndryshme

Dijar Istrefi, maturant në gjimnazin "Frang Bardhi", Mitrovicë
Dijari është në përgatitje e sipër. Këngëtar dëshiron ta këtë Xeni0n. Pëlqen Xenin. Nuk pëlqen të komplikohet, me kostume të hirtë. Mendon të studiojë Elektron në Universitetin e Prishtinës.

Artan Mustafa, maturante në gjimnazin "Frang Bardhi", Mitrovicë
Artani është duke përgatitur. Atë natë dëshiron që t'u këndojë Labi. Mendon të veshë pantallona të zeza me një këmishë të bardhë. Flokët do t'i rregullojë thjesht. Mendon të studiojë Ekonominë në AAB-Riinvest.

Erza Broja, maturante në gjimnazin "Frang Bardhi", Mitrovicë
Erza dëshiron ta ketë Gentian Gojanin, e pëlqen më shumë atë si këngëtar. Ka përgatitur fustanin ngjyrë blu, ndërsa flokët do t'i mbajë të mbledhura. Mendon të studiojë Juridikun në UP ose në "Fama".

Vlora Nuhi, maturante në gjimnazin "Frang Bardhi", Mitrovicë
Vlora po përgatitet. Këngëtar dëshiron ta ketë Xenin. Preferon të jetë sa me e thjeshtë në veshje. Ende nuk ka vendosur çfarë do të veshë. Do të studiojë Ekonomikun ose Juridikun në AAB-Riinvest.

Përgatitën: M. Neziri, K. Rexhepi, V. Tishukaj, D. Pulaj, B. Metolli, E. Hajrizi

Dani: Do të këndoj falas për maturantët

Këngëtari Ramadan Krasniqi (Dani), konfirmoi për gazetën se do të këndojë falas për maturantët. Ai tha se kjo ofertë vlen për maturantët e Pejës, Klinës, Deçanit dhe të Istogut.
"Do të u ofroj zërin tim falas për argëtim maturantëve të Dukagjinit" shprehet Dani. Ndërsa, për maturantët e vendeve të tjera të Kosovës ai thotë se nuk do të ketë kohë, sepse agjenda e tij është shumë e ngarkuar, duke marrë parasysh edhe kërkesat për mbrëmje të tjera rinore të cilat janë të shumta.

/K.R



"Grand Hoteli" pret maturantët

Hoteli Grand, si çdo vit tjetër, edhe sivjet i ka bërë të gjitha përgatitjet për mbrëmjet e maturës.
Menaxheri Albert Mirdita tha për gazetën se Grandi është njeri ndër hotelet me të mira që mund të organizohen mbrëmjet e maturave, duke i përmendur disa të mira që i ofron ky hotel.
Menaxheri Mirdita thotë se ushqimi është ai i cili përgatitet po atë ditë kur do të jenë prezentë maturantët në ndejën e tyre. E veçanta është se ushqimi do të jetë i cilësisë së lartë dhe gjithnjë do të përputhet me kërkesat e maturantëve. Sipas tij, edhe çmimi do të jetë i volitshëm për çdo maturant. Veçanti tjetër është së Hoteli Grand nuk servon alkool për maturantë, sepse me këtë ndeja është më e qetë dhe në këtë mënyrë shmanget ndonjë ekses.

M. Neziri

Mbrëmja, ëndërr e çdo maturanti

Ëndrra e maturantëve është që ta mbajnë mbrëmjen e maturës dhe që kjo natë të vijë sa më shpejtë. Ata e ëndërrojnë mbrëmjen që nga fillimi i shkollës së mesme dhe nuk mbaron deri në përjetimin e saj.
Tash kanë mbetur edhe pak ditë deri te mbajtja e ceremonive të maturës, ndërsa shumica e maturantëve i kanë zgjedhur ngjyrat dhe mënyrën se si do të duken. Ngjyrat dominuese janë: e kaltra, e gjelbra, e kuqja dhe si çdo vit nuk do të mungojë edhe e zeza. Vajzat, si çdo herë, janë më të kompleksuarat. Shumica e tyre do të veshin fustane të thjeshtë dhe të bukur, ndërsa flokët do t'i kenë të lëshuara, me kaçurrela dhe natyrale. Kurse, grimin do ta kenë sa më natyral, por që do t'i bëjë të duken të bukura dhe të veçanta.
Kurse, djemtë edhe ashtu vlerësohen si gjinia më e pakompleksuar, të thjeshtë dhe që nuk zgjedhin shumë. Shumica e tyre do të kenë të veshur pantallona, këmishë dhe një palltë të bukur, kurse për të tjerat nuk janë të interesuar fare. Ata dëshirojnë të jenë sa më natyral. Sipas tyre, kjo është natyra e meshkujve, "të thjeshtë dhe burrëror".**K.R.**

Në "Univers" edhe 20 vende falas për maturantët

Përveç maturantëve që kanë filluar përgatitjet për mbrëmjen e maturës, përgatitje të tilla kanë filluar edhe restorantet e Pejës, përfshirë restorantin "Univers" të cilin e parapëlqenin shumica e maturantëve pejanë.
Menaxheri i këtij restoranti, Sylejman Gashi, tha për gazetën se ata ofrojnë për maturantët një mbrëmje të paharruar me një hapësirë 1000 metra katrorë dhe me 700 ulëse, kurse konfiguracioni i tavolinave do të jetë në formë katrore dhe të rrumbullakët.
Menyja e këtij restoranti do të jetë sipas dëshirës së maturantëve, mirëpo "Univers" ofron edhe meny amerikane, ndërsa do të jetë e ndaluar shërbimi me pije alkoolike për shkak të problemeve që bëjnë maturantët.
Çmimi për maturantë do të sillet rreth 15 euro, mirëpo do të ketë një ofertë speciale për ata maturantë që nuk i kanë kushtet e mira ekonomike. Atyre do t'u ofrohet mbrëmja falas. "Për 20 maturantë nga Peja do të ofrojmë një mbrëmje mature falas për shkak se, siç dihet, kushtet ekonomike në vend nuk janë të mira dhe ne nuk dëshirojmë që ndonjë maturant të mos e përjetojë një mbrëmje të tillë shkaku i 15 eurove. Kjo ofertë do të bëhet në bashkëpunim me organizatorët e shkollës", tha Gashi.
Kurse, për argëtimin e nxënësve do të vendosin drejtoritë e shkollave në Pejë, përderisa një ofertë speciale e ofron edhe këngëtari Ramadan Krasniqi (Dani), i cili e ofron zërin e tij falas për maturantët e Pejës, ashtu siç e ka ofruar edhe viteve të kaluara.

/K. Rexhepi

Me pizhame dhe autoambulancë në mbrëmjen e maturës

Disa maturantë përveç që dëshirojnë të duken bukur dhe të veçantë në mbrëmjen e maturës, ata kanë edhe ide të "veçanta" për mjetin që do ta shfrytëzojnë për t'i dërguar ata deri te restoranti ku mbahet ceremonia.

Valon Dragusha maturant në shkollën e mesme ekonomike në Prishtinë tregon për idenë e tij se si të duket në mbrëmjen e maturës. "Do të jem shumë interesant, do të kem të veshura pizhame së bashku me partneren time. Besoj që edhe shokët e mi do të veshën në këtë mënyrë gjatë hyrjes në restorant, kurse aty do të ndërrohemi dh do t'i veshim kostumet solemne", tregon Valoni. Ai thotë se këtë vendim për këtë mënyrë të prezantimit në mbrëmjen e maturës e ka marrë që të duket sa më i veçantë nga të tjerët.

Ide të këtilla ka pasur edhe viteve të kaluara ku disa maturantë të shkollës teknike në Prishtinë kishin vendosur të shkojnë në mbrëmje të maturës me veturë të ndihmës së shpejtë dhe të veshur me uniformë doktorësh. Atë natë ndihma e shpejtë ishte afruar te turma e maturantëve pranë hyrjes së hotelit pa alarme. Në kohën kur maturantët hapën rrugën duke menduar se ambulanca kishte ardhur për të marrë ndonjë njeri të cilit i është përkeqësuar shëndeti, në ato çaste turma e maturantëve mbeten gojëhapur: nga autoambulanca dalin katër djem maturantë të veshur solemnisht të cilët ishin pjesë e asaj mbrëmje.

K. Rexhepi

Me ekskavator në maturë

Një paraqitje tjetër interesante e tre maturantëve, që la gojëhapur të gjithë ata që prisnin ardhjet "ekstreme", ishte mbërritja me ekskavator. Në "dorën" e ekskavatorit, i cili po afrohej me një shpejtësi të ngadaltë, kishin hipur tre djemtë e veshur me kostume të zeza elegante. "Dora" e ekskavatorit ishte tërësisht e baltosur, ndërsa ata kishin shfrytëzuar një çarçaf të bardhë për të mos u përlyer. Madhështorja e asaj ardhje ishte momenti kur ekskavatori ulte "dorën" për të mundësuar zbritjen e tre maturantëve, gjë që gjatë gjithë kohës duartrokitjet shtoheshin shumë e më shumë.

Kjo ishte ardhja më "ekstreme" në mbrëmjen e maturës, e menduar me një shije të veçantë.

M. Neziri

Matura, sallonet e ondulimit me oferta speciale

Arta thotë së sa i përket grimit, ndodh që i lyen duke u dhënë mendim se si do të dukeshin më mirë dhe kombinimin që duhet bërë me fustanin, grimin, frizurën.

Magi Neziri

Edhe këtë vit për maturantet do të ketë oferta të ndryshme për dukjen e tyre në natën më të veçantë. Disa sallone ondulomi kanë oferta të ndryshme, ato ofrojnë zbritje dhe gjithashtu dukje më të veçantë.

Salloni onduloni D & K, ofron për maturantet disa zbritje dhe ndryshime sa i përket dukjes së maturanteve.

Krenare Limani grimere e këtij salloni shpjegon për ndryshimet që do t'ju ofrojë salloni i tyre. "Këtë vit do të shprehim tamam atë që e dimë dhe e ndjejmë, ky është salloni ynë dhe nuk jemi të kufizuara se çka të bëjmë". Stili që do të ofrojë ky sallon do të jetë i thjeshtë, flokët do të jenë të lëshuara në formë të valëve, kurse grimi do të jetë me ngjyrë më zezë, kafe dhe pjepri, mirëpo do varet edhe prej asaj që kërkojnë klientët. Çmimi do të jetë i arsyeshëm dhe do të ketë zbritje. Për flokët do të jetë 15-20 euro kurse për grimin së bashku me qepallat do të jetë 20 euro.

Ndërsa, një ofertë më ndryshe e ofron salloni "Shuki" në kryeqytet. Ky sallon ofron zbritje për meshkuj dhe për femra. Gjithashtu ofron edhe një dukje më të veçantë nga vitet e kaluara. Ngjyrat që do të përdorin këtë vit janë më të thjeshta, por që tregojnë elegancë, ndërsa flokët do të jenë sa më natyrale. Çmimet do të jenë për femra nga 15 deri në 30 euro për grim, ndërsa për flokët do të jenë 20 deri 30 euro. Kurse, për meshkuj do të jenë më të lira dhe gjithashtu ofrojnë edhe grim profesional për meshkuj.

Ndërsa, në sallonet "Nagipi" dhe "Arta" shprehen së kanë rezervime të shumta nga maturantët, por kanë edhe çmime me të volitshme për dallim nga njerëzit e zakonshëm.

Pronarët Nagipi dhe Arta shprehen së dy vitet e fundit në modë janë flokët më valë - valë ose dredha që maturantët i preferojnë. "Tani me këto duket se i janë kthyer modës së viteve të 70-ta" tha Nagipi.

Arta shprehet së para disa viteve maturantët femra bënin frizura shumë të rënda dhe nuk dalloheshin shumë së në çfarë mbrëmjesh po shkonin, a po shkonin në dasma apo në mbrëmje të maturës. Por, tani kjo është e kundërta. Maturantët dëshirojnë që të duken sa ma thjesht aq më mirë.

Arta thotë së sa i përket grimit, ndodh që i lyen duke u dhënë mendim se si do të dukeshin më mirë dhe kombinimin që duhet bërë me fustanin, grimin, frizurën.

Të shkosh në sallonin e Nagipit apo të

Artës nuk të duhet shumë kohë që të qëndrosh aty ata të rregullojnë për 40-50 minuta dhe t'i do të shkëlqesh në natën e mbrëmjes së maturës.

Testi i maturës i vitit të kaluar (2010)

Gjimnazi i përgjithshëm

GJUHË SHQIPE

Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe përgjigjiu pyetjeve në vijim
"Nëpër këtë rrugë kam pasë ardhë nuse!", e theu dikur heshtjen tonë si të donte t'u japte fund mendimeve tona që na rëndonin dhe na këputnin mbas secilit hap si këmbët si shpresat. P'o zërin edhe atëherë nëna ime e kishte trishtues, edhe pse po fliste për dasmë.
Babai e shikoi si me habi.
"S'ma ka marrë mendja kurr se për herë të fundit e gjallë do të largohem nëpër të, për mos me u kthye kurr ma... Randë qenka me vdekë kështu! Ta marrim rrugën e humbjes e të dështimit...", foli idhtas.
Ndjeu një dobësim që ia futi të dy këmbët në dhe.
Gjyshja ia lëshoi një shikim të rreptë e qortues.
"Na qoftë rrugë e mbarë, nuse!" tha, po sikur të mos bindej as vetë për atë që e tha, ndërroi biseden."Qofshin burrat e...", po s'-mundi të përfundojë.
(Nazmi Rrahmani, Rruga e shtëpisë sime)

1. Vendin, si zonë gjuhësore, ku ndodh ngjarja e përshkruar mund ta kuptojmë nga fjalia:
A. "Na qoftë rrugë e mbarë, nuse!";
B. "Randë qenka me vdekë kështu!" ;
C. Ndjeu një dobësim që ia futi të dy këmbët në dhe. ;
D. Gjyshja ia lëshoi një shikim të rreptë e qortues.

2. Në fragmentin e mësipërm, nëna flet për:
A. dasmën e dikurshme ; B.vdekjen që u kanosej; C. braktisjen e vendit; D. dëbimin nga vendi

3. Folja në fjalinë: "Babai e shikoi si me habi", është në mënyrën:
A. dëshirore ; B. habitore ; C. dëftore ; D. urdhërore

4. Në fjalinë: *"Gjyshja ia lëshoi një shikim të rreptë"*, hasim mbiemrin në shkallën:
A. pohore ; B. sipërore ; C. krahasore të barazisë ; D. krahasore të ultësisë

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigjiu pyetjeve në vijim:
Neni 33
(1) Në qoftë se personi i njëjtë fajësohet për shumë vepra penale dhe për disa prej tyre është kompetente një gjykatë më e ulët, kurse për disa të tjera gjykata më e lartë, atëherë kompetente është gjykata më e lartë. Kur kompetente janë gjykatat e nivelit të njëjtë, kompetente është gjykata në të cilën së pari është ngritur aktakuza, ndërsa kur nuk është paraqitur aktakuzë, kompetente është gjykata të cilës së pari i është dorëzuar aktvendimi i vulosur i hetimeve
(2) Paragrafi 1 i këtij neni zbatohet, gjithashtu, për të caktuar se cila gjykatë është kompetente
në rastin kur i dëmtuari njëkohësisht ka kryer vepër penale ndaj të pandehurit.
(Ligji i Procedurës Penale i Kosovës)

5. Fragmenti i mësipërm ka tipare diskursive të shkrimit:
A. letrar ; B. gazetaresk ; C. kodifikues ; D. estetik

6. Periudha e parë në paragrafin (1), të këtij fragmenti, në bazë të mjeteve lidhëse, është periudhë me marrëdhënie:
A. lejore ; B. kushtore ; C. shkakore ; D. kundërshtore

Lexo tekstin e dhënë më poshtë pastaj përgjigjiu pyetjeve
"Mbrojtja e Interit ishte "nyja gordiane" për ekipin tonë", tha mbrëmë në Barcelonë trajneri i kuqekaltërve pas ndeshjes që ekipi i tij e fitoi me rezultat minimal kundër Interit, duke mos arritur të kalojë në finale. Kronikën që do ta dëgjoni në vazhdim e ka përgatitur gazetari ynë
(Lajm i përshtatur)

7. Nëse faktet nga fragmenti më lart do t'i rendisnim duke iu përgjigjur kroelore: "kush, kur, ku, çka", do të kishim fjalinë:
A. Trajneri i kuqekaltërve mbrëmë në Barcelonë tha se...
B. Trajneri i kuqekaltërve tha mbrëmë në Barcelonë se...
C. Mbrëmë në Barcelonë, trajneri i kuqekaltërve tha se...
D. Mbrëmë, trajneri i ku

8. Fjala "nyja gordiane" e ka kuptimin:
A. problem i pazgjidhshëm
B. problem i zgjidhshëm
C. problem i vështirë për t'u zgjidh
D. problem i lehtë për t'u zgjidhur

9. Në fjalinë: *"Kronikën që do ta dëgjoni në vazhdim e ka përgatitur gazetari ynë"*, e-ja është:
A. nyjë e përparme ; B. pjesëz ; C. lidhëz ; D. trajtë e shkurtër

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigjiu pyetjeve në vijim
Lum për tý, o i lumi Zot!
Fort po shndritë njaj diell e pak po xe'!
Ç'p'e merr frima rrapin e Jutbinës!
Borë e madhe, qi paská rá,
Rândojnë ahat për me u thye;
Ki'n çetinat vetëm kreshtat:
Ushtojnë lugjet prej ortiqesh,

10. Ky fragment është shkëputur nga:
A. Këngëra e Rinjohjes ; B. Këngët e Gjergj Elez Alisë ; C. Këngë e Kreshnikëve ; D. Këngëra e Ago Ymer Agës

11. Vargje të tipit: *"Lum për tý, o i lumi Zot!"*, ku kërkohet ndihma e fuqive mbinatyrore, hasen edhe te:
A. Epi i Gilgameshit ; B. Odiseja e Homerit ; C. Rubaitë e Khajamit ; D. Antigona e Sofokliut

12. Krijimet popullore, pjesë e të cilave është ky fragment, nuk shquhen për:
A. ritmin e rregullt ; B. metrikën e rregullt ; C. figurat stilistike ; D.mbështetjen në fakte

Lexo tekstin e dhënë më poshtë pastaj përgjigjiu pyetjeve
Ky autor lindi në fshatin Gur i Bardhë të Matit, më 1566. Shkollimin e parë e bëri në vend si autodidakt. Mësimet e larta i kreu në Kolegjin Ilirian të Loretos (Itali). Në moshën 21 vjeçare e shugurua prift dhe shërbeu në Kosovë e Maqedoni. Më 1599 u emërua vikar i përgjithshëm i Serbisë, ku qëndroi 17 vjet. Më 1616 shkoi në Romë, ku ndjeti më 1621. Atje pos shtypjes së librave kreu edhe veprimtari të tjera rreth kryengritjes ballkanike kundër Turqisë dhe qe pelegrin në Galicì. Nga fundi i qëndrimit në Romë, ky autor u emërua ipeshkv i Zadrimës (1621). Në këtë detyrë ishte deri në dhjetor të vitit 1622, kur e mbytën duke e kaluar lumin Drin.

13. Mbështetur në të dhënat e mësipërme biografike që jep ky tekst për njërin nga autorët e Letërsisë së vjetër shqipe, bëhet fjalë për:
A. Pjetër Budin ; B. Pjetër Bogdanin ; C. Frang Bardhin ; D. Marin Barletin

Në Poezinë XVI të veprës "Doktrina e Kërshtenë" të Pjetër Budit, janë vargjet:
Tashti të lus, ndritmë mua,
Zoti im me një rrezé
……
Sqip të mundënj me rrëfyem
Ndonjë kankë të ré

14. Në këta dy distikë del frymëzimi krijues autorial i lidhur për tre elementë, që janë përcaktues edhe të programit poetik të këtij autori:
A. tokësor, universal dhe idilik ; B. fetar, atdhetar dhe individual; C. qiellor, adhurues dhe ëndërrimtar; D. imagjinar, dashuror dhe i ndjeshëm

15. Këta dy distikë japin natyrën poetike të poezisë:
A. elegjiake; B. përshkruese ; C. refleksiv ; D. satirike

16. Cilat nga vargjet e poemës: "Këngët e Milosaos" të Jeronim de Radës, shprehin njërën nga format e paradoksit:
A. *Bota kish ndërru*
uji i ri në det
B. *Duro, zemër duro, e dur*
sa duroi mali me borë
C. *Thomni ju, të dashurit*
m'ëmbël ë të puthurit
D. *Nesër ajo, në kët' or*
Ullet në shtratin tim

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigjiu pyetjeve në vijim
Unë nuk pretendoj të jem e zonja të mësoj diplomatin, gjeografin apo arkeologun. Qëllimi im është shumë më modest. Unë dëshiroj t'i jap lexuesit vetëm një ide më të drejtë për gjendjen e ngjarjeve në Gadishullin e Ballkanit nga ajo që ai zotëron zakonisht. Njerëz të këtyre racave të tjera më janë lutur t'i tregoj të gjitha ato që kam parë e dëgjuar, për të kujtuar publikun britanik se, ka edhe popuj të tjerë veç bullgarëve që duhet t'u merren parasysh interesat, dhe për të theksuar që të hollat që jepen nga njerëz bujarë me qëllim, ashtu si mendohet për të ndihmuar Krishterimin, ka të ngjarë që t'i japë shkak Partisë Bullgare që të mendojë se ajo ka mbështetjen e Anglisë dhe për ta inkurajuar atë të shkaktojë dhuna të reja kundër të krishterëve të tjerë.
Kurse njerëz të tjerë më janë lutur që të mos i tregoj ato që kam parë e dëgjuar. Është e pamundur t'i kënaqësh të gjithë. Mungesa e vendit ku do të mund të punoja natyrisht më pengon që të jap hollësitë e këtij udhëtimi tim të gjashtë, në Gadishullin Ballkanik, por jam munduar që të bëj një përshkrim të thjeshtë të fakteve kryesore. Sukseset që munda të arrij, ua detyroj kryesisht miqësisë së atyre që më ndihmuan gjatë udhëtimeve të mia.
Gabimet janë të gjitha të miat.
(Edith Durham: "Brenga e ballkanasve")

17. Cila fjali e jep më së miri qëllimin e veprës së kësaj autoreje?
A. Njerëz të këtyre racave të tjera më janë lutur t'i tregoj të gjitha ato që kam parë
B. Mungesa e vendit natyrisht më pengon që të jap hollësitë e këtij udhëtimi.
C. Ka edhe popuj të tjerë veç bullgarëve që duhet t'u merren parasysh interesat.
D. Dëshiroj t'i jap lexuesit vetëm një ide më të drejtë për gjendjen e ngjarjeve

18. Autorja, në fragmentin e këtij teksti, përqendrohet kryesisht te problemi i:
A. konfliktit midis populli bullgar dhe popujve të tjerë
B. mbështetjes së Anglisë ndaj interesave të bullgarëve
C. paanësisë gjatë paraqitjes së dëshmive dhe ngjarjeve
D. të hollave që jepen nga njerëz për të ndihmuar Krishterimin

Lexo tekstin e dhënë më poshtë dhe përgjigjiu pyetjeve në vijim
Afërdita - Hynesha e dashurisë, e bukurisë, dhe e pjellorisë te grekët e vjetër. Thuhej se ishte e bija e Zeusit ose, ndryshe, se kishte lindur nga shkuma e detit. I shoqi ishte Hefesti, por ajo kishte edhe të dashur të tjerë, si ndër perënditë (më i njohuri Aresi), ashtu edhe ndër njerëzit e vdekshëm (më i njohuri Adonisi).

19. Ky tekst identifikohet si pjesë e fjalorit:
A. enciklopedik ; B. filologjik ; C. të gjuhës letrare ; D. të fjalëve të huaja

20. Cila nga veprat, nuk është vepër e autorit të cilit i referohet?
A. Azem Shkreli: "Nga bibla e heshtjes"; B. Ismail Kadare: "Net shqiptare" ; C. Nazmi Rrahmani: "Malsorja" ; D. Dritëro Agolli: "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo"

ENGLISH LANGUAGE

21. Jenna gave a birthday party last night. We all had great fun although we knew it was not her birthday because she was born on 13/06/1992. Jenn was born on_____.
A. the thirteenth of June, nineteen ninety-two
B. thirteen of the June, nineteen ninety-two
C. thirteenth of June, nineteen ninety-two
D. June thirteenth, of nineteen ninety-two

22. Lana, Roger, Debbie, and Steven all attend the same school. They spend a lot of time together. They have many things in common. However, this summer they have decided to plan their summer holidays on their own. They will go hitchhiking in Europe.

Look at the table below and choose the correct answer:

	LANA	ROGER	DEBBIE	STEVEN
2nd part of June	Austria	Belgium	Switzerland	France
July	Germany	France	Austria	Belgium
August	France	Germany	France	Switzerland
1st part of September	Switzerland	Austria	France	Germany

A. All of them will visit different countries during the same months.
B. None of them will be in the same country during the same month.
C. Lana will visit three countries during the summer.
D. Two of them will visit the same country during the same month.

23.
1. Yes, I've walked a lot and now I'm tired and hungry.
2. What is on the menu? Let me see… k the wai
3. I don't understand this. Let's ask the waiter for advice.
4. Have you had a good afternoon, Susan?
5. I am too. What shall we have?
The correct order of sentences to form a dialogue is _____.
A. 1 2 5 4 3 ; B. 2 1 4 5 3 ; C. 4 1 5 2 3 ; D. 4 3 5 2 1

24. ONLY ONE of the words below CANNOT be used to complete the following sentence. Which one?
Look! They're coming! Can't you see them? Jane is the _____ girl wearing a white hat.
A. tall ; B. high ; C. smart ; D. elegant

25. Read the following sentences and then choose a sentence to complete the dialogue:
Ben: This is an Identikit picture of Brian Smith. Look for him
Diana: What has he done? Why is he wanted?
Ben: He's a pick pocket, _____
A. he steals money, credit cards, passports…
B. he robs banks and cash-points.
C. he breaks into houses.
D. he kidnaps children.

26. In the following dialogue
Rowena: Prince Charles will be in Oxford tomorrow and meet the mayor of Oxford.
Tim: Who told you that? Let's go and _____ him?
from the following words:
1. salute ; 2. lecture ; 3. meet ; 4. chat with
Tim should say, **'salute'** because _____.
A. this is what we do when we meet our friends.
B. this is what people usually do when they meet a prince.
C. this is how you show your respect to an important personality.
D. it is not unusual for us to meet the members of the royal family.

27. Choose the correct answer to complete the sentence:
He always wants to give _____ to people around him.
A. advise ; B. advice ; C. advises ; D. advices

28. The sentence 'I have been reading for ages.' is in the _____.
A. Present simple tense ; B. Present perfect tense ;C. Present continuous tense ; D. Present perfect continuous tense

29. Look at the following verbs. One of them DOES NOT exist. Which one?
A. analyze ; B. carelize ; C. stabilize ; D. harmonize

30. Choose the best way to join the following sentences:
They want to be happy.
Understanding what makes people happy is essential.
A. They want to be happy so understanding what makes them happy is essential.
B. They want to be happy because understanding what makes them happy isessential.
C. They want to be happy that understanding what makes them happy is essential.
D. They want to be happy although understanding what makes them happy is essential.

31. Choose the correct sentence:
A. We thought of him never as part of the family despite that the fact he was one of us.
B. We never thought of him as part of the family despite the fact that he was one of us.
C. We never thought of him as of the family part despite that the fact he was one of us.
D. Despite we never thought of him as part of the family the fact that he was one of us.

32. Look at the words in the box:
asked – one - interviewer – for – the – of – opinion – workers - the – his

The correct combination to form a sentence is:
A. The interviewer asked one of the workers for his opinion.
B. The interviewer asked for his opinion one of the workers.
C. The interviewer for his opinion asked one of the workers.
D. For his opinion the interviewer asked one of the workers.

33. Which word is different?
A. goal ; B. stadium ; C. ball ; D. scorer

34. Choose the correct word to complete the following sentences:
I could not _____ his questions easily.
They will _____ all that you ask.
A. take ; B. choose ; C. answer ; D. respond

35. Which word below does NOT rhyme with the word victorious?
A. furious ; B. dangerous ; C. curious ; D. luxurious

36. In the string of words: carefully, amazingly, wonderfully, carelessly, encouragingly, the word carelessly is different because _____.
A. it is an adjective ; B. it is an adverb ; C. its meaning is positive ; D. its meaning is negative

37. Read the paragraph carefully:
Western Australia is eight times the size of Britain, but it has only one million people. 900,000 of them live in and around the state capital, Perth. The other 100,000 people live in 'the outback', an area of 2,500,000 square kilometres. The area is hot and dry. Temperatures are usually over 30°C in summer and sometimes 40°C. It hardly ever rains. Sheep farming is the main occupation, and the farms are called 'sheep stations' in Australia. The children can't go to school, and they hardly ever see a teacher. They have lessons from a two-way radio. It's called 'The School of the Air'. The children can speak to the teacher and other children in the class by radio.
Look at the highlighted part of the text and complete the following sentence:
The author _____.
A. knows exactly how big the area and population of Western Australia is.
B. is speculating about the size of the area and population of Western Australia.
C. is not certain about the size of the area and population of Western Australia.
D. doesn't know the exact size of the area of Western Australia.

38. The following sign means:
A. taxis are not allowed to park here.
B. you can find a taxi near here.
C. the road is blocked for taxis.
D. taxi transport is for free in this area.

39. In many countries people celebrate holidays of different kinds. This particular holiday is very much appreciated by children. On this occasion they wear masks and fancy costumes and go door to door saying 'Trick or treat'. Below is the symbol of this holiday:
The holiday is called:
A. Christmas
B. Easter
C. Halloween
D. Thanksgiving

40. Read the following paragraph:
Dianna went shopping yesterday. She first went into a greengrocer's. She bought a
kilo of English apples. They cost £1.85. Then she took a kilo of French pears. They were
£1.25. She also bought a kilo of English strawberries and half a kilo of Italian grapes. She
paid £2.70 for these. She paid _____ altogether.
A. five pounds and eighty pence
B. six pounds and eighty pence
C. four pounds and eighty pence
D. three pounds and eighty pence

Matematikë

41. Cila nga barazitë vijuese është e saktë?
A. $a^n \cdot a^m = a^{nm}$
B. $a^n \cdot a^m = a^{n+m}$
C. $a^n : a^m = a^{n+m}$
D. $(a^n)^m = a^{n+m}$

42. Në një rreth janë dhënë 8 pika të ndryshme. Sa trekëndësha me kulme në ato pika mund të formohen ?
A. 52
B. 54
C. 56
D. 58

43. Cili nga gjykimet e dhëna është i saktë?
A. p: *Nëpër dy pika të dhëna kalojnë dy drejtëza të ndryshme*
B. q: *Çdo katërkëndësh ka dy boshte të simetrisë..*
C. $r: \frac{a^2-1}{a+1} = a-1, \quad a \neq -1$
D. $s: \frac{\frac{2}{3}}{\frac{3}{5}} = \frac{3}{10}$

44. Zgjidhjet e ekuacionit kuadratik $(x-2)^2 - 9 = 0$ janë:
A. $x_1 = -1, \ x_2 = 5$
B. $x_1 = -3, \ x_2 = 5$
C. $x_1 = -7, \ x_2 = 7$
D. $x_1 = -9, \ x_2 = 9$

45. Cilat janë zgjidhjet e ekuacionit $\sqrt{2+\sqrt{x^2-3x}} = 2$
A. $x_1 = 1, \ x_2 = 4$
B. $x_1 = -1, \ x_2 = 4$
C. $x_1 = -1, \ x_2 = -4$
D. $x_1 = 1, \ x_2 = -4$

46.
Në qoftë se $z_1 = 3 - i$ dhe $z_2 = 4 + 3i$, $(i = \sqrt{-1})$, janë dy numra kompleksë, atëherë pjesa reale e numrit kompleksë $z_1 \cdot z_2$ është e barabartë me:
A. $Re(z_1 \cdot z_2) = 5$
B. $Re(z_1 \cdot z_2) = 9$
C. $Re(z_1 \cdot z_2) = 14$
D. $Re(z_1 \cdot z_2) = 15$

47. Janë dhënë bashkësitë: A = [1, 6] , B = [3, 8] dhe C = [4, 10] . Sa është $A \cap B \cap C$?
A. $A \cap B \cap C$ = [3, 8] ; B. $A \cap B \cap C$ = [4, 6] ; C. $A \cap B \cap C$ = [3, 6] ;
D. $A \cap B \cap C$ = [4, 8]

48. Janë dhënë funksionet: $f(x) = x^2 - 4$ dhe $g(x) = -\frac{x}{2} - 1$.

Sa është f (g (–2)) + 2 ?
A. 0 ; B. – 1 ; C. – 2 ; D. – 4

49. Pas thjeshtimit shprehja $\left[1 - \frac{2ab}{(a+b)^2}\right] : (a^2 + b^2)$ $a \neq -b$ është e barabartë me:

A. $\frac{1}{(a+b)^2}$ B. $\frac{1}{a^2+b^2}$ C. $(a+b)^2$ D. a^2+b^2

50. Shuma e tre numrave të njëpasnjëshëm është 126. Cili prej tyre është më i madhi?
A. 37 ; B. 39 ; C. 43 ; D. 47

51. Janë dhënë termat $a_3 = 8$ dhe $a_9 = \frac{1}{8}$ të vargut gjeometrik. Sa është herësi q ?

A. $q = \frac{1}{2}$ B. $q = 2$ C. $q = \frac{1}{4}$ D. $q = 4$

52. Cila është vlera e termit të parë të vargut aritmetik nëse dihet termi i pestë $a_5 = 7$ dhe diferenca $d = 2$?
A. $a_1 = 1$; B. $a_1 = -1$; C. $a_1 = -3$; D. $a_1 = -5$

53. Është dhënë trapezi barakrahës me brinjët paralele a = 5 cm dhe b = 3 cm si dhe këndi që formon brinja anësore me brinjën e bazës $\alpha = 45°$. Sa është lartësia e trapezit ?

A. 1
B. 2
C. $\frac{\sqrt{2}}{2}$
D. $\frac{\sqrt{3}}{3}$



54. Është dhënë shprehja $\sqrt{xy} - \frac{\sqrt{x}}{\sqrt{y}} - \frac{\sqrt{y}}{\sqrt{x}}$, $x > 0, y > 0$.

Sa është vlera e y –it ?

A. $\frac{x}{x-1}$ B. $\frac{x}{x+1}$ C. $\frac{x-1}{x}$ D. $\frac{x+1}{x}$

55. Shuma e dy numrave është 10, ndërsa shuma e katrorëve të tyre është 68. Cilët janë ata numra?

A. $x_1 = 1,\ x_2 = 9$
B. $x_1 = 7,\ x_2 = 3$
C. $x_1 = 2,\ x_2 = 8$
D. $x_1 = 6,\ x_2 = 4$

56. Është dhënë $\log_3 5 = a$ **. Në cilin rast është njehsuar saktë** $\log_5 15$ **?**

A. $\log_5 15 = \log_5 3 \cdot 5 = \log_5 3 + \log_5 5 = a + 1$
B. $\log_5 15 = \log_5 3 \cdot 5 = \log_5 3 + \log_5 5 = \frac{\log_3 5}{3} + 1 = \frac{a}{3} + 1$
C. $\log_5 15 = \log_5 3 \cdot 5 = \log_5 3 + \log_5 5 = \frac{\log_3 5}{5} + 1 = \frac{a}{5} + 1$
D. $\log_5 15 = \log_5 3 \cdot 5 = \log_5 3 + \log_5 5 = \frac{1}{\log_3 5} + 1 = \frac{1}{a} + 1$

57. Në një zarf gjendet numri x. Për cilin numër është fjala nëse mesatarja e numrave 3, 6, *x* është numri 10 ?
A. 1 ; B. 11 ; C. 21 ; D. 31

58. Në figurën e dhënë është paraqitur paralelogrami ABCD dhe gjashtëkëndshi irregullt MNBPQD te cili vlen [AM] = [MD] dhe [DQ] = [QC] . Sa është gjatësia e [AM], nëse dihet se [DB] = 8 cm ?
A. 2 cm
B. 3 cm
C. 4 cm
D. 5 cm

59. Nëse është dhënë $\frac{1}{3^{n+1}} = 5$, atëherë sa është 9^{n+1}?

A. 144 ; B. 169 ; C. 200 ; D. 225

60. Është dhënë piramida e drejtë katërkëndore, baza e të cilës është drejtkëndësh me brinjët a = 16 cm, b = 12 cm , kurse lartësia H = 15 cm . Sa është vëllimi i piramidës ?
A. V = 960 cm^3
B. V = 920 cm^3
C. V = 940 cm^3
D. V = 980 cm^3

KIMI

61. Si quhet energjia e cila lirohet ose absorbohet me rastin e pranimit të elektronit nga atomi elektroneutral në gjendje të gaztë?
A. Afinitet ndaj elektronit
B. Afinitet ndaj protonit
C. Energji e jonizimit
D. Energji e disocimit

62. Cili prej këtyre joneve gjendet i kompleksuar me porfirinë në përbërje të hemoglobinës?
A. Al^{3+} ; B. Cr^{3+} ; C. Mg^{2+} ; D. Fe^{2+}

63. Në një kupshore porculani është vendosur një sasi e jodurit të merkurit (HgJ2) i cili është substancë kristalore me ngjyrë të kuqe. Kupshorja është ngrohur mbi flakëdhënës dhe në këtë rast joduri i merkurit e ka ndërruar ngjyrën nga e kuqja në të verdhë. Pse ka ndodhur ndërrimi i ngjyrës?
A. Sepse HgJ2 me ngrohje shpërbëhet në Hg dhe J2
B. Sepse HgJ2 me ngrohje e ndërron strukturën kristalore
C. Sepse HgJ2 me ngrohje kalon në gjendje agregate të lëngët
D. Sepse HgJ2 me ngrohje kalon në gjendje agregate të gaztë

64. Çfarë kanë të përbashkët mes vete elementet e grupit të dytë të sistemit periodik?
A. Numrin atomik
B. Numrin e masës
C. Numrin e elektroneve në shtresën e fundit
D. Numrin e protoneve në bërthamën e atomit

65. Në cilin rast është shënuar saktë konfiguracioni elektronik i atomit të hekurit, duke u bazuar në rrregullën e diagonales?

A. Fe (Z=26) $1s^2\ 2s^2\ 2p^6\ 3s^2\ 3p^6\ 3d^6\ 4s^2$
B. Fe (Z=26) $1s^2\ 2s^2\ 2p^6\ 3s^2\ 3p^6\ 4s^2\ 3d^6$
C. Fe (Z=26) $1s^2\ 2s^2\ 2p^6\ 3s^2\ 3p^6\ 3d^4\ 4s^2$
D. Fe (Z=26) $1s^2\ 2s^2\ 2p^6\ 3s^2\ 3p^6\ 4s^2\ 3d^4$

66. Cili numër kuantik përcakton nivelin energjetik të atomit?
A. numri kuantik sekondar (l)
B. numri kuantik magnetik (m)
C. numri kuantik spin (s)
D. numri kuantik kryesor (n)

67. Është dhënë barazimi i reaksionit kimik të përftimit të bakrit nga xehja e tij me proces pirometalurgjik:

$$Cu_2O + C \xrightarrow{\text{nxehësi}} 2\,Cu + CO$$

Në cilin rast janë shënuar saktë të dhënat për reaksionin kimik dhe për procesin e përftimit të bakrit?

	Cu_2O është:	*Lloji i reaksionit*	*Mjeti reduktues që përdoret*
I	Element kimik	Reaksion i neutralizimit	Oksidi i karbonit (II)
II	Element kimik	Reaksion i oksido-reduktimit	Koksi
III	Komponim kimik	Reaksion i neutralizimit	Oksidi i karbonit (II)
IV	Komponim kimik	Reaksion i oksido-reduktimit	Koksi

A. I ; B. II ; C. III ; D. IV

68. Në cilin rast janë dhënë në mënyrë të saktë të dhënat për alkanet?



69. Në cilin rast janë paraqitur saktë të dhënat për klorin?

	Grupi	Vetitë e përgjithshme	Gjendja oksiduese
I	17-të	Jometal	-1
II	16-të	Jometal	-2
III	1-rë	Metal	+1
IV	2-të	Metal	+1

A. I ; B. II ; C. III ; D. IV

70. Në cilin rast është shënuar saktë formula strukturore e acidit sulfuror (H_2SO_3)?



A. I ; B. II ; C. III ; D. IV

71. Sa është përqendrimi sasior i tretësirës ujore të klorurit të kaliumit, e cila përmban të tretur 1,49g KCl në 2000 cm3 tretësirë?
Mr (KCl) = 74,5
A. c (KCl) = 0,1 mol dm-3
B. c (KCl) = 0,01 mol dm-3
C. c (KCl) = 0,2 mol dm-3
D. c (KCl) = 0,02 mol dm-3



72. Në cilin rast janë dhënë saktë karakteristikat e përbashkëta për fruktozën dhe glukozën?

	Struktura	Vetitë e përbashkëta
I	Përmbajnë grupin karbonil	Kanë shije të thartë
II	Përmbajnë grupin karboksil	Kanë shije të ëmbël
III	Përmbajnë grupin karbonil	Kanë shije të ëmbël
IV	Përmbajnë grupin karboksil	Janë pa shije

A. I ; B. II ; C. III ; D. IV

73. Në grafikun vijues janë dhënë entalpitë e formimit të metanit, etanit, etilenit dhe acetilenit. Cilat prej këtyre komponimeve formohen nga karboni dhe hidrogjeni me reaksione ekzotermike?
A. Metani dhe etani
B. Etani dhe etileni
C. Etileni dhe acetileni
D. Acetileni dhe etani



74. Përshpejtimi i pjekjes së perimeve në serra është pasojë e trajtimit të tyre me:
A. etin ; B. eten ; C. buten ; D. propen

75. Cili prej komponimeve vijuese është paraqitur me formulën strukturore të dhënë?
A. Aminobenzeni
B. Aminofenoli
C. Nitrobenzeni
D. Nitrofenoli

BIOLOGJI

76. Zebra e cila si burim të ushqimit përdorë bimët është organizëm:
A. omnivorë ; B. herbivorë ; C. karnivorë ; D. insektivorë

77. Në cilën pjesë të qelizës kryhet cikli i Krebsit?
A. Plastide ; B. Ribozome ; C. Citoplazmë ; D. Mitokondrie

78. Cila nga metodat e menaxhimit të mbeturinave paraqet procesin gjatë të cilit, materia organike zbërthehet në përbërës mineral dhe joagresiv?
A. Riciklimi ; B. Incinerimi ; C. Fermentimi ; D. Kominucioni

79. Në cilin kategori sistematike të shtazëve bën pjesë pinguini?
A. Gjitarë ; B. Shpendë ; C. Zvarranikë ; D. Ujëtokësorë

80. Si pasojë e dëmtimit të trurit të mesëm te njeriu do të:
A. çrregullohet dëgjimi
B. çrregullohet memoria
C. çrregullohet drejtpeshimi
D. çrregullohet frymëmarrja

81. Gjatë zhvillimit embrional prej ektodermës krijohen:
A. epiteli i fshikëzës së urinës, epiteli i mushkërive, veshi i mesëm
B. epiteli i mushkërive, zemra, sistemi urogjenital
C. indi eshtëror, derma e lëkurës, gjëndrrat pështymore
D. sistemi nervor, gjëndrat lëkurore,
qimet

82. Në figurë është paraqitur sistemi i tretjes dhe disa organe ndihmëse të tretjes te shpendët. Në cilën prej këtyre organeve të tretjes bëhet zbutja e materieve ushqyese?
A. Në gushë ; B. Në lukthin muskulor ; C. Në pankreas ;
D. Në zorrën e hollë

83. Te kurrizorët shqisa e shijimit është e lokalizuar në gjuhë. Në cilën pjesë të gjuhës përceptohet shija e thartë?
A. III ;
B. VI ;
C. I dhe V ;
D. II dhe IV

84. Në figurë janë paraqitur membranat embrionale te kurrizorët. Cila nga këto membrana embrionale e formon placentën te gjitarët?
A. Horioni
B. Amnioni
C. Alantoisi
D. Vitelina



85. Cili është gjenotipi i prindërve (pulës dhe gjelit) nëse prej 160 zogjëve (pasardhësve)120 prej tyre janë me këmbë të shkurtëra dhe 40 janë me këmbë normale? Gjeni për këmbë të shkurtëra është dominant (K) ndërsa gjeni për këmbë normale është recesiv (k).
A. KK x Kk ; B. KK x kk ; C. KK x KK ; D. Kk x Kk

86. Cila nga bazat e mëposhtme acidike mungon te ARN-ja?
A. Adenina ; B. Timina ; C. Guanina ; D. Citozina

87. Cilat nga këto grupe të gjallesave janë paraqitur të parat në rruzullin tokësor?
A. Sfungjerët ; B. Planariet ; C. Protozoat ; D. Grykorët

88. Truri i vogël është qendër për rregullimin dhe drejtpeshimin e trupit dhe koordinator i lëvizjeve që më së miri është i zhvilluar te:
A. gaforrja dhe peshku
B. peshku dhe ujëtokësorët
C. ujëtokësorët dhe zvarranikët
D. shpendët dhe gjitarët

89. Si quhen organet që luajnë rolin e kërcellit te bimët e ulëta?
A. Rizoide ; B. Filoide ; C. Kauloide ; D. Sigmoide

90. Cila nga këto shtazë kryen frymëmarrjen me anë të mushkërive?
A. Delfini ; B. Flutura ; C. Amfioksi ; D. Peshkaqeni

SOCIOLOGJI

91. Disa teoricienë që merren me pabarazitë gjinore ose me pozitën e gruas në shoqëri, pabarazinë e femrës e shohin të kushtëzuar ndër të tjera edhe me faktorin:
A. bio-social
B. morfologjiko-social
C. fiziko-social
D. statiko-social

92. Me çka përputhet shoqëria qytetare sipas Marksit?
A. Me klasat
B. Me religjionin
C. Me mbistrukturën
D. Me bazën materiale

93. Duke qenë se martesa është e pranuar dhe e miratuar nga shoqëria, atëherë mund të themi se martesa është institucion:
A. natyror
B. moral
C. social
D. ekonomik

94. Tipi i familjes ku babai është autoriteti kryesor, ndërsa farefisnia llogaritet sipas linjes mashkullore, është familje:
A. matriarkale
B. patriarkale
C. radikale
D. egalitare

95. Në sistemin demokratik të qeverisjes ekzistojnë tri pushtete :
A. drejtus, administrativ dhe juridik
B. shtetëror, hyjnor dhe publik
C. legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor
D. autarkik, monarkik dhe diktatorial

96. Sipas Ogyst Kontit dinamika sociale është pjesë e fizikës sociale, e cila studion:
A. zhvillimin shoqëror, ndryshimet dhe lëvizjet
B. stagnimin shoqëror, rendin dhe pasojat e tij
C. rendin shoqëror dhe elementet e tij
D. strukturën shoqërore ekzistuese

97. Mendimi i njohur i Makiavelit "qëllimi arsyeton mjetin" do të thotë:
A. në jetën politike nuk ekzistojnë qëllime të caktuara
B. në jetën politike nuk ekzistojnë parime të larta etike
C. në jetën politike ekzistojnë parime të larta etike
D. në jetën politike ekzistojnë qëllime të caktuara

98. Sipas Branislav Malinovski-t ndalesa e incestit është bërë për ta ruajtur:
A. identitetin dhe dinjitetin familjar
B. vazhdimin e llojit njerëzor
C. lidhjen e njerëzve me natyrën
D. integritetin dhe homogjenitetin familjar

99. Cilat elemente e përbëjnë kulturën shpirtërore sipas antropologut Eduard Tejlor?
A. Dija, besimi, arti, morali dhe zakonet
B. Dija, detyrat, përgjegjësitë dhe obligimet
C. Puna vullnetare e bazuar në pirjre personale
D. Puna e detyruar ose e imponuar nga shteti

100. Grupet e caktuara shoqërore mund të identifikohen me kulturën që i përkasin, por gjithashtu edhe me kulturën dominuese të vendit ku jetojnë. Bikulturalizmi është një fenomen ku njerëzit:
A. nuk identifikohen me asnjërën kulturë dominuese
B. nuk identifikohen as me kulturën e origjinës e as me kulturën dominuese
C. identifikohen njëlloj si me kulturën e vet ashtu edhe me kulturën dominuese
D. identifikohen me të dy kulturat, por kulturës dominuese për çdo ditë i japin përparësi më shumë



Maturantët e shkollave të ndryshme të Kosovës, gjatë vizitave në AAB-Riinvest

Vizitë e studentëve të AAB-Riinvest në Athinë

Studentët e AAB-Riinvest në Dubrovnik

...në një galeri artesh në kryeqytetin grek

Vizitë studimore në Kroaci

Ekspozitë e studentëve të AAB-Riinvest në Gostivar

...në një galeri artesh në kryeqytetin kroat

...në një galeri artesh në kryeqytetin kroat

Studentët e AAB-Riinvest, në Universitetin Mimar Sinan, Stamboll

Modelja, Diellza Asllanaj, kërkon të mbetet në sfilatën e modës dhe të vazhdojë studimet e gazetarisë

Ëndrra e bërë realitet

E re, ambicioze, e gatshme për të sfiduar veten, Diellza Asllanaj ka arritur ta bëjë realitet ëndrrën për t'u bërë modele. Ajo u radhit në mesin e pesë më të mirave në garën "Unë jam Top Model" dhe guxon për më tepër. Në Universitetin AAB-Riinvest studion për gazetari, të cilin po ashtu e ka pasion.
Në intervistën për "Studenti", ajo shpjegon se nuk do të kishte dashur të vihej në një pozitë për të përzgjedhur në mes sfilatës dhe gazetarisë.

Diellza, ju tashmë jeni në pesëshen e më të mirave të emisionit 'Unë jam Top Model', që është mbajtur për herë të parë në Kosovë. Çfarë do të thotë kjo për ju?
Diellza: Të ju them të drejtën ka qenë një ëndërr e bukur, tashmë e bërë realitet. Jam ndier e privilegjuar që hyra në mesin e 5 vajzave fituese të emisionit 'Unë jam Top Model'. Është një përjetim i bukur që jam e sigurt se secila vajzë do të dëshironte që ta provonte, e në këtë rast unë po ndihem fatlume.

Ky konkurs ka zgjatur rreth një viti. Cilat ishin vështirësitë për t'ia dalë deri në finale?
Diellza: Saktë. Ky konkurs, apo më mirë të them kjo garë, zgjati një vit të plotë. Tash mund ta merrni edhe ju me mend se për një vit sa punë më është dashur të bëj për të arritur deri këtu ku tashmë arrita, duke ia nisur nga provat pothuajse të përditshme, fotografitë të ndryshme profesionale të cilat nuk kanë qenë të pakta e kështu me radhë. S'duhet harruar asnjëherë që në gjithë këtë punë të pandërprerë ka pasur edhe momente të mrekullueshme në të cilat kam kaluar unë si konkurrente e këtij emisioni.

Kush ishte njeriu që 'zbuloi bukurinë tuaj'?
Diellza: Faktikisht edhe pse gjithmonë kam pasur përkrahjen e familjes sime për të hyrë në botën e modelimit, personi që i dha shtyrje dhe kahe krejt tjetër dëshirës sime të kahershme ishte vetë autori i emisionit 'Unë jam Top Model', Labinot Gashi, sepse falë ndihmës dhe përkushtimit të tij ndaj kësaj pune, unë arrita këtu ku jam edhe sot. Nuk mund ta quaj kulm të karrierës sime prej një modeleje, mirëpo padyshim që mund ta quaj një fillim të mirë.

Gara e madhe ishte e përbërë prej 21 vajzave dhe 21 djemve. Çfarë mendonit në fillim, do t'ia dilnit që të jeni fituese ?
Diellza: Në fillim fare, nuk kam qenë edhe aq optimiste sa i përket fitores, mirëpo me punë të përditshme edhe duke e parë përkushtimin tim ndaj kësaj pune e sidomos edhe vetë komentet e jurisë së emisionit për mua si konkurrente me ngritën në atë fazë sa mund të besoja që unë mund të isha njëra ndër vajzat fituese, ashtu edhe siç u bë.

A keni marrë tashmë ndonjë ofertë për të sfiluar?
Diellza: Fatmirësisht ofertat si për sfilata të ndryshme, ashtu edhe për reklama e fotografi nuk po mungojnë, sidomos tash pas përfundimit të emisionit 'Unë jam Top Model', mirëpo gjithmonë jam në shqyrtim të ndonjë oferte, pse jo sa më të mirë të mundshme.

Është përfolur që fituesit e këtij emisioni do të marrin pjesë nëpër sfilata ndërkombëtare. A qëndron ende ky premtim që iu është dhënë?
Diellza: Ajo që ka premtuar autori i këtij emisioni, Labi, ishte që shumicën nga ne t'i dërgonte diku jashtë shtetit, për të kontraktuar me ndonjë agjenci të huaj, mirëpo gjithsesi ne e dimë që jo të gjithë nga ne do ta kenë atë fat, e cilët do të jenë ata, mbetet të shihet. Gjithsesi një gjë që patjetër më duhet ta përmend është bashkëpunimi i vazhdueshëm me Labin edhe pas finales së madhe.

Diellza, ju njëkohësisht studioni edhe në Fakultetin e Komunikimit Masiv në Universitetin AAB-Riinvest. Cili do të jetë profesioni juaj primar në të ardhmen?
Diellza: Është pak vështirë të përcaktohem në njërën prej dy gjërave që unë i kam shumë për qejf mirëpo, nëse do ta kem fatin të lidh kontratë me ndonjë agjenci të huaj, sigurisht se nuk do ta lëshoj rastin. Gjithsesi gazetaria mbetet një pjesë e bukur dhe e rëndësishme në jetën time.

Dhe, për fund, a konsideroni se sfilata e modës është një punë që sjell të ardhura të mjaftueshme?
Diellza: Ndoshta këtu është e vetmja gjë në të cilën ngec puna e një modele, sepse me sa unë e kam kuptuar, nuk ka të mira materiale aq sa duhet, mirëpo dëshira ime e madhe për t'u marrë me këtë profesion e mund dëshirën për para.

Kimete Islami-Abdyli

Gisele Bundchen

Kate Moss

Modelet që mahnitin botën me trupin e tyre

Të gjitha janë të bukura, të suksesshme e tërheqëse. Ato vazhdojnë të jenë modelet më të paguara në botë. Disa nga ato janë krenare që mbajnë "krahët e engjëjve". Ato përcillen me shumë vëmendje nga meshkujt, sidomos kur prezantojnë veshjet e brendshme të "Victoria's Secret". "Ask men", një revistë kjo për meshkuj, pak kohë më parë ka publikuar listën e modeleve me trupin më të bukur. Të parat që renditën në këtë listë janë: Gisele Bundchen, Adriana Lima, Kate Moss dhe Karolina Kurkova.

Bundchen, të gjitha e kanë zili

Braziliania me trup mahnitës, 31-vjeçarja Gisele Bundchen është përfolur shumë për sukseset e saj. Revista amerikane "Forbes-it", Gisele Bundchen e ka shpallur modelen më të paguar në botë dhe kjo për në gjashtë vjetët e fundit.

Moss, më e suksesshmja në historinë e modelimit

Modelja që në muajin janar mbushi plot 37 vjet, Kate Moss, konsiderohet si modelja më e suksesshme në historinë e modelimit. Modelja angleze nuk është shumë e gjatë dhe nuk i ka linjat sikur "engjëllushët" e "Victoria's Secret". Megjithatë anglezja Moss është imazhi i përzgjedhur, për veshjet intime, i "Agent Provocateur".

Lima, "Engjëlli i Victoria's"

Trupi dhe fytyra janë shenjat dalluese të Adriana Lima-s, e cila bëhet tejet mahniste kur mbathet me intimet e "Victoria's Secret". Suksesi më i madh për braziliane Lima ishte në vitin 2000, kur ajo ishte 19-vjeçe. Vazhdoi të bëjë për vete adhuruesit e modës në vitet 2003, ndërsa në vitin 2007 dhe 2008, pikërisht Adriana Limës i takoi nderi t'i hapë revytë e brendit të "Victoria's Secret".

Kurkova, e rrit karrierën edhe pas 11 vjetësh

Modelja Çeke, 27-vjeçarja, Karolina Kurkova, zë vendin e katërt në këtë top-listë. E bukura Karolina Kurkova, që në moshën 16-vjeçare nisi karrierën e saj prej modeleje. Që atëherë mori pjesë në revynë e saj të parë për "Victoria's Secret". Njëmbëdhjetë vjet pas kësaj, karriera e saj është edhe më tutje në rritje e sipër. Vazhdon të jetë pjesë e "Victoria's Secret" dhe të mbaj në nivel të përkryer linjat e saja trupore.

Adriana Lima

Karolina Kurkova

Sfidat në Academy Awards - OSCAR

Filmi "The King's Speech", ka fituar në të gjitha kategoritë që llogaritën të jenë më kryesore si: "Best Picture" (Fotografia më e mirë), "Best Director" (Regjia më e mirë), "Best Actor" (Aktori më i mirë) dhe "Best Original Screenplay" (Skenari origjinal më i mirë).

Charlton Heston, Aktori më i mirë, Filmi Ben Hur 1960

Gjatë vitit 2010 Hollywoodi kishte prodhuar disa filma të cilët arritën të kenë një sukses të madh në shikueshmëri, gjithashtu disa nga ta u vlerësuan lart nga kritikët e filmit.

Filmi më i suksesshëm që është prodhuar në 2010-ën është filmi "The King's Speach" (Fjalim i Mbretit) i cili në këtë edicion të Academy Award fitoi katër statuja të Oscarit nga 12 nominime.

Filmi "The King's Speach", ka fituar në të gjitha kategoritë që llogaritën të jenë më kryesore si: "Best Picture" (Fotografia më e mirë), "Best Director" (Regjia më e mirë), "Best Actor" (Aktori më i mirë) dhe "Best Original Screenplay" (Skenari origjinal më i mirë).

Filmat e tjerë fitues në këtë edicion janë: "The Social Ntwork", i cila ka fituar tri çmime, dhe "Alice in Wonderland", "Fighter" dhe "Toy Story 3", me nga dy çmime secili. Filmat që kanë marrë nga një çmim në këtë edicion të Oscarit janë: "Black Swan", "In a Better World", "Inside Job" dhe "The Wolfman".

Filmi që arriti të jetë në qendër të vëmendjes së opinionit publik, The Social Netowork, arriti t'i rrëmbejë tri çmime Oscar. Në këtë film bëhet fjalë për rrjetin social Facebook, i cili për një kohë të shkurtër ka arritur të kalojë e dyta në botë, menjëherë pas google-s.

Në edicionin e sivjetmë të Akademy Awards, për kategorinë "Best Picture" kanë qenë të dominuar 10 filma, ndryshe nga edicionet e tjera që kanë qenë të dominuar për këtë kategori nga pesë filma.

Academy Awards shfaqet çdo pranverë dhe është spektakli më i shikuar në SHBA dhe në gjithë botën në industrinë e filmit. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës çmimet e Akademisë njihen ndryshe si "OSCAR" dhe ndahen çdo vit nga Akademia e Arteve dhe Shkencave Filmike.

Në këtë spektakël ndahen edhe çmime për kategori të tjera si, realizimi më i mirë teknik, kinematografia më e mirë, grimi më i mirë, dizajni i kostumeve, zëri, efektet pamore, çmime nderi të karrierës etj.

Statuja "OSCAR"

Statuja "OSCAR", e cila në fakt është shpërblimi që merret, ende nuk dihet se nga e ka marrë këtë emër. Megjithatë, figura në formën e njeriut është shumë e vlefshme. Ajo përbëhet nga ari dhe bronzi, është e gjatë 34.3 centimetra dhe peshon 3.9 kilogramë. Është krijuar nga skulptori amerikan Xhorxh Stenlli.

Filmat më të suksesshëm

Një kohë të gjatë ishte filmi Ben-Hur (i realizuar në vitin 1959), ai i cili konsiderohej me i suksesshmi në historinë e "OSCAR-it", me gjithsejtë 11 OSCAR të fituar deri sa në vitin 1998 filmi Titanic gjithashtu fitoi në 11 Kategori. Vetëm 6 vjet më vonë përkatësisht në vitin 2004, filmi "The Lord of the Rings: The Return of the King" fitoi gjithashtu 11 Oskar. Ky film është edhe filmi i vetëm i cili i ka fituar të gjitha kategoritë për të cilat është nominuar.

Kategoritë si: filmi më i mirë, regjia më e mirë, aktori më i mirë, aktorja më e mirë, si dhe skenari më i mirë vlejnë si kategoritë më të rëndësishme.

Më së shumti çmime në historinë e "OSCAR-it: kanë fituar: aktorja Katharine Hepburn me katër çmime të fituara e ndjekur nga aktorja Ingrid Bergman, aktori Walter Brennan dhe aktori Jack Nicholson me nga tre OSCAR të fituar.

Meryl Streep është aktorja që ka më së shumti nominime për çmimin OSCAR, me gjithsejtë 14 nominime, pas saj vijnë aktorja Katharine Hepburn dhe aktori Jack Nicholson me nga 12 nominime. **Përgatiti: Sabri Musliu**

Orkestra e parë Filarmonike Mbarëshqiptare

Orkestra e parë Filarmonike Mbarëshqiptare u themelua më 8 prill të këtij viti dhe si qëllim kryesor ka nxitjen dhe bashkëpunimin kulturor mes artistëve nga gjithë trevat shqiptare, ndërkohë që koncerti pritet në vjeshtën e këtij viti.

Pianisti Desat Sulejmani u shpreh se ideja për këtë orkestër lindi në nëntor të vitit të kaluar, kur kjo orkestër shfaqi dhe një koncert në Gjermani dhe është konceptuar si një bashkim kulturor dhe shpirtëror shqiptar.

"Kjo orkestër është në radhë të parë një synim i përbashkët jo për dy apo tre koncerte, por për një ide që është forcimi i identitetit tonë kulturor", tha Sulejmani.

Orkestra Filarmonike Mbarëshqiptare do të përfshijë gjithë prurjet më të mira muzikore të trevave shqiptare, të cilat do të përzgjidhen nga një sistem rotacioni, ndërkohë që tre qendrat e saj do të jenë Tirana, Prishtina dhe Shkupi.

Qendra Artistike "Orkestra Filarmonike Mbareshqiptare" përbëhet nga artistët themelues si Desar Sulejmani, njëkohësisht dhe kryetar i saj si dhe, Baki Jashari (Kosove), Blerim Grubi (Maqedoni), Isak Shehu (Shqipëri), Sihana Badivuku (Kosovë), Fatos Lumani (Maqedoni) Pjeter Guralumi dhe Bujar Alliu (Shqipëri).

Ndër qëllimet e këtij institucioni të ri muzikor mbarëkombëtar është promovimi i vlerave kulturore dhe i traditave të shumta muzikore ndërmjet muzikantëve, instrumentistëve, dirigjentëve dhe kompozitorëve shqiptarë.

Gjendet libri 600 vjet i vjetër

Është gjendur një libër 600 vjet i vjetër, në qytetin Sandy në shtetin federal amerikan të Utah. Vlera e këtij libri llogaritet në 100 mijë dollarë.

Ken Sanders merret me vlerësimet e veprave artistike dhe pohon se libri, përkatësisht njëra nga kopjet e librit "Nuremberg Chronicle", është zbulim i karrierës së tij. Ky libër është botuar si libër shtesë i Biblës së Gutembergut më 1494.

Ky është njëri nga librat më të vjetër të shtypur në botë dhe është 200 vjet më i vjetër se libri më i vjetër i shtypur në SHBA, transmeton "Huffington Post".

Në të gjenden mbi 1 800 ilustrime në teknikën e drurit dhe libri ishte në pronësi të një avokati në qarkun Pennsylvania Dutch. Ai nuk ishte i vetëdijshëm për vlerën e librit dhe ia kishte lënë në trashëgim me testament një kushëriri.

Fenomen teknologjik

Kurzueil: Në vitin 2045, njeriu bëhet i pavdekshëm

"Unë do doja shumë që të mos ju jepja lajme kaq tronditëse për të ardhmen, por ndërsa numrat e thonë këtë dhe unë s'kam çfarë ju them tjetër?", është shprehur Kurzueil

Njeriu që ka shpikur softuerin e parë dhe që për herë të parë arriti të përdorte më 1965, mendon sot se më 2045 njeriu të do jetë i pavdekshëm, falë kompjuterëve super të shpejtë dhe shumë herë më inteligjentë se të sotmit.

Raymond Kurzueil ishte 17 vjeç kur paraqiti në një emision televiziv shpikjen e tij, një kompjuter që për herë të parë zëvendësonte aftësi që deri në atë moment kishin qenë vetëm të njeriut, duke fshirë në këtë mënyrë për herë të parë vijën mes inteligjencës artificiale dhe asaj organike. Ky në fakt ishte sekreti i madh që Kurzueil i zbuloi botës, por atëherë, 46-vjet më parë as ai nuk e kuptoi këtë.

"Unë do doja shumë që të mos ju jepja lajme kaq tronditëse për të ardhmen, por ndërsa numrat e thonë këtë dhe unë s'kam çfarë ju them tjetër?", është shprehur Kurzueil.

Kompjuterët të aftë të bëjnë gjëra që njerëzit bëjnë

Sot Kurzueil beson se i jemi afruar shumë momentit kur inteligjenca e kompjuterëve po e kalon atë të njeriut. Kur kjo të ndodhë, thuhet në një reportazh të revistës së famshme "Time", njeriu, trupi jonë, gjaku jonë, mendjet tona dhe i gjithë qytetërimi do të transformohen. Ai beson se ky moment është i paevitueshëm dhe sipas llogaritjeve të tij kjo do të ndodhë pas 35 vitesh dhe këtë nuk e thotë një sharlatan, por njëri ndër inxhinierët më të famshëm në botë.

Kompjuterët po bëhen të shpejtë, në të vërtetë shpejtësia me të cilën ata përmirësohen rritet në mënyrë të paimagjinueshme. Kështu nëse kompjuterët po bëhen kaq të shpejtë ata në një moment mund të arrijnë të barazojnë veten me atë që ne e njohim si inteligjenca njerëzore. Dhe do të kemi në atë moment Inteligjencën Artificiale.

Kjo do t'i bëjë kompjuterët të aftë të bëjnë gjëra që njerëzit bëjnë, që nga drejtimi i një makine deri në marrjen e vendimeve etike. Ju ndoshta nuk e përtypni këtë ide, por Kurzueil dhe mjaft njerëz të zgjuar arrijnë ta përtypin dhe përcjellin këtë.

Ndoshta ne do të shkrihemi me ata super kompjuterë dhe do të bëhemi gjithashtu super të zgjuar duke i përdorur ata për të zgjeruar aftësitë tona intelektuale ashtu siç përdorim makinat dhe aeroplanët për të shtuar aftësitë tona fizike.

Shpenzohen miliona për të kuptuar këtë fenomen

Aktualisht po shpenzohen miliona për të kuptuar këtë fenomen. Nuk kemi të bëjmë me një shaka të përgënjeshtruar botërisht nga shkenca si fundi i botës, por një investim serioz të NASA apo Google që kanë themeluar një universitet që studion këtë fenomen. Njerëzit që po studiojnë këtë fenomen janë ndër mendjet më të zgjuara në botë dhe ata nuk janë aty thjesht sepse janë të çmendur pas teknologjisë, por sepse presin që kjo të jetë e vërtetë dhe nëse ndodh kështu bota s'do jetë kurrë si më parë.

Kurzueil, një nga njerëzit që mbështet fort idenë se shumë shpejt bota do të jetë krejt ndryshe, që prej 1965 ka qenë mjaft i angazhuar në këtë proces.

Kurzueil shpjegon se kjo nuk është një gjendje intuitive, me anë të kompjuterëve super të fuqishëm. Ai tashmë ka llogaritur se edhe vetë njerëzit lëvizin në mënyrë lineare dhe në llogaritë e tij kompjuterët zhvillohen në mënyrë ekstremisht të shpejtë, pasi çdo dyfishim sjell rrjedhimisht katërfishimin e shpejtësisë së zhvillimit e kështu me radhë deri në infinit.

Në fund të kësaj dekade, sipas Kurzueil, kompjuterët do të jenë të aftë dhe me inteligjencë të barabartë me njeriun. Ndërsa data e "Singularity" sipas tij është viti 2045.

Në këtë vit sipas tij inteligjenca artificiale do të ketë arritur të jetë 1 miliard herë më e fuqishme se inteligjenca që ka njeriu sot. Por nuk është vetëm ky njeri që beson në këtë zhvillim të ri të njerëzimit.

Vdekja, problem që zgjidhet

Shpikësit më të rëndësishme të teknologjisë, doktorë nga më të famshmit dhe inxhinierë të teknologjive që njerëzit e thjeshtë vetëm i kanë parë me sy, besojnë se vdekja e njeriut është një problem që zgjidhet, me një llaf çështje numrash.

Kurzueil është i interesuar vetë në lojën e pavdekësisë. Ai ka trashëguar nga i ati që vdiq 58-vjeç një ADN jo shumë të shëndetshme dhe në moshën 35-vjeçare u diagnostikua me dy lloje diabeti. Vetë në bashkëpunim me një doktor ai përdori një kurë që përfshinte 200 lloje të ndryshme barnash dhe vitaminash, diabeti i tij u kurua plotësisht dhe sot 65-vjeç ai ka qeliza të një 45-vjeçari. E pabesueshme?

Sigurisht që jo. Imagjinoni 5 vjet më parë ne nuk kishim 600 milionë njerëz të lidhur në një rrjet të vetëm social, sot kemi Facebook. 5 vjet më parë ishte e pamundur që njerëzit të njoftonin në një moment se ku do të shkonin dhe çfarë po bënin, sot ata mund ta dëshmojnë këtë me IPhone.

Nga ana tjetër imagjinoni sikur Iphone të mos jenë më thjeshtë në duart tona, por në trurin tonë? Tashmë 30,000 pacientëve me Parkinson u është kryer impiant neuronesh në tru. Google tashmë është duke eksperimentuar makinën që ecën pa shofer. Ka më shumë se 2 mijë robotë që luftojnë në vend të njerëzve në Afganistan. Këtë muaj pritet që të zhvillohet një lojë kuizi në SHBA, ku një super kompjuter i IBM i quajtur Uatson do të konkurrojë kundër njerëzve. Në një ndeshje testi që u zhvillua pak kohë më parë ai mundi dy ish kampionë të kësaj loje.

Ai nuk është ndonjë kompjuter kush e di sa i zgjuar, por ai e rrit inteligjencën e tij çdo moment… 100 vjet prej sot personazhi i këtij shkrimi dhe mjaft të tjerë do të njihen si baballarët e një bote të re, ndryshe nga baballarët e botës që njohim të cilët janë prej kohësh nën dhe, Kurzueil dhe të tjerët mund të jenë gjallë dhe ta gëzojnë plotësisht këtë status.

Forbes: Moska, qyteti me më shumë miliarderë në botë

Rusia tashmë ka më shumë se 100 miliarderë dhe se më shumë miliarderë jetojnë në Moskë se në çdo qytet tjetër të botës.

Në raportin vjetor për njerëzit më të pasur në botë, revista prestigjioze "Forbes" shkruan se numri i miliarderëve në Rusi ka shkuar në 101 nga 65 sa ishte vitin e kaluar.

Vetëm në Moskë jetojnë 79 miliarderë, shkruan revista amerikane, sipas së cilës, miliarderët rusë tash përbëjnë një të tretën e e miliarderëve në Evropë. Në New York jetojnë 58 miliarderë.

"Forbes" thotë se Kina tash ka 115 miliarderë, ndërsa SHBA kanë 413 miliarderë.

Sipas revistës, tash në botë ka gjithsejt 1.210 miliarderë. Prej tyre, më i pasuri është Karlos Slim nga Meksika, i cili këtë kurorë arriti ta mbajë për të dytin vit me radhë, duke pasur në pronësi një pasuri prej 79 miliardë dollarësh.

I dyti në listë është Bill Gejts, themelues i Microsoftit, me një pasuri prej 56 miliardë dollarësh, kurse në vendin e tretë është ranguar investitori Uarren Bufet, me 50 miliardë dollarë.

Revista "Forbes" ka vlerësuar se

zoti Gejts mbase do të ishte akoma njeriu më i pasur në botë, po të mos ia kishte dhuruar 28 miliardë dollarë fondacionit të tij.

Mbipesha, lufta me vetveten

Ana e kishte të vështirë të gjente veshje për të. Zemërohej pse dyqanet nuk mbanin veshje me numrin XL. Ajo provoi një dietë ekstreme me pilula, por më pas u bë si "tullumbace e shfryrë". Mjekët këshillojnë konsumimin e ushqimeve pa bazë shtazore, ecje dhe jetë aktive fizike

Kimete Islami-Abdyli

Jo rrallë, ajo kalonte orë të tëra duke i shikuar rrobat e saja të reja, të varura në mbajtësen e dollapit dhe duke e imagjinuar veten si do të dukej e veshur me to. Ajo ëndërronte ditën kur do të mund t'i veshte mini-fundet, të preferuarit e saj, të cilët vazhdon t'i blejë edhe pse ka vite që nuk mund t'i veshë ata, për shkak të madhësisë jo të përshtatshme.

Jo shumë vite më parë, ajo nuk ia vëntë veshin shumë dukjes së saj. Sot ajo është 33 vjeçe dhe ende nuk e ka idenë më të vogël se pse kurrë në jetën e saj nuk kishte bërë diçka lidhur me mbipeshën e saj. Komplimentet e shoqeve dhe të afërmve të saj, të cilët gjithnjë i thoshin se nuk dukej keq, e humbnin vlerën çdo herë e më shumë që ajo dilte për të blerë rroba.

Këto ishin orët kur Ana nuk ishte aspak e kënaqur me dukjen e saj.

Aventurat e rrezikshme me pilula

Por, ishte pranvera e hershme e vitit 2010, kur Neziri, babai 67 vjeçar i Anës, kaloi tri javë i shtrirë në spital, për shkak të një operacioni të venave në këmbë, edhe ai me mbipeshë. Babai i saj ishte një sfidë e vërtetë për ofrimin e përkujdesjes së duhur si për anëtarët e familjes së tij, gjithashtu edhe për personelin mjekësor gjatë kohës së trajtimit të tij në spital.

Kjo gjë sikur ishte edhe një shkak më shumë që Ana të mendonte për mbipeshën e saj.

Një ditë derisa po kthehej në shtëpi, pas vizitës që i kishte bërë babait të saj, në hyrje të ndërtesës ku ajo banon, takon Vlorën, një shoqe të saj të shkollës fillore. Kishin kaluar vite pa u parë. Ana ishte e emocionuar dhe njëkohësisht e befasuar me ndryshimet e mëdha të dukjes së Vlorës. Vlora po i tregonte historikun e saj të shkurtër në rreth 20 vitet e fundit. Ana e shikonte në sy, ndërsa mendjen e kthente në kohën e kaluar: Eh, Vlora e cila, edhe pse më e shkurtë se unë, në vitet e fundit të shkollës fillore peshonte rreth 80 kg. Kurse tani, ja ku është para meje me dukjen dhe qëndrimin e një vajze që bën sfilitë mode.

„A ke mbajtur dietë, apo ke ushtruar" e ndërpret Ana, tregimin për jetën e saj gjatë kohës që nuk ishin parë. Nuk paske ndryshuar fare, ia kthen buzagaz Vlora. Ti nuk më lejove të tregoj se ka më shumë se dy vjet që kam hapur një shitore të vogël ku shes tableta, kafe dhe çajra për dietë. Fillimisht i kam përdorur vetë dhe rezultati besoj se po shihet, i thotë Vlora. Po pse nuk vjen një ditë të më vizitosh në shitoren time dhe të tregoj më për së afërmi për to.

Nuk kaloi pothuajse një javë që nga ajo ditë, kur Ana hap derën e shitores së shoqes së saj.

Për fazën e parë të dietës, e njohur ndryshe si faza testuese, mjaftojnë 12 tableta i kishte rekomanduar Vlora, e cila për ato tableta i kishte marrë 12 euro.

Në orën gjashtë të mëngjesit të ditës së nesërme, mars 2010. Ana gëlltiti pilulën e parë dietale në jetën e saj. Sipas rekomandimeve të Vlorës, tabletat duhej të merreshin çdo mëngjes, prej orës 5-6, prej kësaj kohe deri në mesditë ajo mund të hante sallata frutash-apo siç njihet ndryshe „ushqim i lehtë". Megjithëse Vlora nuk ishte e kualifikuar për këtë lëmi, Ana duke mos e ditur as vetë arsyen, vendosi t'u përmbahet udhëzimeve të saj. Ana e pinte me barkun bosh. Pas mesditës pirja e kafesë ishte rreptësisht e ndaluar, mirëpo jo edhe konsumimi i ushqimit. Pason befasia e radhës për Anën. Për herë të parë në jetën e saj ajo nuk kishte apetit fare, madje as për prodhimet e qumështit, ushqimin e saj të preferuar.

Vlora i kishte premtuar Anës se jo më shumë se pas katër muajsh, dukja e saj do të ndryshojë në atë masë sa edhe vetë Ana do ta ketë të vështirë t'u besojë syve se çfarë po sheh.

Mëngjesi i ditës së parë të dietës shkoi mirë. Orët kalojnë. Mirëpo rreth mesditës, filloi marramendja, djersitja dhe vjellja dhe atë disa herë, brenda pak orësh. Megjithëse ishte paralajmëruar për efektet anësore të dietës, ajo kurrë nuk kishte mundur ta imagjinonte ndjenjën që e përjetoi gjatë tri ditëve të para të dietës.

Tullumbacja e fryrë

Por, Ana sot nuk është edhe aq e lumtur, ndonëse ka humbur disa kilogramë të tepërt. "Sikur të mund ta ktheja kohën prapa, me siguri se nuk do ta zgjedhja dietën, sepse humbja e peshës së madhe brenda një kohë relativisht të shkurtër ka bërë që të dukem më e vjetër se që jam në të vërtetë", thotë ajo. "Për vite të tëra lëkura ime ka qenë e sforcuar dhe e lëmuar, kurse tani pas humbjes së një peshe relativisht të madhe, disi sikur lëkura më është rrudhur dhe më duket vetja si një tullumbace e shfryrë" , shprehet Ana, duke mos e larguar shikimin nga një foto e kohëve kur dukej si "tullumbace e fryrë".

Kujdes me kaloritë, ecni dhe bëni fitness

Ndërsa dr. Gazmend Kajtazi i këshillon konsumimin e ushqimit të shëndetshëm, gjithnjë duke e pasur parasysh faktin se gjatë dietave njerëzit zakonisht e rrisin sasinë e proteinave të konsumuara, ndërsa e zvogëlojnë sasinë e karbohidrateve të konsumuara.

Zana Krasniqi, trajnere në një klub fitnesi në Prishtinë, thotë se konsumimi i kontrolluar i ushqimit është një lloj diete. "Me fitnes njerëzit mund të humbin në peshë shumë më shpejt dhe në mënyrë më efektive".

Ushqimi që do t'ju bëjë më të bukur

Në vend që të blini kremra shume të shtrenjta ultrahidratuese, hapni frigoriferin. Me ushqimin që konsumoni mund të ndikoni në atë se si dukeni. Marrja e disa ushqimeve të ndryshme me vlerë të lartë ushqyese është mënyrë e lehtë, praktike dhe e lirë ta përmirësoni pamjen tuaj(fitoni shkëlqim në sy, parandaloni rënien e flokëve apo pastroni lëkurën). Ja pemët dhe perimet që t'ju bëjnë më tërheqës.

Spinaqi

Ushqimi i preferuar i Popajit nuk do të bëjë që muskujt t'ju fryhen si në filmin e vizatuar, por spinaqi është i pasur me karotenoidet lutienë dhe zeaksantinë, të cilat në mënyrë të shkëlqyeshme veprojnë në pastërtinë e të bardhës së syve tuaj. Kjo perime e gjelbër është e pasur me hekur është e përkryer për sallata.

Vetë

Këto burime të pashtershme të energjisë shpesh janë përbërës ideal të darkave të shpejta dhe të lehta nëse pëlqeni omëletë apo vezë në sy. Vetë e fërguara janë të përkryera për fillim të ditës, ndërsa ato të zierat mund të shërbejnë si shtesë për sandviç. Vetë janë të pasura me hekur, i cili ndihmon në parandalimin e rënies së flokëve dhe me sulfur, i cili i bën flokët më të buta dhe delikate.

Bananet

Kjo pemë e mban lëkurën tuaj të bukur dhe elastike. Pirja e cigares, në mënyrë serioze dëmton elasticitetin e lëkurës suaj, ndërsa kaliumi në banane do të ndihmojë ta zbutni këtë.

Panxhari

Është aleat i shkëlqyeshëm në luftën për ruajtjen e pamjes tuaj. Rrënja e panxharit përmban betainin, agjentin bioaktiv, i cili ndihmon dekompozimin e yndyrave. Ndërsa lëngu i panxharit përmban një lloj të klorit i cili ndihmon gjatë tretjes. Nëse panxhari i shtrydhur nuk ju duket me i shijshmi në botë, provoni të paktën ta merrni në gjendje natyrale, si sallatën.

Vaji nga farat e rrushit

Ky vaj shume "modern" ka ngjyrë ari të çelët , i përkryer për sallata apo bukë italiane. Tani përdoret në kozmetikë si shtesë për lëkurë më të butë, por është i pasur me vitaminë E, e cila zvogëlon shfaqjen e rrudhave. Përdorni ashtu siç e përdorni vajin e ullirit – qoftë në sallata apo për fërgim.

Gujava

Gujavat janë nga familja e shegës dhe janë të pasura me antioksidantë, shkatërruesit e radikaleve te lira të cilat prishin pamjen e lëkurës suaj dhe për shkak të të cilave mund të dukeni më të vjetër sesa jeni. Nuk keni nevojë as t'i hani, nëse nuk i adhuroni. Vetëm copëtoni frutën në pjatë dhe fërkoni lëkurën me të, dhe pastaj lajeni. Gujavat janë shumë të pasura me vitaminë C. Kanë pesë herë më shumë se portokalli "modest".

Online me shoqërinë

Se sa e përdorin të rinjtë Facebook-in, a e përdorin për të bërë më shumë miq, për të marrë informacione apo për të humbur kohë, përgjigjen disa të rinj të intervistuar.

Arlinda Ibrahimi

Njomza Salihu: Më mungojnë miqtë – i gjej në facebook

Rrjeti social facebook viteve të fundit po përdoret shumë nga njerëzit e moshave të ndryshme, e sidomos nga të rinjtë. Edhe unë si e re jam përdoruese e këtij rrjeti social.

Facebook-u po na e merr një pjesë të madhe të kohës, por nuk mund të them me saktësi se sa është kjo kohë, sepse varet nga angazhimet dhe detyrat ditore që kam.

Normalisht se e përdor për të kontaktuar me miqtë të cilët nuk i kam takuar kohë të gjatë, por edhe me ata të cilët s'kemi kontakte të vazhdueshme e të përditshme. Ndonjëherë e shfrytëzoj për ndonjë informatë ose diçka tjetër që na lidh me studimet tona. Por, shumicën e herëve e përdor për të kaluar një kohë të mirë me miqtë e mi e për të marrë informata të reja.

Liridona Hyseni: Me Facebook që nga shkolla e mesme

Facebook-un e kam filluar ta përdor që nga shkolla e mesme. Fillimisht e kam hapur për të komunikuar në një mënyrë pak me ndryshe me shoqërinë e shkollës. Atëkohë me shumë qejf bënim thuajse për çdo ditë foto dhe i postonim për të marrë komente. Dalëngadalë bëra shumë miq nga e gjithë bota. Sot e përdor për të marrë sa më shumë informata që me duhen.

Përfundimisht mund të them se kaloj shumë kohe duke e përdorur facebook-un, por pasi që përmbushi obligimet që kam në fakultet. Sot e përdor edhe për të bërë miq, por dominon ideja e marrjes se informatave.

Arbnora Gara: E përdor të motrës

Unë nuk kam Facebook personal, për arsye se nuk më pëlqen që fotot e mia t'i kem të ekspozuara, sepse dua ta ruaj privatësinë.

Mirëpo, unë e përdori Facebook-un e motrës për çdo gjë që me intereson dhe kaloj çaste interesante dhe nuk me tërheq që të kaloj shume kohë në këtë rrjet social.

Blerta Shala: Nuk e preferoj fare

Të them te drejtën, nuk preferoj të kem Facebook, andaj nuk kam se ç'të them më shumë.

Malsore Murseli: E përdor shumë, por s'jam e varur

Facebook-un e përdori në masë të konsiderueshme për të biseduar me miq e të afërm. Ndonjëherë me shërben për t'u informuar që të jem gjithmonë me afër informacionit. Në të mund të gjesh gjera të mira për mendimin tim, por përderisa nuk bëhesh i varur.

Ndikimi i Facebook-ut te të rinjtë

Burbuqe Metolli

Kohëve të fundit, çdo ditë e më shumë rrjetet sociale po kanë një ndikim të madh tek adoleshentët. Rrjeti social i cili po përdorët më së shumti te të rinjtë shqiptarë, por edhe pothuajse në gjithë botën, është Facebook-u, i cili përmban në vete më së 500 milionë anëtarë.

Lidhur më këtë gjë, sociologët thonë se përparimi i teknologjisë informative, në këtë rast krijimi dhe zhvillimi i facebook-ut, kanë shfrytëzuar hapësirën e "izolimit" te të rinjve në rrethin e tyre "të ngushtë", pasi që ky rrejt social u ka ofruar atyre lidhjen dhe komunikimin më të lehtë me miliona njerëz nga e gjithë bota.

Studentja Albina Avdiu, thotë se ajo e përdor internetin rreth 10 orë në ditë. Ajo thotë se jeta e saj është e varur nga rrjetet sociale përkatësisht Facebook-u.

"Jeta pa Facebook-un është monotone", shprehet Albina. Sipas saj, është në trend të jesh në Facebook, ngase aty janë të përmbledhura të gjitha më pak fjalë dhe se është "all in one" (të gjitha në një).

Ndërkohë, sociologu Rexhep Kuçi, thotë se ndikimi i teknologjisë informative te të rinjtë, në këtë rast rrjetet sociale, janë po me aq ndikim sa edhe familja, rrethi, shoqëria etj. Ai thotë se ndikimi i përdorimit të rrjeteve sociale në këtë rast Facebook-u te të rinjtë në shumicën e rasteve ka ndikim negativ, edhe pse në raste jo të shpeshta mund të ketë ndikim pozitiv.

"Mosha e adoleshentëve kanë prirje që kohën më të madhe ta kalojnë jashtë shtëpisë, apo me gjëra të cilat do t'i argëtonin ata përkohësisht, e në këtë rast mund të jetë facebook-u, kontakti me persona të tjerë (chati), konkurrenca apo promovimi te një masë sa më e gjerë. Kjo vjen pasi që "adoleshenca" është mosha e ndryshimeve fiziologjike dhe në këto ndryshime ata ndihen të pasigurt, kanë trauma, strese dhe në kohën më të madhe kanë nevojë për ndihmë. Këtë ndihmë atyre duhet t'ua ofrojë familja", tha Kuçi.

Kuçi krahason sistemin e vjetër të shkollimit, siç e quan ai shkolla tradicionale me sistemin e ri të shkollimit apo shkolla bashkëkohore, duke thënë se nga shkolla tradicionale është kultivuar morali, disiplina, arsyeja për punë profesionale, për punë të mirëfilltë etj. Ndërsa, sikur nga aspekti i kushteve që ofron shkolla bashkëkohore, ai thotë se në këtë shkollë kanë mundësi shumë si nxënësi ashtu edhe profesori, mirëpo, ofrimi i mundësisë që ata të kenë njohuri të gjithanshme, ata rrallë herë arrijnë që një lëmi të caktuar ta zotërojnë ashtu siç duhet.

Krijimi i varësisë nga rrjetet sociale (Facebook-u) është bërë përditshmëri te shumica e adoleshentëve. Kjo vjen si pasojë e jetës mjaft dinamike dhe se si pasojë e një konkurrence të madhe se cila faqe, apo cili përdorues po vizitohet më shumë. Për këtë shkak, adoleshentët në një farë mënyrë, për t'i rezistuar kësaj konkurrence, iu kalon një kohë e gjatë duke përdorur Facebook-un. Kjo kohe atyre iu kalon duke bërë postime të reja në faqet e tyre, duke komentuar, lavdëruar apo kritikuar të tjerët që janë pjesë e një debati, apo tematike të caktuar.

Ardita Mustafa, një studente tjetër, thotë se rreth katër orë në ditë i shpenzon në rrjetin social Facebook, pa të cilin, asaj dita i duket e mangët. "Pothuajse e gjithë shoqëria ime ndodhet aty dhe është e pa mundur t'i rezistosh kohës", shprehet ajo.

Edhe Bestrim Kryeziu, një nxënës i shkollës së mesme, thotë se edhe ai dhe shokët e tij e përdorin shumë facebook-un, dhe atë mbi nëntë orë në ditë.

Sipas tij, prioritet i ditës së tij është Facebook-u, pastaj mësimi.

"Qasjen në Facebook e ka bërë edhe më të lehtë mundësia e qasjes nga telefoni celular, kështu që ne e përdorim këtë rrjet social edhe kur gjendemi në orë të mësimit", shprehet nxënësi.

Profesorët e shkollave të mesme thonë se qëndrimi i tepërt në Facebook dëmton dhe neglizhon mësimin e nxënësve, ndërsa të kundërtën e thonë nxënësit e tyre. Sipas tyre, sikur të mos ishte i dobishëm qëndrimi në Facebook nuk do t'i kishin edhe shumicën e profesorëve, friendsa (shokë) në Facebook.

"Pothuajse tërë kohën edhe profesorët janë online dhe shumë shpesh komunikojmë me ta në Facebook", janë shprehur disa nxënës.

Sipas statistikave të klikueshmërisë nëpër internet, Facebook-u është faqja e dytë që vizitohet në vendin tonë, menjëherë pas google.com. Këto statistika i sjellë kompania më prestigjioze e majeve të klikueshmërisë së faqeve të internetit, Alexa.com.

Se Facebook është i dëmshëm dhe duhet të ruhemi nga ai, në veçanti prindërit t'i ruajnë fëmijët e tyre, tregon edhe fakti që zonja e parë e SHBA-ve, Mishel Obama, ua ka ndaluar vajzave të saj që të kenë llogari në Facebook dhe që ta përdorin atë.

Volejbollistet e AAB-Riinvest festojnë fitoren

Volejbollistet e Universitetit AAB-Riinvest dorëzuan të enjten (21 prill), në këtë universitet, Kupën e Kosovës të fituar dje kundër Dritës së Gjilanit, finale kjo që u zhvillua në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë.

Kapitenia e klubit, Shqipe Kqiku, dorëzoi Kupën e Kosovës te kryetari i bordit të Universitetit AAB-Riinvest, Ilir Tafa.

Kryetari Tafa, i uroi volejbollistet e klubit AAB-Riinvest duke iu dëshiruar suksese edhe në kampionatin e Supërligës së Kosovës në Volejboll.

"Ne e ndjejmë veten mirë që kemi një klub të universitetit që edhe e mbanë emrin e universitetit tonë. Krenohemi që klubi ynë është klubi më i organizuar në volejbollin kosovar dhe ndihemi mirë që kemi arritur të kontribuojmë që ky sport në Kosovë të jetë në një nivel shumë më të lartë", tha Tafa, duke iu premtuar atyre mbështetje të më tejshme.

Ndërkohë, trajneri i këtij, Naser Krasniqi, ibëri një prezantim të shkurtër ekipit që ai drejton duke i njoftuar edhe për prurjet e volejbollisteve të reja në klub, të cilat përbëjnë një moshë mesatare rreth të të 20-ave.

"Loja ka qenë e mirë, ka qenë një atmosferë e mirë. Në ekipin tonë e kemi komponuar edhe rininë edhe përvojën pasi kemi volejbolliste edhe të moshës 14-vjeçare, pastaj 17-vjeçare", tha Krasniqi.

Në fund të takimit, volejbollistet e klubit AAB-Riinvest u shpërblyen edhe me disa dhurata.

Sabri Musliu

Kosova me tetë garues në garat ndërkombëtare të "Taekwondos"

Reprezentacioni i Kosovës në "Taekwondo " me ftesë të Unionit të Federatave të Taekwondo-s së Belgjikës, mori pjesë ne Kampionatin e Klasës-A. Kjo është garë zyrtare e Unionit Evropian të Taekwondo -se (ETU), e cila u organizua për të 32-tën herë në Gent të Belgjikës, nga 8 deri më 10 prill të këtij viti.

Shpenzimet e akomodimit, ushqimit, transportit si dhe participimin në garë brenda Belgjikës ishin mbuluar nga Federata Belge, ndërsa Departamenti i Sportit pranë Ministrisë së Kulturës së Kosovës kishte premtuar se do të mbulojë shpenzimet për biletat e transportit Prishtinë-Bruksel.

Në këtë garë janë paraqitur rreth 1500 garues nga më shumë se 40 shtete, ndërsa Kosova u paraqit me 8 garues. Garuesit që morën pjesë në këto gara ishin: Erendita Gërguri -53 kg, Gentrit Kastrati - 59 kg. Në kategorinë e juniorëve, nga Kosova ishin këta garues: Mithat Gashi - 58 kg, Kastriot Sekiraqa - 63 kg, Valon Selmani - 68 kg, Durim Berisha -74 kg, Egzon Gërguri - 80 kg dhe Maxhun Berisha - 87 kg.

Për garuesit nga Kosova kjo ishte hera e tretë që morën pjesë zyrtarisht në një turne të Federatës Evropiane.

Kryetari i Federatës së Taekwondo-s së Kosovës (FTK), Nuhi Gashi, tha se është i kënaqur me performansën e garuesve nga Kosova.

"Ishte mungesa e eksperiencës në radhët e përfaqësueses sonë, megjithatë vlen të përmendet garuesi Durim Berisha i cili në dy luftëra fitoi bindshëm, ku për kundërshtar kishte përfaqësuesin e Gjermanisë dhe atë të Bjellorusisë. Mirëpo fati nuk ishte në anën e Berishës dhe pas një tërheqje të muskulit të këmbës, u detyrua të lëshojë garën".

Gashi tha se ky aktivitet u shfrytëzua edhe për lobim, ku në muajin maj në mbledhjen e Këshillit të Federatës Botërore do të diskutohet edhe për anëtarësimin e Kosovës, pasi që muajin e kaluar i kanë dërguar aplikacionin për anëtarësim.

"Gjithashtu, unë dhe Sekretari u takuam me kryetarin dhe sekretarin e Unionit Europian të Taekwondo -së të cilët u shprehen të gatshëm të përkrahin anëtarësimit e Kosovës dhe premtuan angazhim në këtë drejtim", tha numri një i FTK-së.

Përpos këtyre, krerët e FTK-së u takuan edhe me zyrtarë të Federatës Belge, Holandeze, Zvicerane, Gjermane, Marokene etj.

Ndërkohë, Federata Marokene u beri ftesë zyrtare FTK-së për vizitë në Maroko gjatë muajit tetor ku do të zhvillohen seanca të përbashkëta stërvitore. Maroku është Kampion bote aktiv në Taekwondo si dhe kampion Aktiv i kontinentit afrikan

Gazmend Preniqi

Presidentja Jahjaga priti fitueset e Kupës, volejbollistet e "AAB-Riinvest"

Presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga, ka pritur të premten (22 prill) volejbollistet e klubit "AAB-Riinvest", fitucse të sivjetme të Kupës së Kosovës, të prirë nga trajneri Naser Krasniqi dhe rektori i Universitetit "AAB-Riinvest", Dr. Lulzim Tafa.

Me këtë rast, mysafirët e uruan presidenten dhe ia dhanë asaj Kupën e fituar.

Volejbollistet e Universitetit AAB-Riinvest fituan Kupën e Kosovës në Volejboll-kategoria e femrave, në ndeshjen finale që u zhvillua më 20 prill në Palestrën e Pallatit të Rinisë, duke mposhtur volejbollistet e "Dritës" së Gjilanit me rezultat 3:1 në sete.

Portieri Sajmir Ujkani promovon lojtarët "Kuq e Zinj"

Portieri i Kombëtares shqiptare, Sajmir Ujkani, ka dhënë një intervistë për mediat italiane, duke bërë reklamë në një farë mënyre për lojtarët kuqezinj të ekipit përfaqësues. Në fillim Ujkani ka folur për ambiciet e tij me Novarën, skuadër që ndodhet në vendet e para të klasifikimit të Serisë B. "Dëshiroj që me Novarën të luaj në Serinë A. Shanset janë të mira që ne të ngjitemi sezonin e ardhshëm në gjirin e më të mirëve. Kam gjetur këtu ambientin e duhur dhe po përpiqem të bëj maksimumin për të pasur sukses. Do të jap kontributin tim që Novara të ngjitet në Serinë A dhe unë jam optimist për këtë", është shprehur Ujkani. Nga ana tjetër, portieri kosovar që ka luajtur më parë me Palermon, u ka bërë reklamë disa futbollistëve të Kombëtares, si Canës, Currit dhe Vangjelit. "Kombëtarja jonë ka disa elementë mjaft cilësorë që janë të denjë të luajnë dhe për skuadrat më të mira italiane. Sipas tij, këta lojtarë bëjnë diferencë në skuadrën përfaqësuese të Shqipërisë dhe kanë një karrierë të pasur, pasi kanë luajtur me ekipe shumë të forta. "Shqipëria ka një skuadër të mirë, ku disa lojtarë janë të denjë të luajnë në Serinë A. Unë mund të them se Lorik Cana, Debatik Curri dhe Kristi Vangjeli janë lojtarë cilësorë, që mund të jenë një emër i denjë për çdo skuadër të madhe në Serinë A. Por Kombëtarja ka dhe lojtarë të tjerë cilësorë që mund të luanin mjaft mirë në kampionatin italian", tha për mediat portieri kosovar i Kombëtares Shqiptare Sajmir Ujkani.

Vëllezërit Xhaka i thonë "jo" Kombëtares shqiptare

Babai i vëllezërve Granit e Taulant Xhaka, Ragipi, në një prononcim për "Sport" është shprehur se djemtë e refuzojnë përfundimisht kombëtaren e Shqipërisë. Ai shprehet se këtë vendim familja Xhaka e ka marrë, pasi, Federata Shqiptare e Futbollit është treguar joserioze.

Edhe telefonata e Lorik Canës bërë Xhakajve nuk ka pasur sukses, për t'i bindur talentet e Bazelit të vishen kuqezi. Lojtarët janë në bisedime me Federatën e Zvicerane të Futbollit.

"FSHF është e korruptuar. Interesimi i saj për Granitin dhe Taulantin ka qenë joserioz. Na ka telefonuar ditë më parë Redi Jupi (përgjegjës për zbulimin e talenteve në FSHF) dhe na ka kërkuar përgjigje të menjëhershme, kurse ne i kemi kërkuar kohë. Ata janë treguar joseriozë, andaj unë së bashku me djemtë e mi dhe familjen time kemi vendosur që përfundimisht t'i themi "jo" Shqipërisë. Askush nuk mund të luajë me djemtë e mi", është shprehur për "Sport" Ragip Xhakaj, babai i Granitit dhe i Taulantit, që ka thënë se" unë nuk mund ta kuptoj se si nuk ka pyetur kurrë Duka ose Kuzhe për Granitin e Taulantin. Ata në njëfarë mënyre na kanë neglizhuar. Shqipëria do

të humbasë shumë".

Pak ditë më parë, Redi Jupi (shef i zyrës së talenteve) u shpreh se: "FSHF është gati ta ndërmarrë nismën e gjatë dhe të vështirë (kanë luajtur me moshat e Zvicrës) që dy vëllezërit Xhaka të pajisen me pasaportë shqiptare të mund të luajnë për Shqipërinë, por më parë ata duhet të jenë të bindur që e duan këtë gjë."

Djalin e Zinedin Zidane e kërkon Juventusi

Në kohën që shumë tifozë të Real Madridit po krahasojnë magjinë e Mesut Ozil me atë të Zinedine Zidane, trashëgimtari i vërtetë i ish-futbollistit francez, djali i tij Enzo, po kërkohet nga Juventus.

Sipas 'La Gazzetta dello Sport', 16-vjeçari që luan në ekipin e të rinjve të Real Madridit i pëlqen shumë drejtuesve bardhezinj të cilët kërkojnë ta blejnë vitin tjetër. Enzo Zidane do të luante në ekipin e të rinjve në Torino nëse operacioni kryhet.

"Zidani i Vogël", siç quhet në Spanjë, luan në një pozicion të ngjashëm me atë të babait të tij, prapa sulmuesit kryesor.

Alonso: Mourinho di si ti motivojë lojtarët

Mesfushori i Real Madrid Xabi Alonso ka lavdëruar teknikun Mourniho duke deklaruar se ai di si ta nxjerrë me të mirën nga futbollistët e tij.

"Ai përgatitet shumë mirë për ndeshjet dhe merr vendime të mira gjatë saj," tha Alonso.

"Ajo çka në të vërtetë është ndryshe tek ia, nga ana emocionale është shumë i fortë. Ai e bënë çdo lojtarë të mirë aq sa ata mund të jenë.

"Për momente kyçe si në ndeshje kualifikuese apo finale, duhet të jesh i përgatitur mirë. Ai di si të lidhet më ne dhe kjo na motivon shumë për çdo lloj sfide," shtoi Alonso.

Pele: Paratë e agjentët po shkatërrojnë futbollin

Kontratat e larta të futbollistëve dhe puna e agjentëve të tyre, të cilët i "bëjnë presion" klubeve, janë dy gjëra që po ndikojnë në shkatërrimin e futbollit, ka paralajmëruar legjenda braziliane dhe botërore e këtij sporti, Pele.

"Futbollistët nuk duhet të harrojnë të luajnë nga dashuria për lojën dhe ekipin, por ata duan ata që paguajnë më shumë. Kjo paraqet rrezik për futbollin. Ata fitojnë në një sezon më shumë sesa kam fituar unë për 10 vjet", ka thënë Pele, i cili në karrierë ka shënuar 1 281 gola në 1 363 ndeshje të luajtura, transmetojnë agjencitë. Pele iu drejtohet agjen-

tëve:

"Atyre nuk iu intereson nëse futbollisti është i mirë apo jo. Është e rëndësishme që me shitjen e tyre të fitojnë para, dhe kjo kërcënon të ardhmen e futbollit".

Buxheti i sportit pritet të rritet për një milion euro

Federatat sportive të Kosovës gjatë këtij viti pritet të kenë më shumë aktivitete se në vitin 2010, kjo pasi buxheti i Departamentit të Sportit (DS), që financon aktivitetet e federatave, pritet të rritet për rreth një milion euro në krahasim me buxhetin e vitit të kaluar.

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Memli Krasniqi ka njoftuar se është përpiluar drafti i ri i buxhetit, në të cilin është paraparë ngritje për rreth 20 për qind nga buxheti që ishte planifikuar më herët. Sipas Krasniqit, nga ngritja e buxhetit më së shumti do të përfitojë vija e përfitimeve kapitale.

"Kemi thënë se do të mundohemi të ketë ngritje të ndjeshme të buxhetit të Ministrisë dhe në këtë drejtim kemi marrë mbështetje edhe nga Qeveria. Kemi përpiluar draftin e ri të buxhetit në negocim me Ministrinë e Financave dhe kemi pasur një ngritje në këtë draft deri në 20 për qind nga buxheti që ishte i planifikuar. Kryesisht rritja ka qenë për fushën e sportit. Jemi munduar që për një milion euro të rrisim buxhetin për sport në vitin 2011, në krahasim me vitin e kaluar", ka thënë Krasniqi.

Departamenti i Sportit ka kërkuar që për subvencione për vitin 2011 t'i ndahen 1,8 milionë euro. Vitin e kaluar buxheti për subvencione ishte 1,1 milion euro. Nga buxheti për subvencione edhe financohen aktivitetet e federatave sportive. Rritje është kërkuar edhe për investime kapitale. Për investime kapitale vitin e kaluar buxheti ishte 3,3 milionë euro, ndërsa Departamenti i Sportit ka kërkuar që në vitin 2011 të jetë 5,4 milionë euro.

Raul thyen një tjetër rekord

Sulmuesi spanjoll është bërë lojtari me më shumë ndeshje të luajtura në kompeticionin më të madh evropian duke lënë pas ishkapitenin e Milanit, Paolo Maldini.

Raul ka zhvilluar 138 ndeshje në fazën finale të Ligës së Kampioneve dhe 2 ndeshje në fazat paraeliminatore. Në 132 ndeshje ka mbrojtur fanellën e Realit të Madridit, ekip me të cilin debutoi më 13 shtator të vitit 1995.

Gjithashtu, Raul ka shënuar 70 gola në Champions, duke u renditur i pari në listën e golashënuesve të këtij turneu, dhe ka fituar tre herë këtë kompeticion me Real Madridin (1999/2000, 2000/2001 dhe 2001/2002).

Sharri®
Nga Zemra e Brezovicës
Uji më i mirë në vend.


AAB RIINVEST
Universiteti
AAB-RIINVEST

AAB RIINVEST
Institucion per Edukim Universitar

Institucion me më së shumëti fakultete të akredituara

Cilësi. Lidership. Sukses!

APLIKO ONLINE
www.aabriinvest.net

Ekonomik
- Ekonomiks Biznesi
- Banka, Financa dhe Kontabilitet
- Menaxhment dhe Informatikë
- Marketing dhe Administrim Biznesi

Juridik
- Juridik i Përgjithshëm
- Shkenca Politike
- Kriminalistikë
- Diplomaci
- Integrime Evropiane
- Administratë Publike

Komunikim Masiv
- Gazetari
- Produksion

Shkenca kompjuterike
- Inxhiniering Softuerike

Shkenca sociale
- Kujdesi dhe mirëqenia e fëmijëve

Gjuhë angleze

Kulturë Fizike dhe Sport

Arte
- Arkitekturë
- Enterier
- Dizajn grafik
- Pikturë
- Muzikë

Studime në master:
- Financa Zhvillimore
- Tregjet Financiare dhe Bankat
- Menaxhment dhe Informatikë
- Ekonomi dhe Financa
- Komunikim Masiv dhe Gazetari
- Civilo Juridik
- Kulturë Fizike dhe Sport

- I vetmi institucion jopublik i pranuar në **"Magna Charta Universitatum"**
- **Universiteti AAB-Riinvest** operon në 4 objekte në një hapësirë prej 32 000 m2 dhe ofron 27 programe në gjuhën shqipe në studime bachelor dhe master.
- Tre programe studimi në gjuhën angleze nëpërmjet marrveshjes për franshizë me Staffordshire University nga Anglia.
- **INSTITUTI RIINVEST** - instituti më prestigjioz në vend. 15 vjet përvojë pune në hulumtime
- **"THESIS KOSOVA"**, revistë e vetme shkencore me ISSN ndërkombëtar.
- Agjencia e lajmeve **Kosovo News Network** (KNN), TV dhe radio veprojnë në kuadër të Fakultetit të Komunikimit Masiv dhe Gazetarisë të Universitetit AAB-Riinvest (www.knninfo.com)
- Qendra për trajnime
- Qendra rekreative sportive me mbi 15 mijë metra katrorë e cila përmbanë: terrene futbolli, fusha tenisi, pishina, restoran, transport gratis çdo 15 min rreth e qark qytetit
- **AAB-RIINVEST** Universitet i njohur jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon. Profesorë të rregullt dhe vizitorë nga Britania e Madhe, Gjermania, Lubjana, Sarajeva, Shqipëria e Turqia
- Marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbim akademik me: Staffordshire University UK, Universiteti Ankona në Turqi, Universiteti Publik i Tiranës, Universiteti Publik i Sarajevës, Universiteti Evropian i Lublanës, si dhe disa Universitete të njohura evropiane.
- Marrëveshje bashkëpunimi për praktikën e studentëve me më shumë se njëqind biznese dhe institucione bankare në Kosovë.
- **AAB-RIINVEST** ofron hapësirë mësimi të mjaftueshme, laboratorë kompjuterikë më modern, bibliotekë të pasur dhe qasje në burime online.

AAB RIINVEST
PHEP-Institution of Higher University Education

STAFFORDSHIRE UNIVERSITY

Programe të reja studimore në gjuhën angleze në Kosovë

- BA (Hons) Menaxhim Biznesi (BABM)
- BA (Hons) Menaxhim Biznesi dhe Ndërmarrësi (BME)
- BA (Hons) Ekonomiks Biznesi (BE)

AAB-RIINVEST (Programi Franshizë me Universitetin Staffordshire)
Zyra për Pranim
Tel. 038 601 320
www.aabriinvest.net
www.staffs.ac.uk

Only with us...
UK degree

CREATE THE **DIFFERENCE**

Zona Industriale Prishtinë-Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,
Tel: 038/ 601 019; 601 020, Mob: 045/ 284 797, 049/ 603 666, 044/ 522 588, www.aabriinvest.net ; info@aabriinvest.net